



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

PËRMIRËSIMI I SEGMENTIT RRUGOR TUSHEMISHT-DOGANA SHËN NAUM

Raporti i Projekt Zbatimit






Korrik, 2022

KONSULENTI:



Porositësi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Konsulenti:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Objekti:	Përmirësimi i Segmentit Rrugor Tushemisht-Dogana Shën Naum
Titulli i Dokumentit:	Raporti i Projekt Zbatimit
Faza e Projektit:	Projekt Ideja Përfundimtare
Kodi i dokumentit:	ICE-319-P01-V01 00

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për miratim		28.07.2022

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Vasil Leka  Dritan Bratko  Taulant Karriqi  Amarildo Shehu 	Olset Haxhiu Blenard Durmishi Fisnik Kruja	  		
Data:	28.07.2022	28.07.2022	28.07.2022		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2022

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
Lista e Tabelave	ii
Lista e Figurave	iii
1 Hyrje	1
2 KRITERET E PROJEKTIMIT	3
2.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike	3
2.2 Parametrat e projektimit	3
3 Konsideratat për Projektimin e rrugës	4
3.1 Gjendja ekzistuese.....	4
3.2 Projektimi Gjeometrik	6
3.3 Shtresat rrugore	7
3.4 Konsiderata për projektimin strukturor	8
4 Konsiderata për largimin e ujerave të shiut	10
5 Infrastruktura inxhinierike elektrike dhe sistemi i ndriçimit	12
5.1 Rrjeti inxhinierik i infrastrukturës TM, TU, IT dhe ndriçimit	12
5.1.1 Të përgjithshme.....	12
5.1.2 Kodet dhe Standardet	12
Referencat	13

LISTA E TABELAVE

Tabela 4-1: Lista e veprave te artit.....	10
---	----

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1: Horografia	1
Figura 1-2: Planvendosja e objektit.....	2
Figura 3-1: Fillimi i projektit	4
Figura 3-2: Pamje të shtresave rrugore ku vihet re qarte kanali i fibrave optike.....	5
Figura 3-3: Pamje të cedimeve të rrugës dhe plasaritjeve të asfaltit ne anën e majte.	5
Figura 3-4: Formacioni gjeologjik i rrugës.....	6
Figura 3-5: Infrastruktura elektrike përgjatë rrugës.....	6
Figura 3-6: Seksioni tërthor tip i rrugës	7
Figura 3-7: Mure ekzistues prej guri	9

1 HYRJE

Segmenti rrugor “Tushemisht-Doganë” fillon në dalje të fshatit të Tushemishtit, në pjesën lindore të tij, dhe vazhdon deri në doganën e Tshemishtit, me një gjatësi rreth 0.9km. Rruga është e asfaltuar me gjerësi 6m dhe kalon në një terren kodrinor përgjatë bregut të liqenit të Ohrit. Ky segment rrugor i shërben banorëve të fshatit Tushemisht, por më tepër shërben si rrugë lidhëse kufitare midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu kjo rrugë ka tipare të theksuara të një rruge turistike për shkak të pranisë së liqenit të Ohrit dhe zonave turistike afër saj, si Tushemishti, Driloni, Shen Namumi etj.

Objekti zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në funksion të “Programit Operacional”, një program i nisur nga Qeveria Shqiptare.

Shoqëria “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. në cilësinë e Konsulentit ka nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kontratën me objekt: “Përmirësimi i segmentit rrugor Tushemisht-Dogana Shen Naum”.

Objektivat kryesorë të këtij projekti do të jenë: përmirësimi i aksesit drejt potencialeve turistike të rajonit, me qëllim përmirësimin e eksperiencës turistike, cilësisë së jetës për komunitetet si dhe mundësi për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të zonës. Projekti do të synojë të përmirësojë cilësinë dhe sigurinë e lëvizjes.

Për këtë segment rrugor është kërkuar përgatitja e projekt zbatimit.




Figura 1-1: Horografia



Figura 1-2: Planvendosja e objektit

2 KRITERET E PROJEKTIMIT

2.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike

- Projektimi i rrugëve do të bëhet në përputhje me “Rregullin Teknik për Projektimin e Rrugëve” të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 628, datë 15.7.2015.
- Projektimi gjeometrik i rrugëve do të kryhet në përputhje me “Rregullin teknik për projektimin e rrugëve (RrTPRr-2) – Projektimi gjeometrik”
- Projektimi i shtresave rrugore do të kryhet në përputhje me “Rregullin teknik për projektimin e rrugëve (RrTPRr-3) – Projektimi i dyshemesë” dhe “AASHTO (Guide for Design of Pavements Structures 1993)”
- Projektimi i sinjalistikës rrugore do të kryhet në përputhje me “Rregullin teknik për projektimin e rrugëve (RrTPRr-6) – Sinjalistika rrugore” dhe në përputhje me “Kodin Rrugor” në fuqi dhe Rregulloren e Zbatimit të tij.
- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor.
- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet në struktura.
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave të betonit.
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku.
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik.
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave për rezistencë nga tërmeti
- KTP 2-78 Kushtet Teknike të projektimit për ndërtimet në zona sizmike (norma teknike për projektimin në zonat sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP N.2-89 Kushtet Teknike projektimi për ndërtimet antisizmike (Norma Teknike për projektimin.)

2.2 Parametrat e projektimit

Shpejtësia e Projektimit:	50 km/h
Pjerrësia gjatësore maksimale:	8 %
Pjerrësia tërthore:	2.5%
Mbilartësimi maksimal:	7%
Periudha e Projektimit:	20 vjet

3 KONSIDERATAT PËR PROJEKTIMIN E RRUGËS

3.1 Gjendja ekzistuese

Rruga ka një gjatësi afërsisht 1 km dhe kalon përgjatë bregut të liqenit të Ohrit ne pjesën jugore të tij. Ajo gjendet në një lartësi rreth 700 m mbi nivelin e detit. Rruga është e asfaltuar me gjerësi 6m shërben si rrugë lidhëse kufitare midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu kjo rrugë ka tipare të theksuara të një rruge turistike për shkak të pranisë së liqenit të Ohrit dhe zonave turistike afër saj, si Tushemishti, Driloni, Shen Naumi etj.



Figura 3-1: Fillimi i projektit

Gjeometria e rrugës është përgjithësisht e mirë me kthesa të buta me rreze minimale 35m, dhe me pjerrësi gjatësore deri në 6%.

Në profil tërthor rruga është e asfaltuar. Shtresa e asfaltit është e konsumuar. Ajo, vende-vende, ka plasaritje. Gjatë gjithë gjatësisë së rrugës në anën e djathtë të saj ka një kanal të fibrave optike i cili pasi është mbuluar me material granular nuk është asfaltuar. Bazamenti në pjesën më të madhe të tij nuk ka cedime pasi rruga kalon kryesisht në zonë shkëmbore. Por vihen re plasaritje të asfaltit dhe ulje në disa zona nga ana e liqenit që mund të vijnë si rezultat i mbushjeve të dobëta. Vihet re që rruga është deri diku e mirëmbajtur kryesisht me mbyllje gropash dhe riparim plasaritjesh.

Seksioni tërthor i rrugës është 6m asfalt +2x0.75m bankine e paasfaltuar.






Figura 3-2: Pamje të shtresave rrugore ku vihet re qarte kanali i fibrave optike.



Figura 3-3: Pamje të cedimeve të rrugës dhe plasaritjeve të asfaltit ne anën e majte.

Në disa zona traseja nga ana e liqenit rruga është e mbrojtur me mure prej guri.

Në anën e majtë rruga ka barriera metalike anësore.

Formacioni gjeologjik është i mire, kryesisht shkëmbor.



Figura 3-4: Formacioni gjeologjik i rrugës.

Trafiku është relativisht i ulët në këtë zonë. Përgjatë rrugës kalon një linje elektrike të cilat duhet të spostohen.



Figura 3-5: Infrastruktura elektrike përgjatë rrugës

3.2 Projektimi Gjeometrik

Gjatë projektimit, konsulenti do të tentojë të përmirësojë sa me shumë që të jetë e mundur përvijimin horizontal. Shpejtësia e projektimit do të jetë 50km/h se cilës i takon një reze minimale 75m.

Në fillim të segmentit rruga kryqëzohet me rrugën urbane që vjen nga Tushemishti e cila për momentin është rruga e vetme në të cilën kalon trafiku për në dogane. Kryqëzimi i tanishëm zhvillohet me një kënd shumë të ngushtë dhe pjerrësia gjatësore është shumë e madhe të madhe 9%. Konsulenti ka punuar një variant të kryqëzimit në formë T duke përmirësuar këndin e kthesës dhe altimetrinë e tij. Në zonën e kryqëzimit ndodhet një impiant uji të pijshëm i cili furnizohet nga burime nëntokësore. Për këtë arsye gërmimi i shkëmbit në atë zonë do të realizohet në mënyrë të kontrolluar me çekiç. Në pjesën tjetër gërmimi mund të kryhet edhe me mina.




Figura 3-6: Seksioni tërthor tip i rrugës

Për shkak të karakterit turistik të rrugës është parashikuar një korsi biçiklete me gjerësi 1.5m e ndriçuar në anën e majte të rrugës.

Rruga përfundon në hyrje të doganës së Tushemishtit. Në fund të rrugës ndodhet një ndërtesë 2 katëshe e cila preket nga projekti dhe duhet të shpronësohet.

3.3 Shtresat rrugore

Periodha për të cilën do të projektohen shtresat rrugore është 20 vjet. Trafiku për të cilën është llogaritur kjo rrugë është TMDV (trafiku mesatar ditor vjetor) 1200 mjete njësi në ditë.

Llogaritja e shtresave rrugore do të kryhet sipas “Rregullit teknik për projektimin e rrugëve (RrTPPr-3) – Projektimi i dyshemesë” i cili mbështet në metodologjinë së AASHTO për projektimin e rrugëve.

Udhëzuesi i projektimit AASHTO bazohet në konceptin e ngarkesës së përgjithshme të trafikut në terma të një ngarkese statike të vetme e njohur si ngarkesë një aksiale ekuivalente 80 kN (ESAL).

Pas llogaritjeve paketa e shtresave e parashikuar do të jetë:

Asfalt	4cm
Binder	6cm
Stabilizant	20cm
<u>Çakëll</u>	<u>20cm</u>
Total	50cm

3.4 Konsiderata për projektimin strukturor

Projektimi i strukturave do të bëhet në përputhje me Rregullat Teknikë të Projektimit Rrugëve (RrTPRr-5_ - Urat dhe Tunelet si dhe normat Evropiane (Eurokodet).

Projektimi dhe ndërtimi i të gjithë zërave të veprave të artit do të përmbushin kërkesat e botimeve dhe rishikimeve më të fundit të kodeve dhe standardeve të organizmave teknike të mëposhtme:

- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor
- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet mbi struktura
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave prej betoni
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit
- KTP 2-78 Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet në zona sizmike (norma teknike për projektimin në zonat sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP N.2-98 Kushtet teknike projektimi për ndërtimet antisizmike (norma teknike për projektimin e strukturave anti-sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP 4-78 Kategorizimi dhe klasifikimi i veprave hidroteknike
- KTP 7-78 Përcaktimi i ngarkesës së erës
- KTP 8-78 Përcaktimi i ngarkesës së dëborës

Janë parashikuar 5 tombino rrethore me diametër 800-1500 mm.

Gjatë rrugës ke mure guri me llac përgjithësisht në gjendje të mire.



Figura 3-7: Mure ekzistues prej guri

4 KONSIDERATA PËR LARGIMIN E UJERAVE TË SHIUT

Vihet re një mungese e sistemit të drenazhimit. Por nga tjetër gjatë rrugës nuk ka ndonjë rrjedhe të përqendruar me prurje të madhe. Përsa i përket drenazhimit të rrugës është parashikuar një kanal nga ana e shpatit dhe tombino rrethore 800-1500 mm

Ne mënyrë të përmblodhur, veprat e artit të këtij segmenti jepen në tabelën e përmblodhur me poshtë.

Tabela 4-1: Lista e veprave të artit

NR.	EMERTIMI	NJËSIA	SASIA
1	Tombino me tuba betoni Ø 800 mm	copë	3
2	Tombino me tuba betoni Ø 1500 mm	copë	1

Ndërsa në figurën me poshtë jepen pellgjet ujëmbledhëse përgjatë aksit të rrugës Tushemisht-Dogana Shën Naum.




Figura 4-1: Pellgjet Ujmbledhës

Nga pikëpamja e ndërhyrjeve tombinot do të jene me puseta ne hyrje dhe mure ne dalje.

5 INFRASTRUKTURA INXHINIERIKE ELEKTRIKE DHE SISTEMI I NDRIÇIMIT

5.1 Rrjeti inxhinierik i infrastrukturës TM, TU, IT dhe ndriçimit

Është parashikuar rialokimi i linjave ekzistuese që preken nga projekti.

Është parashikuar ndriçim dhe infrastruktura për kalimin e fibrave optike.

5.1.1 Të përgjithshme

Projektimi i infrastrukturës inxhinierike elektrike dhe IT konsiston në marrjen në konsideratë nga ana e projektuesit të disa pikave kryesore të cilat janë:

- Gjendja ekzistuese e kabinave, linjave elektrike dhe IT.
- Sigurinë dhe kushtet teknike të projektimit.
- Spostimin e Kabinave Elektrike ekzistuese (nëse ka) për shkak të gjurmës së projektit.
- Spostimin e Shtyllave Elektrike ekzistuese TU, TM, TL për shkak të gjurmës së projektit.
- Demontim të Shtyllave ekzistuese Elektrike TU, TM, TL dhe IT të cilat janë të amortizuara ose janë jashtë funksionit, që preken nga gjurma e projektit.
- Demontim të linjave dhe kabujve ekzistues të cilat janë jashtë funksionit.
- Spostim/Infrastrukturë nëntokësore të linjave IT.

5.1.2 Kodet dhe Standardet

- BS EN 13201-1: Guidelines on selection of lighting classes
- BS EN 12665: Light and lighting - Basic terms and criteria for specifying lighting requirements.
- BS 7430:2011: Code of practice for protective earthing of electrical installations.
- BS EN 60598 2003: Luminaires-Part 2-3- Particular requirements-Luminaires for road and street lighting.
- UNI 11248: Road lighting, selection according to road classification.
- UNI EN 40-5: Standards of road lighting and their application.
- UNI EN 40-2: The rule on the dimensions of the poles and the depth of the fixation on the ground.
- CEI 64-7: Pole positioning according to the environment where it will be installed.
- CEI 64-8: Electrical calculation system, overflow system, protection against direct and indirect contact.
- CEI 20-22: Standard on FG16OR coating cables.
- CEI 11-17: Standard on the highway installation and installation of cable infrastructure.
- CEI 32-01: Standard on the application of security protection in road lighting plants.
- IEC 60439-1: Low voltage panels and assembly of frames.
- IEC 60947: Low-voltage switchboards and their control.
- IEC 60502: Power cables with extruded insulation and their accessories for rated voltage from 1 kV ($U_m=1,2$ kV) up to 30 kV ($U_m=36$ kV).
- IEC 227: "PVC insulated cables of rated voltages up to and including 450/750 V".

REFERENCAT

- Detyra e Projektimit, nga Autoriteti kontraktues
- VKM Nr. 628, date 15.07.2015 Për miratimin e Rregullave të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve
- Kushtet teknike të projektimit (Ujësjiellësa dhe Kanalizime), 1978
- Standardi Europian BS EN 805, UNI EN 805
- Standardi Europian BS EN 752, UNI EN 752
- Standardi Europian BS EN 12050
- Standardi Europian BS EN 12056
- Standardi Europian BS EN 1610
- Standardi Europian BS EN 124
- Standardi Europian DIN EN 1955, etj
- Acquadotti – Guida alla progettazione, Valerio Milano
- Sistemi di Fognatura – Manuale di Progettazione, grup autorësh
- Pompe e Impianti di sollevamento, Alberto Bianchi, Umberto Sanfilippo



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

PËRMIRËSIMI I SEGMENTIT RRUGOR TUSHEMISHT-DOGANA SHËN NAUM

Aneksi A – Llogaritjet e Shtresave Rrugore





Korrik, 2022

KONSULENTI:



Porositësi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Konsulenti:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Objekti:	Përmirësimi i Segmentit Rrugor Tushemisht-Dogana Shën Naum
Titulli i Dokumentit:	Aneksi A – Llogaritjet e Shtresave Rrugore
Faza e Projektit:	Projekt Zbatimi
Kodi i dokumentit:	ICE-319-P01-V01 01

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për zbatim		07.07.2022

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Vasil Leka 	Olset Haxhiu Blenard Durmishi	 		
Data:	07.07.2022	07.07.2022	07.07.2022		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratur	Kontrolluar	Miratur

Tiranë 2022

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
1 Projektimi i shtresave rrugore	1

1 PROJEKTIMI I SHTRRESAVE RRUGORE

1-Trafiku:

n=	1	korsi	Number of lanes per direction
D _D =	0.50		Directional distribution factor
D _L =	1.00		Lane distribution factor

Table 1-1: Shpërndarja e Trafikut

Vehicle Class No.	Vehicle Class	Typical ESAL	AADT for eachh vehicle class	Daily ESAL	PCE factor	Passenger car equivalent
1	Motorcycles	0.000015	0	0	0.5	0
2	Passenger cars	0.001163	500	0.58	1	500
3	Pickups, Panels, Vans	0.008352	500	4.18	1	500
4	Buses	0.577291	50	28.86	3.5	175
5	Single Unit 2-Axle Trucks	0.288515	10	2.89	3.5	35
6	Single Unit 3-Axle Trucks	0.492711	10	4.93	3.5	35
7	Single Unit 4 or More-Axle Trucks	0.597833	5	2.99	3.5	17.5
8	Single Trailer 3- or 4-Axle Trucks	0.331022	2	0.66	3.5	7
9	Single Trailer 5-Axle Trucks	1.237570	2	2.48	4	8
10	Single Trailer 6 or More-Axle Trucks	1.381913	3	4.15	3.5	10.5
11	Multi-Trailer 5 or Less-Axle Trucks	0.895650	0	0.00	3.5	0
12	Multi-Trailer 6-Axle Trucks	1.334809	0	0.00	3.5	0
13	Multi-Trailer 7 or More-Axle Trucks	1.428643	0	0.00	4	0
Sum				51.7	AADT	1'288
Yearly ESAL				18'886	AAT	470'442
Yearly ESAL / Design lane				9'443		
Traffic annual growth rate r				4%		4%
Design Life Y (years)				20		20
$ESAL\ total = Y * Yearly\ ESAL * G = Y * Yearly\ ESAL * \frac{(1+r)^Y - 1}{r}$				281'191	PCE Total	14'008'859

2-Besueshmeria

B=	95.00%	Besueshmeria
----	---------------	--------------

$Z_R=$	-1.645	<i>Shmangia normale standarde</i>
$S_0=$	0.5	<i>Gabimi standard i kombinuar i parashikimit të trafikut dhe funksionimit</i>

Tabela 2: Vlerat e Rekomanduara të Besueshmërisë (AASHTO, 1993)

Klasifikimi i rrugës	Vlerat e rekomanduara të besueshmërisë	
	Urbane	Rurale
Autostrada	85% - 99.9%	80% - 99.9%
Arterie Kryesore	80% - 99.9%	75% - 95%
Kolektorë	80% - 95%	75% - 95%
Lokale	50% - 80%	50% - 80%

Tabela 3: Shmangia Normale Standarde për Besueshmëri të Ndryshme

Besueshmëria (%)	Shmangia normale standarde	Besueshmëria (%)	Shmangia normale standarde
50	0	93	-1.476
60	-0.253	94	-1.555
70	-0.524	95	-1.645
75	-0.674	96	-1.751
80	-0.841	97	-1.881
85	-1.037	98	-2.054
90	-1.282	99	-2.327
91	-1.34	99.9	-3.09
92	-1.405	99.99	-3.75

3-Treguesi i Shërbyeshmërisë

Shërbyeshmëria është një koncept i lidhur me funksionin kryesor të strukturës së dyshemesë: ti ofrojë publikut udhëtues një drejtim mjete të lehtë, të rehatshëm dhe të sigurt. Përdoret një shkallë vlerësimi nga 0 në 5 për vlerësimin e treguesit të shërbyeshmërisë aktuale (PSI); shtresa me vlerësimin 0 është e pakalueshme dhe 5 do të ishte e lëmuar në mënyrë perfekte.

Humbja e shërbyeshmërisë së projektimit (Δ PSI) përcaktohet duke zbritur PSI përfundimtare në fund të periudhës së projektimit prej PSI fillestare në fillim të ndërtimit. PSI në fillim të ndërtimit do të jetë normalisht nga 4.2 në 4.6 dhe zakonisht mund të pranohet të jetë 4.5. PSI në fund të periudhës së projektimit është rasti më i keq i kushteve të pranueshme të cilat mund të arrijë shtresa. Një PSI kufitare prej 2.5 është e pranueshme për rrugë me Trafik Mesatar Ditor (ADT) prej 750 ose më shumë.

Δ PSI=	2	<i>Humbja e shërbyeshmërisë së projektimit</i>
---------------	---	--

4-Tabani

CBR=	9	%	<i>Californian Bearing Ratio</i>
$M_R=$	13500	psi	<i>Subgrade resilient modulus (psi) $M_R=1500*CBR$ (%) acc. AASHTO 1993</i> <i>Subgrade resilient modulus (psi) $M_R=2055*[CBR(\%)]^{0.64}$ acc. AASHTO 2002 Design Guide</i>
$M_R=$	93079.223	kPa	<i>Subgrade resilient modulus (kPa)</i>

5-Llogaritja e Numrit Strukturor

Llogaritja e SN behet nga ekuacioni i meposhtem:

$$\log_{10} W_{18} = z_R \cdot S_0 + 9.36 \cdot \log_{10}(SN + 1) - 20 + \frac{\log_{10} \left(\frac{\Delta PSI}{4.2 - 1.5} \right)}{0.40 + \frac{1094}{(SN + 1)^{5.19}}} + 2.32 \cdot \log_{10} M_R - 8.07$$

	0.0000001	
SN=	2.44	in
SN=	6.19	cm

Solver	FALSE
Parameters	1
	100
	100

6-Përcaktimi i paketës së shtresave

Koeficienti i shtresës shpreh marrëdhënien empirike midis SN dhe trashësisë, dhe është një masë e aftësisë relative të materialit për të funksionuar si një komponent strukturor i dyshemesë.

$$SN = a_1 \cdot D_1 + a_2 \cdot D_2 \cdot m_2 + a_3 \cdot D_3 \cdot m_3 + \dots + a_n \cdot D_n \cdot m_n$$

Tabela 4: Koeficientët dhe Trashësitë e Shtresave

Nr.	Emri i Shtreses	Koeficienti i shtreses a_i	Koeficienti i drenimit m_i	Trashësia e shtreses D (cm)	$a_i \cdot d_i \cdot m_i$ (cm)
1	Asfalt	0.44	1	4	1.76
2	Binder	0.4	1	6	2.4
3	Konglomerat	0.3	1	0	0
4	Stabilizant	0.14	0.7	20	1.96
5	Cakull	0.11	0.7	20	1.54
6	Zhavorr	0.1	0.7	0	0
7					0
8					0
9					0
10					0
Total				50	7.66

Trashësia e Shtresave
OK



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

PËRMIRËSIMI I SEGMENTIT RRUGOR TUSHEMISHT- DOGANA SHËN NAUM

Aneksi B – Llogaritjet Hidraulike







Korrik, 2022

KONSULENTI:

ICE | ILLYRIAN
CONSULTING
ENGINEERS

Porositësi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Konsulenti:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Objekti:	Përmirësimi i Segmentit Rrugor Tushemisht-Dogana Shën Naum
Titulli i Dokumentit:	Aneksi B – Llogaritjet Hidraulike
Faza e Projektit:	Projekt Ideja Përfundimtare
Kodi i dokumentit:	ICE-319-P01-V01 02

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për miratim		08.07.2022

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Alban Doko  Dritan Bratko 	Olset Haxhiu Blenard Durmishi	 		
Data:	08.07.2022	08.07.2022	08.07.2022		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2022

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
Lista e Tabelave	ii
Lista e Figurave	iii
1 Hyrje	1
2 Llogaritja Hidraulike e Tombinove	2
2.1 Llogaritja Hidraulike e Tombinove	2
3 Drenazhimi i Sipërfaqes së Rrugës	3
3.1 Të Përgjithshme.....	3
3.2 Kodet dhe Standartet	3
3.3 Kriteret e Projektimit.....	3
3.4 Intensiteti i Shiut	3
3.5 Përcaktimi i Prurjes tek Kuneta dhe Kanali Anësor	4
3.5.1 Koeficienti i Rrjedhës.....	4
3.5.2 Koha e Bashkëardhjes	4
3.5.3 Rezultatet e Mara nga Llogaritja Hidrologjike	5
3.5.4 Përcaktimi i Kapacitetit të Kusetës.....	6
3.6 Kapaciteti i Zgarave Shimbledhëse	7
3.6.1 Llogaritja e Prurjes që Kalon në Zgara në Siperfaqet e Pjerrëta	7
3.7 Kontrolli i Kapacitetit të Kanalit Anësor.....	8
Referencat	10
Literatura	11

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1: Tabela Përmbledhëse me Llogaritjet e Tombinove	2
Tabela 3-1 Kapaciteti i Kinetës për Pjerrësi të Ndryshme Gjatësore të Rrugës	7
Tabela 3-2 Kapaciteti i Zgarave për Pjerrësi të Ndryshme Gjatësore të Rrugës	8
Tabela 3-3 Kontrolli i Kapacitetit të Kanalit	9

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1: Planvendosja e Rrugës	1
Figura 3-1 Kurba e Intensiteteve të Shiut (Pogradec) për Drenazhimin e Rrugës	3

1 HYRJE

Segmenti rrugor “Tushemisht-Doganë” fillon në dalje të fshatit të Tushemishtit, në pjesën lindore të tij, dhe vazhdon deri në doganën e Tushemishtit, me një gjatësi rreth 1km. Rruga është e asfaltuar me gjerësi 6m dhe kalon në një terren kodrinor përgjatë bregut të liqenit të Ohrit. Ky segment rrugor i shërben banorëve të fshatit Tushemisht, por më tepër shërben si rrugë lidhëse kufitare midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu kjo rrugë ka tipare të theksuara të një rruge turistike për shkak të pranisë së liqenit të Ohrit dhe zonave turistike afër saj, si Tushemishti, Driloni, Shën Namumi etj.

Objekti zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në funksion të “Programit Operacional”, një program i nisur nga Qeveria Shqiptare.

Shoqëria “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. në cilësinë e Konsulentit ka nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kontratën me objekt: “Përmirësimi i segmentit rrugor Tushemisht-Dogana Shen Naum”.

Objektivat kryesorë të këtij projekti do të jenë: përmirësimi i aksesit drejt potencialeve turistike të rajonit, me qëllim përmirësimin e eksperiencës turistike, cilësisë së jetës për komunitetet si dhe mundësi për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të zonës. Projekti do të synojë të përmirësojë cilësinë dhe sigurinë e lëvizjes.

Për këtë segment rrugor është kërkuar përgatitja e projekt zbatimit.



Figura 1-1: Planvendosja e Rrugës

Në këtë aneks janë paraqitur llogaritjet hidraulikë të bëra për drenazhimin e rrugëve dhe zonave urbane që do të ndërtohen përgjatë tyre. Llogaritjet janë bërë duke ndjekur udhëzimet dhe kriteret e VKM Nr. 628, datë 15.07.2015.

Përkatesisht në këtë raport janë dhënë llogaritjet hidraulike për Tombinot:

2 LLOGARITJA HIDRAULIKE E TOMBINOVE

2.1 Llogaritja Hidraulike e Tombinove

Përgjatë segmentit rrugor do të ndërtohen tombino të cilat do të shërbejnë për përcjelljen e ujërave që vijnë nga shpatet anash rrugës. Pothuajse të gjitha tombinot për shkak dhe të terrenit në hyrje janë me pusëtë ndërsa në dalje janë të lira shkarkojnë direkt në liqen, pasi dhe diferenca e kuotave është e tillë që krijon rënie të menjëhershme.

Sipas Studimit Hidrologjik në zonën në studim janë 4 pellgje ujëmbledhëse, të cilët formojnë rrjedha sipërfaqësore në formën e përrenjve. Për shkak të pjerrësisë së terrenit këta përrenj kanë luhajtje të mëdha të prurjeve përgjatë stinëve të ndryshme, disa prej tyre në verë shterojnë plotësisht. Rrjedhat e përqendruara të ujit që vijnë në rrugë do të largohen prej saj nëpërmjet tombinove me hyrje në formë pusëtë. Kurse rrjedha që vjen nga shpati do të kapet me anë të një kanali të hapur anësorë dhe do të orientohet drejt tombinove.

Tombinot bazuar në VKM Nr. 628, datë 15.07.2015 rruga do të llogaritet për prurjet me siguri 1 herë në 50 vjet.

Tombinot janë llogaritur me anë të softuerit HY-8. Në këtë softuer janë përcaktuar:

- Tombinot

Hyrja e tombinove- e cila për shkak të terrenit për të gjitha tombinot është hyrje me pusëtë

Dalja e Tombinove – dalje e lirë

Pjerrësia gjatësore – në varësi dhe të planvendosjes së rrugës varion nga 1-5 %.

Ashpërsia manning – për betone të ashpra $n=0.018$

Dimensionet – janë zgjedhur që tombino për prurjen me siguri 2% të punojnë me 70% të kapacitetit.

Nga analiza janë marë rezultatet e paraqitura në tabelën mëposhtë.

Tabela 2-1: Tabela Përmbledhëse me Llogaritjet e Tombinove

Nr	Km	Sipërfaqja e Pellgut (A) (km ²)	Prurja 1/50 vjet (Q) (m ³ /s)	Dimesnionet (bxh;D)	Ashpersia Manning	Pjerrësia (m/m)	Thellesia e Ujit (m)	Shpejtësia e Ujit (m/s)
1	0+114	0.026	0.3	D=800 mm	0.018	0.01	0.308	1.68
2	0+309	0.037	0.5	D=800 mm	0.018	0.01	0.41	1.92
3	0+428	0.240	2.5	D=1500 mm	0.018	0.01	0.74	2.87
4	0+863	0.050	0.6	D=800 mm	0.018	0.01	0.46	2.0

Sipas llogaritjeve hidraulike rezultojnë 4 tombino, nga të cilat 3 do të jenë tombino tub me diametër 800 dhe njëra do të jetë tub me diametër 1500 mm.

3 DRENAZHIMI I SIPËRFAQES SË RRUGËS

3.1 Të Përgjithshme

Në këtë kapitull janë dhënë llogaritjet për kullimin e sipërfaqes së rrugës së bashku me shpatin.

3.2 Kodet dhe Standartet

• VKM Nr. 628, date 15.07.2015 Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve.

3.3 Kriteret e Projektimit

Në tabelën e mëposhtme përmbliidhen kriteret hidraulike për analizën e sistemit të drenazhimit të sipërfaqes së trupit të rrugës.

Elementi	Vlera e Rekomanduar
Koha e Bashkëardhjes Minimale	5-10 min
Siguria e Projektimit të Drenazhimit të ujërave të shiut (sipërfaqet e rrugës) për rrugët me shpejtësi më të vogël së 70 km	1 herë në 10 vjet
Shpërndarja e Lejuar në trupin e Rrugës	Kuneta +1 m
Stacioni Meteorologjik “Pogradec”	Kurba e Intensitetit të Shiut

3.4 Intensiteti i Shiut

Për stacionin meteorologjik “Pogradec” nga të dhënat e marra nga Studimi Hidrologjik, më poshtë është paraqitur kurba intensitet kohëzgjatje frekuencë për periudhën e përsëritjes 1 herë në 10 vjet.




Figura 3-1 Kurba e Intensiteteve te Shiut (Pogradec) për Drenazhimin e Rrugës

3.5 Përcaktimi i Prurjes tek Kuneta dhe Kanali Anësor

Prurja maksimale me një frekuencë të caktuar përsëritje e cila do të transportohen nga kuneta dhe kanali është përcaktuar me formulën racionale për sipërfaqe deri në 80 ha:

Formula Racionale:

$$Q = 0.00278 \cdot C \cdot I \cdot A$$

Q – Vlera maksimale e prurjes

m³/s

C – Koeficienti i rrjedhës

I – Intensiteti mesatar i shiut për një kohëzgjatje të shiut të barabartë me kohën e përqendrimit, për një periudhë të përzgjedhur kthimi

mm/orë

A – Sipërfaqja e pellgut që kontribuon në vëndodhjen e projektuar

ha

3.5.1 Koeficienti i Rrjedhës

Koeficienti i rrjedhës është në varësi të karakteristikave të sipërfaqes ujëmbledhëse. Vlerat e marra në llogaritje janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 3-1: Koeficienti i Rrjedhës

Përshkrimi i Sipërfaqes	Koeficienti i Rrjedhës
Sipërfaqe të shtruara (asfalt, beton) dhe çatitë e ndërtesave	0.90
Sipërfaqe toke të zhveshura ose të punuara	0.40
Kullota ose fusha me bar	0.20

Në rastet kur zona ujëmbledhëse ka sipërfaqe me karakteristika të ndryshme atëherë kjo zonë ndahet në pjesët koresponduese dhe koeficienti i rrjedhës për zonën kompozite llogaritet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm.

$$C = \frac{\sum_1^n A_i x C_i}{\sum_1^n A_i}$$

3.5.2 Koha e Bashkëardhjes

Koha e bashkëardhjes për rrjedha sipërfaqësore për secilën sipërfaqe ujëmbledhëse do të përcaktohet bazuar në ekuacionin e Kerby të treguar më poshtë:

$$t_c = \left(2.187x \frac{nxL}{\sqrt{S}} \right)^{0.467}$$

ku:

t_c: është koha e bashkëardhjes në min për sipërfaqen ujëmbledhëse të marrë në shqyrtim.

L: është gjatësia e rrjedhës më të gjatë përgjatë sipërfaqes ujëmbledhëse deri në pikën e depozitimit të ujit të shiut në m (p.sh baseni i depozitimit ose kanali).

S: pjerrësia mesatare e sipërfaqes përgjatë rrjedhës (m/m)

n: koeficienti i ashpërsisë Kerby në varësi të karakteristikave të sipërfaqes të zonave të veçanta ujëmbledhëse Vlerat e propozuara për projektim janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3-2: Koefficienti i Ashpërsisë sipas Kerby

Përshkrimi i Sipërfaqes	Koefficienti i Ashpërsisë n
Sipërfaqe të shtruara (asfalt, beton) dhe çatitë e ndërtesave	0.02
Sipërfaqe toke të zhveshura ose të punuara	0.20
Kullota ose fusha me bar	0.40


Në rastet kur një sipërfaqe e përbërë ujëmbledhëse me karakteristika të ndryshme shkarkohet në një pikë depozitimi, atëherë sipërfaqja duhet të ndahet në pjesë me karakteristika uniforme dhe koha e bashkëardhjes për sipërfaqen ujëmbledhëse duhet të përcaktohet nga shumatorja e kohës së bashkëardhjes së secilës zonë, kur sipërfaqet e veçanta zhgarkohen në seri. Kur sipërfaqet e veçanta shkarkohen në paralel atëherë koha e bashkëardhjes për sipërfaqen ujëmbledhëse duhet të jetë maksimumi i kohës së bashkëardhjes të të gjitha sipërfaqeve të veçanta.

3.5.3 Rezultatet e Mara nga Llogaritja Hidrologjike

Për drenazhimin e sipërfaqes së rrugës është llogaritur prurja për 1 ml. Duke qënë se pjerrësitë tek sipërfaqja e rrugës janë të konsiderueshme koha e bashkëardhjes është pranuar 5 min per kuneten dhe 7 min per kanal dhe intensiteti i shiut për stacionin meteorologjik “Pogradec” me periudhe përsëritje një here ne 10 vjet është $I=93$ mm/ore.

Rruga përbëhet nga dy korsi me pjerrësi tërthore 2.5%, gjerësia e cila do te kullohet nga kuneta eshte është 7 m dhe per zonen qe do te kullohet nga kanali eshte 20 m.

Seksioni tërthor i rrugës paraqitet ne figurën meposhte:



Prurja për 1 ml qe do te kullohet nga kuneta është:


$$Q = 0.00278 \cdot 0.9 \cdot 93 \cdot \frac{(7 \cdot 1)}{10000} = 0.16 \text{ l/s(ml)}$$

Prurja për 1 ml qe do te kullohet nga kanali është:

$$Q = 0.00278 \cdot 0.9 \cdot 89 \cdot \frac{(20 \cdot 1)}{10000} = 0.44 \text{ l/s(ml)}$$

3.5.4 Përcaktimi i Kapacitetit të KUNETËS

Meqënëse rruga ka disa pjerrësi gjatësore për secilën nga ato është përcaktuar kapaciteti maksimal i përhapjes së shtresës së ujit në kunetë dhe rrugë. Përhapja e ujit në rastin e rruges është e lejuar gjerësia e kunetës + 1m. Seksioni tërthor që do të analizohet është njëra nga korsitë, pjerrësi tërthore 2.5% dhe kuneta me gjerësi 0.5m dhe pjerrësi tërthore 8%.



Ekuacioni llogaritës për përcaktimin e kapacitetit është përdorur formula e Manning-ut.

Q-Prurja m³/s

$$Q = \frac{Q_s}{(1 - E_0)}$$

m³/s

E₀-Eficienca

$$E_0 = 1 / \left\{ 1 + \frac{\frac{S_w}{S_x}}{\left[1 + \frac{\frac{S_w}{S_x}}{\frac{T}{W} - 1} \right]^{2.67} - 1} \right\}$$

S_x- pjerrësia tërthore e rrugës m/m

S_w- pjerrësia tërthore e kunetes m/m

W-Gjerësia e Kunetes m

T-përhapja e ujit mbi kunete dhe rruge m

Q_s-Prurja në seksionin jashtë kunetes (në rrugë) m³/s

$$Q_s = \frac{0.376}{n} \cdot S_x^{1.67} \cdot S_L^{0.5} \cdot T^{2.67}$$

n- ashpërsia manning 0.016 (beton)

S_L- pjerrësia gjatësore e rrugës m/m

Nisur nga kushti i lejuar që gjerësia e përhapjes së ujit duhet të jetë sa gjerësia e kunetës + 1m (1.5 m) llogaritjet e kapacitetit të kunetës është bërë për disa pjerrësi gjatësore të rrugës SL=0.001 m/m deri SL=0.02 m/m. Nisur nga kushti i përhapjes së ujit është përcaktuar dhe hapi i pushtave shimbledhëse. Në tabelën


mëposhtë jepet llogaritja e kapacitetit të kunetës për disa pjerrësi gjatësore të rrugës (hapi i pusetave është zgjedhur paraprakisht çdo 30m).

Tabela 3-1 Kapaciteti i Kunetës për Pjerrësi të Ndryshme Gjatësore të Rrugës

Pjerrësia gjatësore e rruges SL (m/m)	Pjerrësia terthore e rruges Sx (m/m)	Pjerrësia terthore e kunetes Sw (m/m)	Ashpërsia Manning n	Gjerësia e Kunetes w (m)	Prurja Llogaritëse Q (l/s) për hap pusetash (30m)	Përhapja e ujit T (m)	Eficienca E0	Thellessia e ujit ne kunetë (cm)
0.0021	0.025	0.08	0.016	0.5	5.0	0.939	0.949	5.09
0.0045	0.025	0.08	0.016	0.5	5.0	0.688	0.992	4.47
0.025	0.025	0.08	0.016	0.5	5.0	0.4	1	3.2
0.035	0.025	0.08	0.016	0.5	5.0	0.38	1	3.0
0.045	0.025	0.08	0.016	0.5	5.0	0.36	1	2.9
0.055	0.025	0.08	0.016	0.5	5.0	0.35	1	2.8

3.6 Kapaciteti i Zgarave Shimbledhëse

Zgarat, si një lloj hyrje, funksionojnë në mënyrë të kënaqshme në një masë të madhe të kunetave. Kapja e ujit me zgara përgjithësisht humbet kapacitetin me rritjen e pjerrësisë, por në një masë më të vogël se hyrjet e hapura në bordura.



Avantazhi kryesor i zgarave është se ato janë të vendosura përgjatë rrugës ku rrjedh uji. Disavantazhi i tyre është se mund të bllokohen prej lundrimit të mbeturinave ose inerteve. Për arsye sigurie, duhet ti jepet preferencë zgarave pasi mund të kalojnë edhe mjetet që kanë humbur kontrollin. Për më tepër, aty ku ka trafik biçikletash kapakët e pusetave duhet të jenë të sigurta për to.

3.6.1 Llogaritja e Prurjes që Kalon në Zgara në Siperfaqet e Pjerrëta

Kapaciteti i ndërprerjes së një hyrjeje me kapak në nivel është i barabartë me efijencën e kapakut shumëzuar për rrymën totale në kunetë:

$$Q_i - \text{Prurja që mer zgara} \quad m^3/s$$

$$Q_i = E \cdot Q = Q[R_f E_0 + R_s(1 - E_0)]$$

$$Q - \text{Prurja që kalon ne kunete} \quad m^3/s$$

R_s -Efijenca e ndërprerjes së rrymës anësore

$$R_s = 1 / \left(1 + \frac{0.0828 \cdot V^{1.8}}{S_x \cdot L^{2.3}} \right)$$

$$S_w - \text{pjerrësia tërthore e kunetës} \quad m/m$$

$$L - \text{Gjatësia e zgarës} \quad m$$

$$V - \text{shpejtësia e rrjedhës në kunetë} \quad m/s$$

$$V = \frac{Q}{A}$$

$$Q - \text{Prurja që kalon në kunetë} \quad m^3/s$$

A-Sipërfaqja e Lagur	$A = 0.5 \cdot T^2 \cdot S_x + 0.5 \cdot (S_w - S_x) \cdot W$	m ²
S _x -pjerësia terthore e rrugës		m/m
S _w -pjerësia tërthore e kunetes		m/m
W-Gjerësia e Kunetes		m
T-përhapja e ujit mbi kunete dhe rrugë		m
R _f -Eficienca e ndërprerjes së rrymës ballore	$R_f = 1 - 0.295 \cdot (V - V_0)$	
V-shpejtësia e rrjedhës në kunetë		m/s
V ₀ -shpejtësia që ndodh kërcimi i ujit mbi zgarë		m/s

Kapaciteti i zgarave është llogaritur për disa pjerrësi gjatësore të rrugës (si ato të mara për kontrollin e kapacitetit të kunetës). Mëposhtë jepet tabela ku tregohet kapaciteti i zgarave.

Tabela 3-2 Kapaciteti i Zgarave për Pjerrësi të Ndryshme Gjatësore të Rrugës

Pjerësia gjatësore e rruges SL (m/m)	Gjerësia e zgarës w (m)	Gjatësia e Zgarës L (m)	Prurja Llogaritëse Q (l/s) për hap pusetash (30m)	Prurja e kapur nga zgara Q _i (l/s)	Prurja që ngelet Q _{bp} (l/s)	Eficienca E
0.0021	0.5	0.5	5.0	5.0	0.0	0.964
0.0045	0.5	0.5	5.0	5.0	0.0	0.991
0.025	0.5	0.5	5.0	5.0	0.0	1
0.035	0.5	0.5	5.0	5.0	0.0	1
0.045	0.5	0.5	5.0	5.0	0.0	1
0.055	0.5	0.5	5.0	5.0	0.0	1

3.7 Kontrolli i Kapacitetit të Kanalit Anësor

Dimensionet e kanalit anësor me gravitet janë kontrolluar me ane të formulës Manning:

$$Q = \frac{1}{n} \cdot R^2 \cdot s^{0.5}$$

Q- prurja llogaritëse

n – ashpërsia Manning

s- pjerrësia e kanalit/tubacionit

R – rezja hidraulike

Ne tabelën mëposhtë jepen për secilin segment prurjet e llogaritura, thellesia e ujit dhe shpejtësia për seksionin trapezoidal të kanalit të hapur të paveshur me b=40 cm, h= 40 cm dhe pjerrësi të skarpave z=1/1.

Tabela 3-3 Kontrolli i Kapacitetit të Kanalit

Segmenti	Gjatësia (m)	Prurja njesi (l/s/ml)	Prurja (l/s)	Pjerresia (m/m)	Ashperisa Manning n	Dimension et	Thellesia e Ujit (m)	Shpejtesia (m/s)
0+017-0+114	97	0.44	43	0.0045	0.022	b=0.4 m, h=0.4m, z=1/1	0.13	0.6
0+114-0+193	79	0.44	35	0.0245	0.022	b=0.4 m, h=0.4m, z=1/1	0.071	1.04
0+193+0+309	116	0.44	51	0.025	0.022	b=0.4 m, h=0.4m, z=1/1	0.089	1.17
0+309+0+428	119	0.44	53	0.0021	0.022	b=0.4 m, h=0.4m, z=1/1	0.183	0.496
0+428-0+698	270	0.44	118	0.0374	0.022	b=0.4 m, h=0.4m, z=1/1	0.128	1.75
0+698-863	165	0.44	73	0.026	0.022	b=0.4 m, h=0.4m, z=1/1	0.108	1.33

REFERENCAT

Raporti i llogaritjeve hidraulike është hartuar duke u mbështetur dhe mbi studimet e mëposhtme:

- Studimi hidrologjik.
- Studimi topografik.

LITERATURA

- [1] Brunner, G. (2020). HEC-RAS River Analysis System: 2D Modeling User's Manual. Version 6.2 US Army Corps of Engineers, Institute for Water Resources, Hydrologic Engineering Center.
- [2] HYDRAULIC DESIGN OF HIGHWAY CULVERTS Publication No. FHWA-NHI-12-029, January 2012.



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

PËRMIRËSIMI I SEGMENTIT RRUGOR TUSHEMISHT-DOGANA SHËN NAUM

Aneksi C – Llogaritjet Strukturore të Veprave të Artit






Korrik, 2022

KONSULENTI:



Porositësi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Konsulenti:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Objekti:	Përmirësimi i Segmentit Rrugor Tushemisht-Dogana Shën Naum
Titulli i Dokumentit:	Aneksi C – Llogaritjet Strukturore të Veprave të Artit
Faza e Projektit:	Projekt Zbatimi
Kodi i dokumentit:	ICE-319-P07-V01 04

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për zbatim		08.07.2022

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Taulant Karriqi 	Olset Haxhiu Blenard Durmishi	 		
Data:	08.07.2022	08.07.2022	08.07.2022		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratur	Kontrolluar	Miratur

Tiranë 2022

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
Lista e Tabelave	ii
Lista e Figurave	iii
1 Hyrje	1
2 Konsideratat për projektimin strukturor dhe kriteret e projektimit	2
2.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknikë.....	2
2.2 Veprimet.....	2
2.2.1 Peshat vetjake dhe veprimet e përhershme	3
2.2.2 Ngarkesat e përkohshme në ura dhe tombino	4
2.2.3 Veprimi sizmik	7
2.3 Projektimi në Gjendjen Kufitare dhe faktorët e sigurisë për urat dhe strukturat e tjera	8
2.3.1 Gjendja Kufitare e Fundme (ULS).....	9
2.3.2 Gjendja Kufitare e Shërbyeshmërisë (SLS)	12
2.3.3 Projektimi gjeoteknik	13
2.4 Materialet e përdorura për strukturat prej betoni	14
2.4.1 Betoni.....	14
2.4.2 Çeliku i Armimit	16
3 Analiza strukturore e tombinove dhe strukturave të tjera	18
3.1 Modeli strukturor i tombinove dhe elementeve të tjerë strukturorë.....	20
3.2 Shtresa Mbrojtëse e Betonit	20
3.3 Ngarkesat.....	20
3.3.1 Ngarkesa e Përhershme e Elementëve Strukturorë	20
3.3.2 Ngarkesa e Përhershme e Elementëve jo Strukturorë	20
3.3.3 Ngarkesa e Përkohshme	21
3.3.4 Presioni i Dheut	21
3.3.5 Presioni i Ujit.....	21
3.3.6 Ngarkesa e Temperaturës.....	21
3.3.7 Ngarkesa nga Tërmeti	21
3.3.8 Kombinimet e Ngarkesave	22
3.4 Moduli i sustës së bazamentit	24
3.5 Rezultatet e analizës.....	24
4 Shtojca A: Llogaritjet e mureve mbajtës	25
A.1 Muri mbajtës b/a H=2.5m	25
5 Shtojca B: Llogaritjet e tombinove rrethore	33
B.1 Llogaritjet për tombinot rrethore $\Phi 800\text{mm}$	33
B.2 Llogaritjet për tombinot rrethore $\Phi 1500\text{mm}$	36
Referencat	39
Literatura	40

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1: Dendësia nominale e materialeve të ndërtimit	3
Tabela 2-2: Ngarkesa e automjeteve sipas EN 1991-2.....	5
Tabela 2-3: Përmbledhje e veprimeve.....	7
Tabela 2-4: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi ura	10
Tabela 2-5: Vlerat e faktorëve ψ për urat automobilistike sipas EN 1990	10
Tabela 2-6: Vlerat llogaritëse γ të veprimit	11
Tabela 2-7: Vlerat projektuese të veprimeve për situatat me ngarkesa aksidentale dhe sizmike për urat ..	11
Tabela 2-8: Kombinimi i veprimeve për SLS	12
Tabela 2-9: Vlerat projektuese të veprimeve të përdorura në kombinimet e veprimeve	12
Tabela 2-10: Faktorët e sigurisë për gjendjen kufitare të fundme për projektimin gjeoteknik	13
Tabela 2-11: Diametri maksimal i shufrave për kontrollin e plasaritjeve.....	17
Tabela 3-1: Rastet e ngarkesave	20
Tabela 3-2: Faktorët pjesorë për kombinimet e ngarkesave (ngarkesat e përhershme)	22
Tabela 3-3: Faktorët pjesorë për kombinimet e ngarkesave (ngarkesat e ndryshueshme)	22
Tabela 3-4: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, EQU (Set A)	22
Tabela 3-5: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, STR/GEO (Set B).....	22
Tabela 3-6: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, STR/GEO (Set C).....	22
Tabela 3-7: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, Sizmik	23
Tabela 3-8: Kombinimet e Ngarkesave për ULS, Aksidental	23
Tabela 3-9: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, Karakteristik	23
Tabela 3-10: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, I shpeshtë	23
Tabela 3-11: Kombinimet e Ngarkesave për SLS, thuasht i përhershëm.....	23

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1: Horografia	1
Figura 2-1: Detaje të modelit të ngarkimit 1 (LM1) për ngarkesat e trafikut.....	5
Figura 2-2: Aplikimi i sistemit "tandem" për kontrolle lokale.....	6
Figura 2-3: Modeli i ngarkesës LM2.....	6
Figura 2-4: Diagrama sforcim – deformacion për beton C25/30 në shtypje.....	16
Figura 2-5: Çeliku i armimit B500C – diagrama sforcim-deformacion e projektimit	16
Figura 3-1: Prerje tërthore e tombinos rrethore $\Phi 800$ mm dhe armimi	18
Figura 3-2: Prerje tërthore e tombinos rrethore $\Phi 1500$ mm dhe armimi	19

1 HYRJE

Segmenti rrugor “Tushemisht-Doganë” fillon në dalje të fshatit të Tushemishtit, në pjesën lindore të tij, dhe vazhdon deri në doganën e Tshemishtit, me një gjatësi rreth 0.9km. Rruga është e asfaltuar me gjerësi 6m dhe kalon në një terren kodrinor përgjatë bregut të liqenit të Ohrit. Ky segment rrugor i shërben banorëve të fshatit Tushemisht, por më tepër shërben si rrugë lidhëse kufitare midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu kjo rrugë ka tipare të theksuara të një rruge turistike për shkak të pranisë së liqenit të Ohrit dhe zonave turistike afër saj, si Tushemishti, Driloni, Shen Namumi etj.

Objekti zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në funksion të “Programit Operacional”, një program i nisur nga Qeveria Shqiptare.

Shoqëria “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. në cilësinë e Konsulentit ka nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kontratën me objekt: “Përmirësimi i segmentit rrugor Tushemisht-Dogana Shen Naum”.

Objektivat kryesorë të këtij projekti do të jenë: përmirësimi i aksesit drejt potencialeve turistike të rajonit, me qëllim përmirësimin e eksperiencës turistike, cilësisë së jetës për komunitetet si dhe mundësi për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të zonës. Projekti do të synojë të përmirësojë cilësinë dhe sigurinë e lëvizjes.

Për këtë segment rrugor është kërkuar përgatitja e projekt zbatimit.



Figura 1-1: Horografia

Llogaritjet nga ana strukturore janë bazuar në normat teknike Shqiptare, KTP dhe në standardet europiane “Eurkodet Strukture”. Struktura e veprave janë planifikuar me elemente betonarme, kryesisht të klasës C25/30. Çeliku i armimit do të jetë i klasës B500C. Veprat strukturore janë optimizuar si nga ana materiale po ashtu dhe funksionale.

2 KONSIDERATAT PËR PROJEKTIMIN STRUKTUROR DHE KRITERET E PROJEKTIMIT

2.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike

Në këtë kapitull janë dhënë kodet, standardet dhe dokumentet teknike më të rëndësishme të cilat janë ndjekur dhe respektuar gjatë procesit të projektimit.

Projektimi i urave do të bëhet në përputhje me Rregullat Teknike të Projektimit Rrugëve (RrTPRr-5_ - Urat dhe Tunelet si dhe normat Evropiane (Eurocodes).

Projektimi dhe ndërtimi i të gjithë zërave sipas fushave përkatëse përmbushin kërkesat e botimeve dhe rishikimeve më të fundit të kodeve dhe standardeve të organizmave teknike të mëposhtme:

- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor
- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet mbi struktura
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave prej betoni
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit
- KTP 2-78 Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet në zona sizmike (norma teknike për projektimin në zonat sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP N.2-98 Kushtet teknike projektimi për ndërtimet antisizmike (norma teknike për projektimin e strukturave anti-sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP 4-78 Kategorizimi dhe klasifikimi i veprave hidroteknike
- KTP 7-78 Përcaktimi i ngarkesës së erës
- KTP 8-78 Përcaktimi i ngarkesës së dëborës

Në Eurokodet strukturorë, kërkesat e projektimit jepen në lidhje me kushtet specifike të gjendjeve kufitare. Llogaritjet për të përcaktuar aftësinë e pjesëve të ndryshme për të përmbushur një gjendje të veçantë kufitare janë bërë duke përdorur veprimet llogaritëse (ngarkesa dhe deformime) dhe rezistencat llogaritëse. Vlerat llogaritëse janë përcaktuar nga vlerat përkatëse të veprimeve dhe rezistencat karakteristike të materialeve nëpërmjet aplikimit të faktorëve të sigurisë.

2.2 Veprimet

Veprimet janë marrë nga pjesët e mëposhtme të EN 1991 dhe EN 1998:

- EN 1991-1-1 Dendësia, pesha vetjake dhe ngarkesa e përkohshme
- EN 1991-1-5 Veprimet termike
- EN 1991-1-6 Veprimet gjatë ndërtimit
- EN 1991-1-7 Veprime aksidentale për shkak të goditjeve dhe shpërthimeve
- EN 1991-2 Ngarkesat e trafikut në ura
- EN 1991-3 Veprimet nga vinçat dhe makineritë
- EN 1997 Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 Eurokodi 8 (Pjesa 1 dhe 5) Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit

Një veprim i ndryshueshëm ka vlerat e mëposhtme përfaqësuese:

- Vlera karakteristike Q_k
- Vlera e kombinimit $\psi_0 Q_k$
- Vlera e shpeshte $\psi_1 Q_k$
- Vlera pothuajse e përhershme $\psi_2 Q_k$

Vlerat karakteristike dhe vlerat e kombinimeve përdoren për verifikimin e gjendjes së fundit kufitare dhe kontrollin në gjendjen e fundit të pakthyeshme të shërbyeshmërisë. Vlerat e shpeshta dhe pothuajse të përhershme përdorën për kontrollin e gjendjes së fundit kufitare duke përfshirë dhe veprimet aksidentale dhe gjendjen e fundit të kthyeshme të shërbyeshmërisë. Vlerat pothuajse të përhershme përdorën gjithashtu për llogaritjen e veprimeve me kohë të gjatë.

Vlerat projektuese të veprimeve (ngarkesave) jepen nga:

$$\text{Veprimi (ngarkesa) llogaritëse} = \gamma_F \times \psi F_k$$

ku F_k është vlera karakteristike e specifikuar, γ_F është vlera e faktorit të sigurisë për veprimin (γ_A për veprimet aksidentale, γ_G për veprimet e përhershme, γ_Q për veprimet e ndryshueshme) dhe gjendjen kufitare të marrë në konsideratë, dhe ψ është 1.0, ψ_0 , ψ_1 ose ψ_2 . Vlerat e rekomanduar të γ_F dhe ψ jepen në EN 1990 Bazat e projektimit strukturor.

Vlerat projektuese të veprimeve janë marrë nga faktorët pjesorë γ_F dhe janë kombinuar ndërmjet tyre sipas situatës projektuese, duke përmenduar kryesisht tre tipe:

- situatë e qëndrueshme projektim, e cila i referohet kushteve të përdorimit normal;
- situatë kalimtare projektimi, e cila u referohet kushteve të përkohshme të ushtruara në strukturë, p.sh. gjatë zbatimit ose riparimit;
- situatë kalimtare projektimi, e cila u referohet kushteve të jashtëzakonshme të ushtruara në strukturë ose gjatë ekspozimit të saj.

2.2.1 Pesha vetjake dhe veprimet e përhershme

Pesha vetjake e strukturës dhe komponentëve të saj llogaritet në përputhje me EN 1991 në bazë të përmasave nominale dhe vlerave karakteristike të dendësive të dhëna në EN 1991 – 1, Aneksi A – Tabelat për dendësinë nominale të materialeve të ndërtimit, dhe dendësia nominale dhe këndet e vendosjes për materialet e ruajtura. Më poshtë jepen vlerat nominale të dendësisë së materialeve të përdorura:

Tabela 2-1: Dendësia nominale e materialeve të ndërtimit

Materiali	Dendësia Nominale (kN/m ³)
Betoni (pesha normale, i pa-armuar)	24.0
Betoni (pesha normale, i armuar)	25.0
Llaç – çimento	23.0
Çelik	78.5
Zhavorr	19.0

Si ngarkesa të përhershme janë konsideruar:

Vlerat e poshtme dhe të sipërme të peshës vetjake të shtresës izoluese, shtresave asfaltike, ku ndryshueshmëria e trashësisë së tyre mund të jetë e lartë, janë marrë duke konsideruar një interval $\pm 20\%$ nëse vlera nominale merr parasysh sipërfaqen pas ndërtimit dhe $+40\%$ and -20% në rast të kundërt (EN1991-1-1 5.2.3(3)). Densiteti specifik i asfalto-betonit është marrë 25 kN/m^3 (vlera sipas EN EN1991-1-1 Annex A Tab. A6 varion 24-25 kN/m^3).

Veprimet kryesore të ndryshueshme:

Siç përkufizohen në pjesë të ndryshme të Eurokodit 1:

TS	Ngarkesa e vargut të trafikut dhe UDL ngarkesa uniformisht e shpërndarë e trafikut. Këto dy ngarkesa janë model për ngarkesën kryesore LM1 [EN1991-2];
q_{fk}	ngarkesa uniforme në trotuar [EN1991-2];
g_{ri}	grupi i ngarkesave i , lejon përkufizimin e qartë të kombinimeve të modelit të ngarkesës së ndryshueshme në plan për vërejtjen e veprimit të tyre të njëkohshëm mbi strukturë [EN1991-2];
F_w	forca nga era, F_w^* përfaqëson forcën e erës në trafik dhe F_{wk} forcën e erës në mungesë të trafikut [EN1991-1-4];
T	forca nga temperatura;
$Q_{Sn,k}$	forca nga bora [EN1991-3];
A_d	forca aksidentale;
A_{Ed}	forca sizmike;
P	paranderja si vlerë e mundshme ose si vlerë karakteristike.

Gjithashtu do të përfshihen veprimet e përhershme të mëposhtme:

- Ngarkesa nga pesha vetjake e elementeve strukturorë
- Ngarkesa nga pesha vetjake e elementeve jo-strukturorë
- Ngarkesa nga shtresat e vijës së kalimit
- Ngarkesa nga instalimet e pajisjeve të ndryshme

2.2.2 Ngarkesat e përkohshme në ura dhe tombino

Shtylla 28	1	50	50	386.104	4x10	56	400	0.64	29	0.06583	0.0024969	0.9	0.067	0.03	386.037
Shtylla 29	1	50	50	386.037	4x10	56	350	0.56	29	0.06583	0.0024969	0.9	0.058	0.03	385.979
Shtylla 30	1	50	50	385.979	4x10	56	300	0.48	29	0.06583	0.0024969	0.9	0.05	0.02	385.929
Shtylla 31	1	50	50	385.929	4x6	42	250	0.4	29	0.10962	0.0027695	0.9	0.069	0.03	385.86
Shtylla 32	1	50	50	385.86	4x6	42	200	0.32	29	0.10962	0.0027695	0.9	0.055	0.02	385.805
Shtylla 33	1	50	50	385.805	4x6	42	150	0.24	29	0.10962	0.0027695	0.9	0.041	0.02	385.764
Shtylla 34	1	50	50	385.764	4x6	42	100	0.16	29	0.10962	0.0027695	0.9	0.028	0.01	385.736
Shtylla 35	1	50	50	385.736	4x6	42	50	0.08	29	0.10962	0.0027695	0.9	0.014	0.01	385.722
Σ									1046						1.86

Figura 2-2: Figura me tabelën për llogaritjen e seksionit të linjave të ndriçimit



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

PËRMIRËSIMI I SEGMENTIT RRUGOR TUSHEMISHT-DOGANA SHËN NAUM

Raporti topografik






Korrik, 2022

KONSULENTI:

ICE | ILLYRIAN
CONSULTING
ENGINEERS

Porositësi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Konsulenti:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Objekti:	Përmirësimi i Segmentit Rrugor Tushemisht-Dogana Shën Naum
Titulli i Dokumentit:	Raporti topografik
Faza e Projektit:	Projekt Zbatimi
Kodi i dokumentit:	ICE-319-P02-V1 00

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për projekt zbatimi		08.07.2022

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Bujar Karanxha 	Olset Haxhiu Blenard Durmishi	 		
Data:	08.07.2022	08.07.2022	08.07.2022		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2022

Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
Lista e Tabelave	ii
Lista e Figurave	iii
1 HYRJE.....	1
1.1 Përshkrimi mbi Projektin.....	1
1.2 Detyrimet Kontraktuale	1
1.3 Grupet e punës	1
2 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PUNIMEVE TOPOGRAFIKE	3
2.1 Matjet GNSS	3
2.1.1 Sistemi i referimit, Rrejtë Mbështetës	3
2.1.2 GPS RTK (Real Time Kinematics).....	4
2.1.3 Paisjet	4
2.2 Punimet Fotogrametrike (UAV Survey)	5
2.2.1 Paisja.....	5

LISTA E TABELAVE

Tabela 1-1:	3
Table 2-1: A	4

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1: Pamje Grafike e zonës ku do zhvillohet Projekti.....	1
Figura 1-2: Pamje grafike e zonës ku janë vendosur pikat e bazamentit	4

1 HYRJE

1.1 Përshkrimi mbi Projektin

Qëllimi i këtij rilevimi është të paraqitet gjendja ekzistuese e rrugëve, objekteve dhe elementeve të tjerë të situacionit për qëllim Studim projektim "Tushemisht-Doganë Tushemishtit"

U morën në konsideratë që produkti përfundimtar i këtij rilevimi të paraqesë një situatë reale dhe me sa më shumë detaje të gjendjes faktike të sheshit ku pretendohet të realizohet projekti. Nuk është neglizhuar asgjë nga situacioni faktik në terren duke paraqitur çdo rrugë, pusët, mure rrethuese, rrethime, objekte ekzistuese, linja/shtylla elektrike dhe telefonie si dhe çdo gjë tjetër brenda fashës së rilevimit.

1.2 Detyrimet Kontraktuale

Qëllimi i këtij projekti është përgatitja e projektit të zbatimit për zhvillimin e kësaj zonë në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës rrugore në drejtim të pikës kufitare të Tushemisht / Shën Naum, si pjesë përbërëse të këtij projekti janë dhe punimet topogjeodezike.

Kryerja e matjeve fushore, me saktësi të shkallës 1:100 dhe 1:200 dhe 1:500 me qëllim realizimin e projektit:




Figura 0-1: Pamje Grafike e zonës ku do zhvillohet Projekti

1.3 Grupet e punës

Për kryerjen e kësaj detyre janë angazhuar 3 grupe pune, këto grupe pune janë të angazhuara për të realizuar matjet fushore me paisje marrës satelitor GNSS, gjithashtu dhe me paisje total station duke patur parasysh që në shumë zona të këtij projekti matjet me GPS janë të kufizuara për shkak të objekteve dhe bimësisë në zonë. Këto ekipe janë mbështetur nga ekipi i përpunimit të materialeve dhe të dhënave të marra në terren me dy metoda, matjet tokësore dhe fotografimin ajror të realizuar me pajisje speciale të projektuara për të arritur saktësinë e të dhënave të përpunuara brenda vlerave të lejuara të projektit.

Fillimisht janë caktuar zonat që kane prioritet nga ekipi i projektimit, ka filluar rilevimi duke vendosur pika bazamentit mbështetës, me parametrat e përshkruar me poshtë ne këtë raport, më pas duke u mbështetur në këto pika te matura me gps ka filluar puna duke rilevuar çdo gjë brenda fashës së kërkuar të rilevimit.

Vështirësitë dhe sfide gjatë kryerjes së procesit të rilevimit kanë qenë terreni i thyer. Në disa raste ka qenë e nevojshme të rikthehemi sërish të njëjtës zone për rilevim për të realizuar plotësime të mundshme që në herën e parë mund të jenë lënë për shkaqe te ndryshme.

Duke qenë se terreni ishte shumë i vështirë për tu arritur të gjitha pikat e interesit parashtruar nga projektuesi janë përdorur duke i kombinuar të gjitha llojet e pajisjeve që ndodhen ne treg, GNSS, Total Station dhe UAV (fotogrametri ajrore).

2 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PUNIMEVE TOPOGRAFIKE

Më poshtë paraqitet i gjithë procesi i punës për realizimin e këtij rievimi:

1. Matjet GNSS
2. Rievimi fotogrametrik, UAV
3. Matjet tokësore me Stacion Total

2.1 Matjet GNSS

2.1.1 Sistemi i referimit, Rrejtja Mbështetës

Për realizimin e këtij rievimi u ndërtuan 10 pika poligonometrie të emëruara nga BM1 deri në BM10 me sistem rritës nga 1.

Pikat u sinjalizuan në terren me vida metalike dhe gozhde të ngulura mirë në beton dhe pika që ekipe të tjera kanë ndërtuar në zonë duke qenë se janë në gjendje të mirë fizike në terren, në mënyrë që pajisjet që përdoren për të realizuar rievimin topografik apo dhe ato që do të përdoren në fazën e ndërtimit të rrugëve apo dhe veprave të tjera inxhinierike, të qëndrojnë kollaj dhe gjithmonë në të njëjtin pozicion. Janë zgjedhur në zona me shikueshmëri të mirë dhe në pozicione që nuk preken nga ndërhyrjet për rindërtimin e zonës.

Pika hyrëse është përdorur pika BM1, koordinatat e të cilës u përfutuan duke u mbështetur në bazat permanente ALBCORS elipsoidi GRS80 Projektioni KRGJSH2010

Sistemi i Lartësive është përdorur sistemi gjeoidi global EGM2008,

Tabela 1-1:

KOORDINATAT E STACIONEVE "T-V" KRGJSH				
NR	East	North	H	D
1	560933.956	4529874.004	724.976	BM1
2	561098.212	4530336.679	706.911	BM2
3	561484.432	4530624.384	714.196	BM3
4	561636.524	4530849.467	708.767	BM4




Figura 1-2: Pamje grafike e zonës ku janë vendosur pikat e bazamentit

Në tabelën e mësipërme jepen koordinatat e pikave të rrjetit kryesor mbështetës.

Këto pika nuk janë zhvilluar brenda ditës, por përgjatë gjithë kohës që është nevojitur për të realizuar matjet në terren gjithashtu gjatë punës është dashur që të zhvillohen shumë më shumë pika mbështetëse se këto në listë por nuk janë paraqitur në këtë tabelë.

2.1.2 GPS RTK (Real Time Kinematics)

Metoda rtk është përdorur nga ekipi I punimeve fushore për të realizuar rilevimin, ku janë marrë të gjithë elementet e stacionit. Gjithashtu kjo metode është përdorur për të matur koordinatat e pikave të orientimit të fotografive GCP (Ground Control Points) gjithashtu dhe të pikat e rrjetit mbështetës duke patur parasysh që shtrirja e zonës nuk është e madhe.

2.1.3 Paisjet

Paisjet GNSS të përdorura për realizimin e këtij rilevimi janë të specifikuar me poshtë:

Tabela 2-2: A

Quantity	CHCNAV	Base Accuracy vector prescribed by the manufacturer		Frequencies	Channels
		Hz:	V:		
3	CHC NAV i90	Hz:	8mm ± 0.5 ppm	See below	220
		V:	10mm ± 0.5 ppm	See below	

GNSS Characteristics

- 220 channels with all in view simultaneously tracked satellite signals
- GPS: L1C/A, L2C, L2E, L5
- GLONASS: L1C/A, L1P, L2C/A, L2P, L3
- Galileo: E1, E5A, E5B
- BDS: B1, B2

- SBAS: L1C/A, L5 (QZSS, WAAS, EGNOS, GAGAN)

GNSS Accuracies

- Network RTK:
 - Horizontal: 8 mm + 0.5 ppm RMS
 - Vertical: 15 mm + 0.5 ppm RMS
 - Initialization Time: < 10 s
 - Initialization Reliability: > 99.9%
- Real Time Kinematic (RTK):
 - Horizontal: 8 mm + 1 ppm RMS
 - Vertical: 15 mm + 1 ppm RMS
 - Initialization Time: < 5 s
 - Initialization Reliability: > 99.9%
- Post-processed Kinematic (PPK):
 - Horizontal: 8 mm + 1 ppm RMS
 - Vertical: 15 mm + 1 ppm RMS
- High-precision Static:
 - Horizontal: 2.5 mm + 0.1 ppm RMS
 - Vertical: 3.5 mm + 0.5 ppm RMS
- SBAS: 0.5 m RMS

Kjo paisje GNSS është e pajisur dhe me kompesatorë pjerrësie, gjë që bën të mundur matjen e pikave që më parë ishte e pa mundur të merren. Kompensatori lejon që me një pjerrësi deri në 60° të merret pika detaje duke mos kaluar saktësinë e përmendur më sipër. Në sajë të teknologjive të reja që kanë bërë të mundur rritjen e efikasitetit në terren, është realizuar dhe rilevimi i këtij projekti.

2.2 Punimet Fotogrametrike (UAV Survey)

Puna e parë e këtij procesi ishte të shënonim pikat e kontrollit në tokë, pika të cilat rilevohen dhe me pajisjet gnss, këto pika evidentohen në secilën fotografi respektive ku janë shfaqur i caktuar pozicionin në qendër të shenjës.

Misioni i krijuar është mision fotografik LINEAR ku të gjitha objektet mbas përpunimit në software të posaçëm ku më pas mund të vektorizohen të gjitha elementet me interes për projektin.

2.2.1 Paisja

PHANTOM 4 RTK

Kjo pajisje ka revolucionizuar procesin e fotografimit ajror duke qenë se është e pajisur me marres satelitor gnss duke siguruar një saktësi centimetrike të qendrës së fotografive, me këtë pajisje numri i pikave të kontrollit në tokë është më i ulët.




Figure 0-1: Saktësia e PHANTOM 4 RTK

Phantom 4 RTK, siguron saktësinë absolute në real time. P4RTK ruan te dhënat e observimet satelitore që mund të përdoren dhe më pas për procesin të mëvonshëm nëse gjatë kohës së fluturimit nuk ka sinjal RTK. P4RTK operon me software specifike për procedimin e mëvonshëm të koordinatave të qendrës së fotografive (Cloud PPK Service).

Sinjali RTK për këtë pajisje mund të sigurohet duke përdorur bazën që është projektuar për këtë qëllim D-RTK 2 ose duke përdorur N-Trip

Detajet teknike sipas pasaportës së pajisjes P4RTK janë listuar më poshtë:

- **GNSS**

Multi-Frequency Multi-System High-Precision RTK GNSS

Frequency Used:

GPS: L1/L2;
GLONASS: L1/L2;
BeiDou: B1/B2;
Galileo: E1/E5a

First-Fixed Time: < 50 s

Positioning Accuracy:

Vertical 1.5 cm + 1 ppm (RMS);
Horizontal 1 cm + 1 ppm (RMS)

1 ppm means the error has a 1mm increase for every 1 km of movement from the aircraft.

- **Kamera**

Sistem imazherie preciz

Të dhënat më të mira të fotove mund të kapen me një sensor 1-inç, 20 megapixel CMOS. Shkrepja mekanik bën që misionet e për krijimin e hartës ose kapja e rregullt e të imazheve të jenë në një qetësi dhe pa deformim pasi Phantom 4 RTK mund të lëvizë ndërsa bën fotografi pa rrezikun e turbullimit të hapjes së kamerës. Për shkak të rezolucionit të lartë, Phantom 4 RTK mund të arrijë një (GSD) prej 2.29 cm në 90 metra lartësi fluturimi. Për të siguruar që çdo Phantom 4 RTK ofron saktësi të pashembullt, çdo lente e kamerës së vet kalon përmes një procesi rigoroz të kalibrimit, me parametrat e ruajtur në metadat e secilës imazh, duke lejuar që programi pas përpunimit të përshtatet në mënyrë unike për çdo përdorues.

Sensor	1" CMOS; Effective pixels: 20 M
Lentja	FOV 84°; 8.8 mm / 24 mm (35 mm format equivalent:24 mm) f/2.8 - f/11, auto focus at 1 m - ∞
ISO Range	Video: 100 - 3200 (Auto) 100 - 6400 (Manual)

Photo: 100-3200(Auto) 100 - 12800(Manual)

Shpejteisa e shkrepjes mekanike 8 - 1/2000 s

Shpejteisa e shkrepjes elektronike 8 - 1/8000 s

Madhesia maksimale e imazhit 4864×3648 (4:3), 5472×3648 (3:2)

Video Recording Modes H.264, 4K: 3840×2160 30p

Photo Format JPEG

Video Format MOV

Me një program të integruar të planifikimit të fluturimit (GS RTK) dhe një metodë të lehtë për të mbledhur të dhëna RTK (Rrjeti RTK ntrip ose Stacioni Mobile D-RTK 2), Ekipi i punest ka një zgjidhje të plotë për çdo rrjedhë pune të rilevimit, hartografimit ose inspektimit.

Quality Report



Generated with Pix4Denterprise version 4.5.6

Important: Click on the different icons for:

- Help to analyze the results in the Quality Report
- Additional information about the sections

Click [here](#) for additional tips to analyze the Quality Report

Summary

Project	Tushemisht-Dogane
Processed	2022-06-08 14:42:58
Camera Model Name(s)	FC6310R_8.8_5472x3648 (RGB)
Average Ground Sampling Distance (GSD)	3.13 cm / 1.23 in
Area Covered	0.249 km ² / 24.8905 ha / 0.10 sq. mi. / 61.5377 acres
Time for Initial Processing (without report)	45m:43s

Quality Check

Images	median of 58095 keypoints per image	✓
Dataset	208 out of 208 images calibrated (100%), all images enabled	✓
Camera Optimization	1.2% relative difference between initial and optimized internal camera parameters	✓
Matching	median of 10347.3 matches per calibrated image	✓
Georeferencing	yes, no 3D GCP	✓

Preview




Figure 1: Orthomosaic and the corresponding sparse Digital Surface Model (DSM) before densification.

Calibration Details



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

PËRMIRËSIMI I SEGMENTIT RRUGOR TUSHEMISHT- DOGANA SHËN NAUM

Specifikimet Teknike









Korrik, 2022

KONSULENTI:



Porositësi:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Konsulenti:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Objekti:	Përmirësimi i Segmentit Rrugor Tushemisht-Dogana Shën Naum
Titulli i Dokumentit:	Specifikimet Teknike
Faza e Projektit:	Projekt Zbatimi
Kodi i dokumentit:	ICE-319-P18-V1

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
02	Për zbatim		28.07.2022

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrollloi / Miratoi:	Firmosi:	Kontrollloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Vasil Leka  Dritan Bratko  Taulant Karriqi  Enis Haveriku 	Olset Haxhiu Blenard Durmishi	 		
Data:	28.07.2022	28.07.2022	28.07.2022		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2022

Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
Lista e Tabelave	iv
Lista e Figurave	vi
1 Të Përgjithshme	1
1.1 Zbatimi i specifikimeve të përgjithshme.....	1
1.2 Topografia.....	4
1.3 Studimi i truallit.....	4
1.4 Programi i punimeve të zbatimit.....	5
1.5 Hyrjet në objekt për të punuar.....	5
1.6 Mbikëqyrja e Kontraktorit.....	6
1.7 Siguria dhe shëndeti në punë.....	6
1.8 Punimet rrugore.....	7
1.9 Kujdesi ndaj punimeve.....	9
1.10 Dëmtimet dhe ndërhyrjet.....	12
1.11 Raportimet.....	13
1.12 Koordinimi me të tjerët.....	13
1.13 Pastërtia e Kantierit të ndërtimit.....	13
1.14 Materialet dhe pajisjet.....	13
1.15 Provat.....	14
1.16 Cilësia e punës dhe tolerancat.....	16
1.17 Ngritja e kantierit.....	16
2 Punimet e Pastrimit	19
2.1 Kërkesa të përgjithshme.....	19
3 Investigimi dhe Instrumentimi	21
3.1 Të përgjithshme.....	21
3.2 Standardet e marra si referencë.....	21
3.3 Tolerancat.....	22
3.4 Regjistrimi i shpimeve.....	22
3.5 Instrumentet dhe pajisjet matëse.....	23
4 Punimet e Gërmimeve, Mbushjeve dhe Pilotave	24
4.1 Përkufizime.....	24
4.2 Standardet e marra për referencë.....	25
4.3 Pastrimi i zonës.....	26
4.4 Përgatitja e bazamentit për ndërtimin e argjinaturës.....	26
4.5 Gërmimi.....	27
4.6 Pilotat.....	34
4.7 Palankolat.....	38
4.8 Largimi i materialit të gërmuar.....	41
4.9 Kontrolli i punimeve të dheut.....	42
4.10 Mbushjet.....	43
5 Punimet e betonit	49
5.1 Të përgjithshme.....	49

5.2	Prodhimi i betonit.....	60
5.3	Procedurat e kontrollit të cilësisë	65
5.4	Kontrulli i betonit.....	67
5.5	Kallëpet e betonit	76
5.6	Waterstopet (Ndaluesit e penetrimit të ujit)	78
5.7	Sipërfaqet e përfunduara të betonit	79
5.8	Llaçi – çimentos.....	80
5.9	Tolerancat në ndërtim	80
5.10	Fugat e ndërtimit	87
5.11	Betonet vetë – ngjeshëse (Self Compacted Concrete – SCC)	87
5.12	Kërkesat shtesë që duhet të plotësojë betoni për punime të veçanta gjeoteknike	93
5.13	Betoni i parafabrikuar	96
6	Çeliku i armimit për betonin.....	97
6.1	Çeliku i armimit.....	97
6.2	Zgarat e salduara	97
6.3	Veshjet kundër ndryshkjes së armaturës	97
6.4	Armimi me fibra.....	98
7	Punimet e çelikut strukturor	100
7.1	Referencat	100
7.2	Çeliku struktural	100
7.3	Korimanot, Shkallët e shërbimit dhe Shkallët.	104
8	Drenazhet dhe punimet mbrojtëse.....	107
8.1	Drenazhet	107
8.2	Punimet mbrojtëse, gabionet	107
9	Punimet rrugore	110
9.1	Punimet paraprake, shtresat dhe nënshtresat rrugore	110
9.2	Argjinaturat (mbushja e trupit të rrugës) e rrugëve.....	113
9.3	Shtresat asfaltike	114
9.4	Tolerancat.....	120
9.5	Testet e dendësisë, C.B.R dhe të ngjeshjes	121
9.6	Gjeotekstilet	122
9.7	Sinjalistika rrugore dhe vijëzimet.....	122
10	Punimet për muret mbajtës me gur	128
10.1	Referencat	128
10.2	Materialet	128
10.3	Ndërtimi.....	129
11	Punimet e tubacioneve.....	130
11.1	Të përgjithshme.....	130
11.2	Dorëzimet	130
11.3	Sigurimi i cilësisë.....	130
11.4	Piketimi	131
11.5	Transporti	131
11.6	Ngarkim-Shkarkimi	132
11.7	Magazinimi	132

11.8	Instalimi	133
11.9	Prerja e tubave	133
11.10	Sasitë	134
11.11	Inspektimi i Punëdhënësit.....	134
11.12	Rakorderitë	134
11.13	Vendi i Originës së Materialeve	134
11.14	Lidhja me Tubacionet Ekzistues	134
11.15	Punimet e tubacioneve për furnizimin me ujë.....	135
11.16	Punimet e tubacioneve të kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe të shiut.....	145
11.17	Valvulat dhe rakorderitë	159
12	Punimet elektrike për linjën TM	166
12.1	Shtylla beton arme te centrifuguara.....	166
12.2	Izolatorë linje 10kV 12kN	169
12.3	Litar Alumin-Çeliku	171
12.4	Sistemi tokëzimit	174
13	Punimet elektrike për infrastrukturën e fibrave optike	176
13.1	Punimet me tubat	176
13.2	Dorëzimet	176
14	Punimet elektrike per NDRIÇIMIN RRUGOR	180
14.1	Sistemi ndriçimit.....	180
14.2	Linjat e furnizimit me energji elektrike.....	181
14.3	Specifikimet teknike për shtyllat e ndriçimit.....	181
14.4	Panelet elektrike.....	182
14.5	Automatet (ndërprerësit automatik të qarkut)	183
14.6	Sistemi tokëzimit	185
14.7	Infrastruktura e Tubave Fleksibël dhe Aksesorët.....	187
15	Proçedurat në arkeologjinë parandaluese	189
15.1	Përcaktime	189
15.2	Përgjegjësitë	189
15.3	Monitorimi arkeologjik gjate fazës së ndërtimit dhe raportimi	190
15.4	Sondazhet arkeologjike dhe gërmimet e shpëtimit	190
15.5	Gjetjet rastësore arkeologjike.....	190
15.6	Procedura për gjetjet rastësore	191
15.7	Dokumentimi i gjetjeve rastësore arkeologjike	192
15.8	Mbrojtja e site-ve të njohura të trashëgimisë.....	192
15.9	Teknikat e ndërtimit	192
16	Punime të tjera	193
16.1	Shkallë, platforma çeliku dhe parmakët.....	193
16.2	Shkallët metalike	193
16.3	Zgarat metalike.....	193
16.4	Shtresa e vegjetacionit (nëse përshihet në preventiv)	193

LISTA E TABELAVE

Tabela 4-1: Standardet e marra për referencë.....	25
Tabela 4-2: Vlera udhëzuese për shpejtësitë e vibrimeve që do të përdorën për vlerësimin e efekteve të vibrimeve në struktura (DIN4150-3, paragrafi 5.1).....	38
Tabela 4-3: Vlerat e pritshme të mostrave dhe shpeshtësia	42
Tabela 4-4: Specifikimet për realizimin e mbushjes.....	46
Tabela 4-5: Tolerancat në ndërtim	46
Tabela 4-6: Granulometria e materialit të mbushjes së shtratit	47
Tabela 5-1: Vlerat e rekomanduara kufitare të përbërësve dhe vetitë e betonit (Tabela F.1 – EN 206).....	50
Tabela 5-2: 27 Produktet e familjes së zakonshme të çimentos (Tabela 1 – EN 197 – 1)	51
Tabela 5-3: Kufizimet në përmbajtjen e substancave shuarese në beton	53
Tabela 5-4: Agregati i trashë për beton, kërkesat e madhësisë	54
Tabela 5-5: Agregati i imët për beton, kërkesat e madhësisë	54
Tabela 5-6: Përmbajtja e klorit në beton.....	55
Tabela 5-7: Klasat e vetive të betonit të freskët.....	56
Tabela 5-8: Rekomandime për vlerat totale të synuara të përmbajtjes së ajrit në beton	57
Tabela 5-9: Zhvillimi i rezistencës së betonit në temperaturë 20°C (Tab 16 - EN 206).....	58
Tabela 5-10: Vlerat limite të ujëthithjes së agregateve të betonit (të testuara sipas ASTM C 127 dhe 128)	58
Tabela 5-11: Klasat e dendësisë për betonet e lehta (Tab 14 - EN 206).....	58
Tabela 5-12: Sasia e shtesave të tipit 2 dhe vlerat e koeficientit “k”	59
Tabela 5-13: Saktësia e pajisjeve matëse.	61
Tabela 5-14: Tolerancat e grumbullimit të materialeve përbërëse.....	61
Tabela 5-15: Koha e heqjes së kallëpeve (kur përdoret çimento e zakonshme portland)	65
Tabela 5-16: Korrigjimi i kohës së heqjes së kallëpeve për rastin e përdorimit të çimentove të tjera përveç portland të zakonshme	65
Tabela 5-17: Shkalla minimale e marrjes së mostrave për vlerësimin e konformitetit	67
Tabela 5-18: Vlerat për verifikimin e devijimeve standarde.....	67
Tabela 5-19: Kriteri i konfirmimit për mostrat e një familjeje betoni	68
Tabela 5-20: Kriteri i konfirmimit për rezistencën në tërheqje	68
Tabela 5-21: Vlerësimi i konformitetit për klasat e konsistencës, vetitë e SCC, përmbajtjen e ajrit dhe homogjeniteti i shpërndarjes së fibrave në betonin e freskët në momentin e dërgimit	69
Tabela 5-22: Përcaktimi i përmbajtjen e fibrave, dendësinë, raportim maksimal ujë / çimento dhe përmbajtjen minimale të çimentos	70
Tabela 5-23: Kriteret e konformitetit për vlerat e synuara a për konsistencën dhe viskozitetin	71
Tabela 5-24: Numrat e pranimit për kriteret e konformitetit të dhëna në tabelën 5.19	71
Tabela 5-25: Kontrolli i pajisjeve	72
Tabela 5-26: Kontrolli i procedurave të prodhimit dhe i vetive të betonit	73
Tabela 5-27: Sipërfaqet e kallepeve të formuara.....	77
Tabela 5-28: Sipërfaqet e betoneve të përfunduara.....	78
Tabela 5-29: Veçoritë fizike për waterstop-et PVC për fugat e ndërtimit dhe diletacionit	78
Tabela 5-30: Vlerat e devijimeve vertikale të lejuara për kolonat dhe muret	80
Tabela 5-31: Vlerat e devijimeve vertikale të lejuara për kolonat dhe muret	81
Tabela 5-32: Vlerat e devijimeve të lejuara për trarët dhe soletat	82

Tabela 5-33: Vlerat e devijimeve për seksionet e elementeve.....	84
Tabela 5-34: Vlerat e devijimeve për pozicionimin e armaturës.....	84
Tabela 5-35: Vlerat e devijimeve për pozicionimin e armaturës.....	85
Tabela 5-36: Vlerat e devijimeve për pozicionimin dhe përmasat e vrimave dhe tolerancat për vendosjen e bulonave dhe pllakave të ankorimit.....	86
Tabela 5-37: Vetit e Klasave të SCC.....	90
Tabela 5-38: Lista e metodave të testimit dhe vlerat tipike për vetitë e punueshmërisë së SCC.....	90
Tabela 5-39: Karakteristika kryesore të prodhimit të SCC.....	91
Tabela 5-40: Përmbajtja minimale e çimentos dhe kokerrizave të imta për betonin e pilotave të derdhura dhe të ngulura me zhvendosje.....	95
Tabela 5-41: Përmbajtja minimale e çimentos për betonin e mureve diafragmë.....	95
Tabela 5-42: Vlerat e synuara për konsistencën e betonit të freskët në kushte të ndryshme.....	96
Tabela 6-1: Kriteret e kombinuara të identifikimit të përmbajtjes së fibrave dhe homogjenitetit të betonit të freskët.....	99
Tabela 7-1: Bashkimet me bulona.....	102
Tabela 7-2: Bulonat e ankorimit të pllakave.....	102
Tabela 9-1: Limitet e gradimit për materialet e nën bazës.....	111
Tabela 9-2: Specifikimet për materialet e nën bazës.....	111
Tabela 9-3: Kufijte e gradimit për shtresat e bazës së rrugëve.....	112
Tabela 9-4: Specifikimet për materialet e bazës.....	112
Tabela 9-5: Përbërja granulometrike dhe përqindja e bitumit në lloje të ndryshme asfaltobetoni.....	114
Tabela 9-6: Kërkesat teknike që duhet të plotësojë asfaltobetoni.....	114
Tabela 9-7: Limitet e gradimit për shtresat asfaltike të rrugës.....	119
Tabela 9-8: Limitet e gradimit për binderin.....	119
Tabela 9-9: Limitet e gradimit për bazën e asfaltit.....	120
Tabela 9-10: Tolerancat e kuotave faktike nga kuotat e kerkuara.....	120
Tabela 9-11: Parametrat teknikë të gjeotekstit të pa thurur.....	122
Tabela 11-1: Tolerancat në diametrin nominal.....	147
Tabela 11-2: Forca minimale shtypëse për njësitë e tubave të klasës së fortësisë 120, me seksion rrethor për përdorim në kanalizime.....	148
Tabela 11-3: Përmasat e zgarës së ujerave të shiut.....	158
Tabela 14-1: Karakteristikat e ndriçuesit rrugor tip.....	180
Tabela 14-2: Karakteristikat teknike të kabllave FG16OR16 0,6/1 kV.....	181
Tabela 14-3: Karakteristikat teknike të panelit.....	182
Tabela 14-4: Karakteristikat teknike e automateve magnetotermik 4P/3P+N.....	183
Tabela 14-5: Karakteristikat teknike e automateve magnetotermik 2P/1P+N.....	184
Tabela 14-6: Karakteristikat teknike të automateve diferencial të pastër 2P / 4P.....	185
Tabela 14-7: Specifikimet teknike të tubave D75 mm dhe 110 mm.....	187
Tabela 14-8: Specifikimet teknike të aksesorëve të tubave.....	187

LISTA E FIGURAVE

Figura 4-1: Mbushja e kanaleve	47
Figura 5-1: Klasat e ekspozimit ambiental.....	49
Figura 11-1: Kthimet tipike të tubave	147
Figura 11-2: Vizatimi shembull i zgarës	158
Figura 12-1: Përcjellës FeZn	174
Figura 12-2: Elektrodë tokëzimi	175
Figura 12-3: Morseta lidhëse, lidhje perçjelles FeZn-elektrode FeZn.....	175
Figura 14-1: Tipat e diferencialeve	184
Figura 14-2: Përcjellës FeZn	185
Figura 14-3: Elektrodë tokëzimi	186
Figura 14-4: Morseta lidhëse, lidhje perçjelles FeZn-elektrode FeZn.....	186
Figura 14-5: Morseta lidhëse, lidhje përcjellës FeZn-përcjellës bakri.....	187

1 TË PËRGJITHSHME

1.1 Zbatimi i specifikimeve të përgjithshme

Dispozitat e përmbajtura në këto Specifikime të Përgjithshme për Punimet Inxhinierike do të mbizotërojnë mbi dispozitat e përmbajtura në Kushtet Teknike të Projektimit, Standardet Evropiane, dhe dokumente të ngjashme standarde të deklaruar në Kontratë, **por jo mbi Ligjet Shqiptare dhe detajet apo shënimet e dhëna në Vizatimet e Projektit.**

1.1.1 Shkurtime

Shkurtime e përdorura në këto Specifikime të Përgjithshme për Punimet Inxhinierike do të kenë kuptimet e mëposhtme:

AASHTO	:	American Association of State Highway and Transportation Officials
AWWA	:	American Water Works Association
ASTM	:	American Society for Testing and Materials
BoQ	:	Preventivi ("Bills of Quantities")
BS	:	Standardi Britanik ("British Standard")
CS	:	Të dhëna grafike ("Chart Datum")
CI	:	gize ("cast iron")
CP	:	British Standard Code of Practice
CS	:	Standardi i Ndërtimi ("Construction Standard")
DI	:	gizë e deformueshme ("ductile iron")
DE	:	diametri i jashtëm ("external diametër")
DN	:	diametri nominal ("nominal diametër")
DIN	:	Deutsches Institut für Normung e.V. (Standardi Gjerman i Projektimit)
EN	:	Standardet Evropiane ("European Standards")
FGL	:	Kuota përfundimtare e tokës ("finished ground level")
KPK	:	Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
KTP	:	Kushtet Teknike të Projektimit
KTZ	:	Kushtet Teknike të Zbatimit
GS	:	Specifikimet e Përgjithshme ("General Specifications")
HDPE	:	Polietilen me densitet të lartë ("High density polyethylene")
HSFG	:	forca të mëdha fërkimi ("high strength friction grip")
IEC	:	Komisioni Ndërkombëtar Elektro – Teknik ("International Electro technical Commission")
ISO	:	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit ("International Organization for Standardization")
KTZ	:	Kushtet Teknike të Zbatimit
PD	:	Të dhëna kryesore ("Principal Datum")
PSC	:	Çimento Portland me Skorie ("Portland slag cement")
Ppm	:	pjesë për milion ("parts per milion")
PS	:	Specifikime të Veçanta ("Particular Specification")
PTFE	:	politetrafluoroetilen
PVC	:	Klorur polivinili ("polyvinyl chloride")

RHPC	:	Çimento portland me ngrirje të shpejte (“rapid hardening Portland cement”)
SCC	:	Kushte të veçanta të kontratës (“Special Conditions of Contract”)
SIS	:	Standardi Suedez
CESMM	:	Metoda standarde e matjeve në inxhinierinë civile (“Civil Engineering Standard Method of Measurement”)
SPC	:	Çimento Portland rezistente ndaj sulfateve (“Sulphate resistant Portland cement”)

Shkurtime të njësive matëse të përdorura në Specifikimet e Përgjithshme kanë kuptimet e mëposhtme:

°C	:	gradë Celsius
g	:	gram
g/ml	:	gram për mililitër
ha	:	hektar
hr	:	orë
Hz	:	Hertz
J	:	Joule
kg	:	kilogram
kHz	:	kilohertz
kJ	:	kilojoule
km	:	kilometer
Km/hr	:	kilometer për orë
kN	:	kilo Newton
kPa	:	kilopascal
kV	:	kilovolt
kW	:	kilowatt
L	:	litra
L/min	:	litra për minutë
L/s	:	litra për sekondë
m	:	metra
m ²	:	metra katrore
m ³	:	metër kub
m/s	:	metër për sekondë
Mg	:	mega gram
Mg/m ³	:	mega gram për metër kub
min	:	minutë
ml	:	millilitra
mm	:	milimetra
mm ²	:	milimetër katror
mm ³	:	milimetra kubike
mm/s	:	milimetër për sekondë
MPa	:	mega Pascal
N	:	Newton

N/mm	:	Newton për milimetër
N/m ²	:	Newton për metër katror
No.	:	numër
Pa.s	:	Pascal sekondë
r/min	:	rrotullime per minute
r/s	:	rrotullime per second
s	:	sekond
T	:	ton
µm	:	Mikro metër
%	:	përqindje

1.1.2 Provat dhe miratimet

- (1) Referenca në SP për miratimin nga ana e Mbikëqyrësit do të thotë pëlqimin nga ana e Mbikëqyrësit e dhënë me shkrim. Materialet, metodat e ndërtimit dhe çdo çështje tjetër e miratuar nga Mbikëqyrësi nuk duhet të ndryshohet pa miratimin e Mbikëqyrësit për ndryshimet e propozuara.
- (2) Provat do të kryhen siç thuhet në kontratë për të demonstruar se materialet dhe metodat e ndërtimeve do të prodhojnë një punë që është në përputhje me kërkesat e specifikuara.
- (3) Provat do të kryhen para se të fillojë punimi në mënyrë që t'i lejojë Mbikëqyrësit një periudhë të mjaftueshme për të përcaktuar nëse prova përputhet me kërkesat e specifikuara. Kontraktori do të informojë Mbikëqyrësin 24 orë para se të fillojë testimi, ose një periudhë të dakordësuar nga Mbikëqyrësi.
- (4) Provat do të kryhen duke përdorur materialet dhe metodat e ndërtimit të llojeve të miratuara nga Mbikëqyrësi, si dhe në vende të miratuara nga Mbikëqyrësi.
- (5) Nëse, për kryerjen e punimeve që janë në përputhje me kërkesat e specifikuara, kërkohet të bëhen ndryshime të veçanta të propozuara me materiale ose metoda ndërtimi të tjera (përveç atyre të specifikuara), Mbikëqyrësi do të kërkojë kryerjen e provave të mëtejshme deri në arritjen e punimeve që janë në përputhje me kërkesat, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe në Kontratë. Punimet për të cilat provat janë të nevojshme nuk do të fillojnë deri në miratimin e Mbikëqyrësit që ato përputhen me kërkesat e specifikuara.
- (6) Përveç rastit kur lejohen nga Mbikëqyrësi, materialet dhe metodat e ndërtimit që përdoren për kryerjen e punëve që kanë kërkesa të specifikuara, nuk do të ndryshohen pa u kryer teste të mëtejshme, për të treguar se ndryshimet e propozuara janë të kënaqshme.

1.1.3 Standardet Evropiane, Standardet Britanike, Kodet e Praktikave dhe standardet e tjera

- (1) Përveç rastit kur përcaktohet ndryshe në Kontratë, referencat në SP ndaj standardeve të BE, Standardeve Britanike, Kodet e Praktikave dhe të standardeve të ngjashme do të jenë në botimin e fundit.
- (2) Standardet të cilat konsiderohen të jenë të barabartë, nuk do të zbatohen pa u miratuar nga Mbikëqyrësi. Mbikëqyrësi nuk do të japë miratimin e tij deri sa Kontraktori t'i ketë dorëzuar atij një kopje të standardit përkatës për informacion. Nëse miratimi është dhënë, Kontraktori do të sigurojë dy kopjet e dokumentit për përdorim nga ana e Mbikëqyrësit.

1.1.4 Njësitë e Përdorura

- (1) Specifikimet do të jenë në njësitë SI.

1.1.5 Përmasat dhe vizatimet

- (1) Përmasat nuk do të merren nga shkalla e Vizatimeve. Përmasat që nuk tregohen në Vizatime ose që nuk llogariten nga përmasat e tjera të treguara në Vizatim, do të merren me miratim të Mbikëqyrësit.

1.2 Topografia

- (1) I gjithë piketimi do të kryhet nga Kontraktori. Meqënëse Mbikëqyrësi do ta kontrollojë piketimin, kjo nuk e çliron Kontraktorin nga përgjegjësia për saktësinë e piketimit.
- (2) Të gjitha kuotat e treguara në Vizatime i referohen Të Dhënave të Kantierit.
- (3) Autoriteti Kontraktor do të sigurojë, kur kërkohet, të dhëna të mëtejshme mbi pozicionet e pikave gjeodezike (reperat) në dispozicion dhe të kuotave.
- (4) Kontraktori do të mbajë, me shpenzime të tij, pika të tilla gjeodezike dhe stacione rievimi nqs kërkohen dhe vlerësohen të nevojshme nga Mbikëqyrësi.
- (5) Kontraktori do të vendosë vijën qendrore të rrugës dhe kanalit, në planimetri dhe në kuotë, siç ka rënë dakord me Mbikëqyrësin. Gjatë kësaj periudhe, Kontraktori do të kryejë gjithashtu kontrollin e gjendjes ekzistuese të intervaleve të prerjeve tërthore.
- (6) Me përfundimin e piketimit të vijës qendrore, Kontraktori duhet të marrë nivelet e tokës ekzistuese dhe t'ia paraqesë ato Mbikëqyrësit për kontroll dhe aprovim. Asnjë punim nuk do të bëhet derisa nivelet ekzistuese të tokës të jenë aprovuar nga ai.
- (7) Asnjë piketim i mëtejshëm nuk do të bëhet derisa Mbikëqyrësi të ketë konfirmuar vijën qendrore me ndonjë ndryshim që ai e konsideron të nevojshëm dhe të ketë përcaktuar trashësinë e shtresave. Pastaj ai do të nxjerrë udhëzimet specifike për Kontraktorin për të gjitha punimet që do të kryhen, jo më pak se 14 ditë para datës së programuar për fillimin e punimeve të seksionit përkatës.
- (8) Kontraktori do t'i referohet vijës qendrore për kontrollin tërthor, ose të japë referime shtesë në rast se stacionet e kontrollit tërthor do të ndikohen nga punimet. Linja qendrore e referimit do të vendoset me Mbikëqyrësin para fillimit të punimeve.
- (9) Kontraktori duhet t'i japë Mbikëqyrësit të gjithë ndihmën e nevojshme për kontrollin e piketimit, të niveleve dhe ndonjë rievimi ose matje tjetër të cilën Mbikëqyrësi duhet ta bëjë sipas Kontratës.

1.3 Studimi i truallit

- (1) Para fillimit të punimeve të ndërtimit në kantier, Mbikëqyrësi mund ti kërkojë Kontraktorit, me shpenzime të mbuluara nga Kontraktori, kryerjen e studimeve të truallit nëpërmjet investigimeve fushore.
- (2) Gropat e investigimit do të gërmohen me ekskavator mekanik ose me dorë. Kontraktori do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbajtur ose për të stabilizuar skarpitetet e gropës së vrojtimit dhe për të drenazuar gropat kur kërkohet për inspektim ose qëllime testimesh.

- (3) Duhet të mbahen shënime të kujdesshme për shtresat e ndryshme të hasura gjatë gërmimit, prania e ujit dhe e nivelit të ujit në gropë. Mund të kërkohen mostra përfaqësuese për secilën shtresë.
- (4) Kontraktori do të ndërmarrë, me shpenzimet e tij, vrojtime të mëtejshme që mund ti duhen për qëllimet vetjake dhe do të mbajë raporte të plota të rezultateve në dispozicion të Mbikëqyrësit.

1.4 Programi i punimeve të zbatimit

- (1) Kontraktori duhet të dorëzojë brenda 14 ditëve pas nënshkrimit të Kontratës, një program që tregon një përshkrim të detajuar të punimeve që do të ndërmerren në 3 mujorin e parë dhe një plan për punimet e mbetura. Ky program do t'i dorëzohet Mbikëqyrësit jo më vonë se 4 javë para fillimit të secilës periudhe 3 mujore vijuese.
- (2) Programet e dorëzuara në përputhje me këtë artikull do të jenë të punuara në një program dixhital të specializuar, si p.sh. MS Project ose të ngjashëm me të dhe do të tregojë datat më të fundit të fillimit dhe mbarimit të secilit aktivitet dhe rrugën kritike.
- (3) Përshkrimi i punimeve që duhet të tregohet për secilin Seksion të punimeve në programin e dorëzuar do të jetë gjithëpërfshirës. Ai do të përmbajë aktivitetet kryesore, data kryesore dhe momentet kryesore nga programi i dorëzuar dhe kërkesat e informimit nga KPK, bashkë me sa më poshtë:
 - a) Punimet që do të kryhen, duke përfshirë provat dhe komisionet.
 - b) Prodhimi, transporti dhe instalimi i materialeve që do të prodhohen jashtë Kantierit.
 - c) Dorëzimi i materialeve me origjinë nga jashtë Shqipërisë.
 - d) Aktivitetet për të cilat Investitori ose Mbikëqyrësi është i përgjegjshëm, duke përfshirë çështjen e vizatimeve dhe informacioneve të tjera, sigurimi i materialeve nga Investitori, nominimi dhe miratimi i Nën – Kontraktorëve të nominuar dhe konsiderimi dhe miratimi i vizatimeve të propozuara, dhe
 - e) Punimet që do të ndërmerren nga Departamentet Shtetërore, Ndërmarrjet e Shërbimeve Komunale dhe Kontraktorë të tjerë.
- (4) Kontraktori do të jetë përgjegjës për përgatitjen, koordinimin dhe pranimin e një programi për punët e ndërmarrjeve dhe shërbimeve komunale. Kontraktori do të bëjë kompensimin e plotë për kohën dhe sigurimin e objekteve për ndërmarrjet në përgatitjen e programeve të tij.

1.5 Hyrjet në objekt për të punuar

Të gjitha punimet e nevojshme për të hyrë në objekt do të bëhen nga Kontraktori me shpenzimet e tij. Punëdhënësi nuk ka asnjë përgjegjësi për kushtet apo mirëmbajtjen e ndonjë rruge ekzistuese apo strukture që mund të përdoret nga Kontraktori për kryerjen e punimeve nën këtë kontratë dhe për udhëtimet në dhe nga Objekti. Asnjë pagesë nuk do të bëhet tek Kontraktori për ndërtimin, përmirësimin, riparimin apo mirëmbajtjen e ndonjë rruge ekzistuese që mund të përdoret nga Kontraktori për kryerjen e punimeve nën këtë kontratë përveç rasteve kur jepen në Preventiv.

Kontraktori duhet të përgatitë me shpenzimet e tij çdo facilitet për hyrjet e përkohshme në objekt (rrugë, strukture etj.) që mund të kërkohen për qëllime ndërtimi nga Mbikëqyrësi. Facilitete të tilla do të jenë për zgjerimin dhe qëndrueshmërinë e duhur për të lejuar lëvizjen e të gjitha makinerive dhe pajisjeve si dhe mirëmbajtjen nga Kontraktori në kushte të mira dhe të shërbyeshme gjatë periudhës së ndërtimit.

Punëdhënësi dhe Mbikëqyrësi si dhe punonjësit e tyre se dhe ata të Kontraktorëve të tjerë që do të punojnë në objekt për Mbikëqyrësin do të përdorin falas facilitetet e ndërtuara nga Kontraktori.

1.6 Mbikëqyrja e Kontraktorit

- (1) Kontraktori do të punësojë në terren për zbatimin e punimeve Ekspertë Arkitektë dhe Inxhinierë për të gjitha disiplinat që lidhen me zbatimin e projektit të cilët do të kenë kualifikimin dhe licencat përkatëse ose të jenë nën mbikëqyrjen e një eksperti të kualifikuar.
- (2) Arkitektët/Inxhinierët do të qëndrojnë në kantier gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve që lidhen me disiplinën e tyre.

1.6.1 Veçoritë e inspektorëve dhe të të punësuarve

- (1) Të dhënat vijuese të Mbikëqyrësit të propozuar, do t'i dorëzohen Mbikëqyrësit:
 - a) emri,
 - b) Kopjen e pasaportës së vlefshme ose letërnjoftimit,
 - c) detajet e kualifikimeve, duke përfshirë kopjet e certifikatave, dhe
 - d) të dhënat e përvojave të mëparshme.
- (2) Të dhënat e Mbikëqyrësit do të dorëzohen për miratim ndersa dhe të dhënat e topografit dhe përgjegjësit për punët e betonit do të dorëzohen për informacion.
- (3) Të dhënat e agjentit do të dorëzohet brenda 7 ditëve nga data e fillimit të punimeve. Të dhënat e topografit dhe përgjegjësit për punimet e betonit do të dorëzohet brenda 7 ditëve nga data e emërimit të tyre.

1.7 Siguria dhe shëndeti në punë

- (1) Do të zbatohen dhe do të ndiqen të gjitha rregullat dhe udhëzimet e dhëna në Ligjin Nr.10 237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë".
- (2) Një kopje e dokumenteve të mëposhtme do të mbahen në terren:
 - a) Rregullorja e Kantierit të Ndërtimit (Sigurisë), e bazuar në normat Shqiptare ose Evropiane të ndërtimit.
 - b) Një Udhëzues për Rregulloren e Kantierit të Ndërtimit (Sigurisë).
 - c) Libri i instruktimit teknik
 - d) Dokumenti i vlerësimit të riskut
 - e) Kartelat mjekësore të punonjësve
 - f) Regjistri i aksidenteve në punë
 - g) Plani i emergjencës së evakuimit.
- (3) Sigurimi i pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse personale të duhura të sigurisë në punë duke përfshirë sipas nevojës helmetat e sigurisë, syze, mbrojtëse të veshit, rripa të sigurisë, pajisjeve të sigurisë për shpëtim nga mbytja, aparatet fikëse të zjarrit, pajisjet e ndihmës së parë dhe pajisje të tjera të nevojshme të sigurisë do të jenë në dispozicion në kantier në çdo kohë.
- (4) Pajisjet e sigurisë, skelat, platformat, shkallët dhe mjetet e tjera të aksesit, dhe pajisjet e ndriçimit, sinjalizimit dhe ruajtjes do të inspektohen dhe mirëmbahen rregullisht. Dritat dhe shenjat do të mbahen të pastra dhe lehtësisht të lexueshme. Pajisjet të cilat janë të dëmtuara, të pista, të keq pozicionuar ose jo në gjendje pune do të riparohen ose zëvendësohen menjëherë.
- (5) Tabelat paralajmëruese dhe shënimet udhëzuese për sigurinë në shqip dhe anglisht do të vendosen dukshëm në kantier, makineritë, panelet e kontrollit dhe vende të tjera të ngjashme me këto.

- (6) Kontraktori do të emërojë një Koordinator të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë i cili do të përgatisë një Plan të Përgjithshëm të Sigurisë për Punimet dhe Deklaratat specifike të Metodologjisë për secilin aktivitet. Plani i Përgjithshëm i Sigurisë do t'i dorëzohet Mbikëqyrësit për miratim dy javë pas nënshkrimit të kontratës, ndërsa Deklaratat e Metodologjive do t'i dorëzohen Mbikëqyrësit të paktën një javë përpara punimeve përkatëse të parashikuara. Mosmiratimi i Deklaratave të Metodologjive nga mbikëqyrësi, për shkak të pamundësisë së kontraktorit për të siguruar punë profesionale dhe të sigurt, nuk do të përbëjë bazë për ankesa.

1.8 Punimet rrugore

1.8.1 Rrugët ekzistuese

Kontraktori duhet të marrë masa të veçanta për të garantuar sigurinë e trafikut dhe të këmbësorëve në kryqëzimet e rrugëve të aksesit në zonat e punimeve me rrugët publike. Në veçanti, lëvizja e makinerve të rënda duhet të kontrollohet në këto kryqëzime sipas kërkesave të Bashkisë dhe Mbikëqyrësit.

Kontraktori duhet të garantojë devijimet e përkohshme të rrugëve të lidhura me ndonjë punim, për të pasur një kalim të sigurt të trafikut në çdo kohë. Pavarësisht nga masat për devijimin e rrugëve të miratuara nga Mbikëqyrësi, Kontraktori do të jetë plotësisht i përgjegjshëm për përshtatshmërinë dhe sigurinë e devijimeve. Kostoja e devijimeve duhet të jetë e përfshirë në vlerën e vendosur në ofertë.

1.8.2 Miratimi për rregullimin dhe kontrollin e trafikut të përkohshëm.

- (1) Përveç çdo kërkesë tjetër të përmendur në Kontratë, rregullimet e trafikut të përkohshëm do të jenë në përputhje me kushtet dhe kufizimet e imponuara nga Ligji Shqiptar, Bashkia dhe zyra Lokale e Policisë. Ndriçimi i përkohshëm, sinjalistika, ruajtja dhe kontrolli i rregullimit të trafikut do të jetë në përputhje me kushtet dhe kufizimet e imponuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- (2) Kontraktori do të bëjë të gjitha përgatitjet e duhura dhe të marrë lejet e duhura nga Bashkia dhe çdo autoritet tjetër i lidhur me punimet për rregullimet dhe kontrollin e përkohshëm të trafikut.

1.8.3 Rregullimi dhe kontrolli i përkohshëm i trafikut

- (1) Në vendet ku punimet në rrugë dhe në trotuare ndërpresin lëvizjet ekzistuese të mjeteve dhe kalimtareve do të sigurohen shmangie të përkohshme të trafikut dhe rrugëve të kalimtareve. Punimet përkatëse nuk do të fillojnë derisa të jetë ndërmarrë rregullimi dhe kontrolli i përkohshëm i miratuar i trafikut.
- (2) Rregullimet dhe kontrolli i përkohshëm i trafikut për punimet rrugore dhe në trotuare do të përputhën me kërkesat e paraqitura nga rregullorja Shqiptare në lidhje me këtë çështje.
- (3) Sinjalet e përkohshme me drita për trafikun do të jenë të një tipi të miratuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
- (4) Rregullimi dhe kontrolli i përkohshëm i trafikut do të inspektohet dhe mirëmbahet rregullisht, si gjatë ditës dhe natës. Dritat e trafikut, dritat dhe sinjalet do të mbahen të pasta dhe lehtësisht të lexueshme. Pajisjet që janë të dëmtuara, të pista, keq të pozicionuara ose jo në gjendje punë, duhet të rregullohen ose të zëvendësohen menjëherë.

1.8.4 Veçoritë e rregullimit dhe kontrollit të përkohshëm të trafikut

Për lëvizjen e mjeteve në akset rrugore afër kantierit duhet të hartohet "Plani i Menaxhimit të Trafikut" i cili duhet të jetë i shoqëruar me sinjalistikën e nevojshme dhe skemat tip të sinjalistikës sipas manualit për punime të ndryshme.

Plani i menaxhimit të trafikut do t'i paraqitet Mbikëqyrësit për miratim, të paktën 7 dite para zbatimit të rregullimit dhe kontrollit të trafikut dhe duhet të përmbajë, por jo të kufizohet në sa më poshtë:

- a) Detaje të shmangieve të trafikut dhe rrugëve të këmbësoreve,
- b) Detaje të ndriçimit, sinjalistikës, ruajtjes dhe masave për kontrollin e trafikut dhe pajisjeve dhe çdo kusht dhe kufizim të imponuar nga Bashkia ose autoritetet përkatëse, duke përfshirë kopje të kërkesave, korrespondencave dhe miratimeve.

Plani i menaxhimit të trafikut do t'i dorëzohet Bashkisë dhe zyrës Lokale të Policisë ose Autoriteteve të tjera Publike nëse juridiksioni i punimeve është detyrë e tyre.

1.8.5 Përdorimi i rrugëve dhe trotuareve

Nëse nuk deklarohet me anë të vërtetimit nga Bashkia dhe/ose vërtetimeve nga Zyra të tjera Publike:

- (1) Rrugët dhe trotuaret përgjatë zonës së kantierit ku nuk zhvillohen punime do të mbahen në një gjendje të pastër dhe të kalueshme dhe nuk do të përdoren për të depozituar materiale apo për të vendosur mjetet e ndërtimit apo mjete të tjera.
- (2) Do të merren masa për të parandaluar hyrjen e materialeve të gërmuar, baltës apo mbeturinave në sistemin e kullimit në rrugë dhe trotuare; kalimi i ujit në kanal nuk do të pengohet.
- (3) Rrugët që të çojnë në kantier nuk do të përdoren nga mjete me zinxhirë përveç rasteve kur është siguruar mbrojtja e duhur ndaj dëmtimeve.
- (4) Mjetet e ndërtimit dhe mjetet e tjera që dalin nga kantieri do të jenë të ngarkuara në një mënyrë të atillë që materialet e gërmuara, mbeturinat ose mbetjet të mos depozitohen në rrugë; ngarkesat do të jenë të mbuluara ose të mbrojtura që të parandalohet shpërndarja e pluhurave. Rrotat e mjeteve të ndërtimit dhe mjeteve të tjera do të lahen nëse është e nevojshme para se të largohen nga kantieri për të mënjeluar depozitimin e baltës apo mbeturinave në rrugë.

1.8.6 Punimet në rrugë dhe trotuare

- (1) Puna në rrugë në kantier do të kryhet në seksione të tilla që gjatësia e rrugës e zënë në çdo kohë nuk e kalon atë të shprehur në kontratë dhe gjerësia e rrugës e zënë në çdo kohë nuk e kalon gjerësinë e një vije kalimi përveç se kur lejohet nga Mbikëqyrësi dhe Autoritetet Lokale. Puna në çdo seksion do të përfundojë dhe rruga do të të rivendoset dhe të hapet për trafikun para fillimit të punimeve në seksionin tjetër. Puna në çdo seksion, duke përfshirë ngarkimin dhe shkarkimin, do të kryhet në mënyrë të tillë që trafiku dhe shërbimet në rrugët e afërta dhe trotuaret të qëndrojnë në mënyrë adekuate.
- (2) Para se të kryhen gërmime në rrugë ose trotuare, përveç zonave të mbuluara me blloqe ose pllaka, kufijtë e zonës që do të rindertohen do të kufizohen nga një vijë e prerë me sharrë. Vija e prerë do të jetë të paktën 6 mm e gjerë dhe të paktën 50 mm thellë. Prerja dhe shkëputja e rrugës apo trotuarit do të kryhet në mënyrë të tillë që rruga ngjitur apo trotuari, duke përfshirë skajet, të mos dëmtohet.
- (3) Materialet e gërmuara nuk do të ruhen në afërsi të gërmimeve në rrugë apo trotuare nëse nuk lejohet nga Mbikëqyrësi.

- (4) Hyrja e automjeteve përgjatë gjurmëve në rrugë do të sigurohet nga platforma çelikut. Platformat do të jenë të projektuara sipas Eurokodit 3 ose EN 1993-1-1:2005+A1:2014 dhe do të sigurohen në vendosje dhe të kenë shtresë kundër rrëshqitjes në mënyrë që vlerat e rezistencës në rrëshqitje në mbulesat të matura sipas EN 1436:2007+A1:2008 të jenë jo më pak se 45. Platforma të mjaftueshme çeliku do të mbahen në kantier ngjitur me gjurmët në rrugë për të lejuar kalimin e automjeteve përmes gjurmëve në rast emergjence.

1.8.7 Rikthimi në gjendjen ekzistuese të rrugëve dhe trotuareve

- (1) Nëse nuk deklarohet ndryshe nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ose Autoritet Lokale: Shmangiet e përkohshme, kalimet e këmbësoreve dhe ndriçimi, sinjalistika, ruajtja dhe pajisjet e kontrollit të trafikut do të largohen menjëherë pasi ato nuk janë më të nevojshme. Rrugët, trotualet dhe objektet e tjera të ndikuara nga rregullimi dhe kontrolli i përkohshëm i trafikut do të rikthehen në gjendjen ekzistuese para fillimit të punimeve ose në një gjendje tjerët që mund të jetë miratuar ose udhëzuar nga Mbikëqyrësi.

1.9 Kujdesi ndaj punimeve

1.9.1 Mbrojtja nga uji

- (1) Në rast se nuk lejohet ndryshe nga Mbikëqyrësi, të gjitha punimet do të ndërmerren sa më shpejt të jetë e mundur në varësi të rrethanave, në kushte të thata, përveç rasteve kur punimet priten të kryhen në ujë ose në prezencë uji ose të një fluidi tjetër.
- (2) Punimet, duke përfshirë edhe materialet që do të përdoren, aty ku është e nevojshme dhe sa më shpejt të mundur, duhet të behën pa prezencë uji dhe të mbrohen nga dëmtimet për shkak të ujit. Uji i pranishëm në zonen e Punimeve dhe uji që rrjedh brenda kesaj zone () duhet të largohet me anë të kullimeve të përkohshme, sistemeve të pompimit ose me anë të metodave të tjera që bëjnë të mundur kryerjen e punimeve pa ujë dhe të mbrojtura nga dëmtimet për shkak të ujit. Balta dhe mbeturinat duhet të filtrohen para se uji të shkarkohet nga zona e ndertimit.
- (3) Vendet e shkarkimit të kullimeve të përkohshme dhe sistemeve të pompimit do të jene siç janë miratuar nga Mbikëqyrësi. Kontraktori do të marrë të gjitha masat dhe të marrë miratimet e nevojshme dhe inspektimet nga autoritetet përkatëse për shkarkimin e ujërave në kanale, rrjedha uji ose në det. Punimet përkatëse nuk do të fillojnë para kryerjes së rregullimeve të miratuara për heqjen e ujërave.
- (4) Duhet të merren masa për të parandaluar përmbytjet e strukturave të reja dhe ekzistuese.

1.9.2 Mbrojtja nga kushtet atmosferike

- (1) Punimet nuk duhet të kryhen në kushte të një moti që mund të ndikojë negativisht punimet përveç rasteve kur është siguruar mbrojtje me anë të metodave të miratuara nga Mbikëqyrësi.
- (2) Punimet e përhershme, duke përfshirë edhe materialet për punimet e përhershme, do të mbrohen nga ekspozimi ndaj kushte të motit që mund të ndikojnë negativisht në punime me metoda të miratuara nga Mbikëqyrësi.

1.9.3 Mbrojtja e punimeve të përfunduara

- (1) Punimet e përfunduara duhet të mbrohen nga dëmtimet që mund të lindin nga gjurmimi i punimeve ngjitur, me metoda të miratuara nga Mbikëqyrësi. Punimet duhet të kryhen në një

mënyrë të tillë që punimet e kryera nga palë të tjera, duke përfshirë Departamente Shtetërore, Ndërmarrjet e Shërbimeve dhe Kontraktorë të tjerë, të mos dëmtohen.

1.9.4 Dëmtimet dhe ndërhyrjet

Ky seksion mbulon sigurimin e materialit, prodhimin, transportin dhe vendosjen e sinjaleve rrugore sipas udhëzimeve të Mbikëqyresit dhe aplikimin e vijëzimeve të trafikut në rrugën e përfunduar.

9.7.1 Sinjalistika Vertikale

Konsiston në furnizimin dhe vendosjen e shenjave rrugore në përputhje me specifikimet e mëposhtme, pozicionimin dhe dimensionet e treguara në vizatim si dhe sugjerimet e bera nga Mbikëqyresi.

Të gjitha shenjat duhet të bazohen në ngjyrë, përmasë, formë, simbol dhe shkrim, në Kodin Rrugor në fuqi dhe Regulloren e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

9.7.1.1 Materialet

Materiali i prodhimit të shenjave rrugore mund të jetë fletë çeliku e galvanizuar ose fletë alumini.

9.7.1.1.1 Fletët e celikut

Fletët e çelikut duhet të jetë në përputhje me kërkesat e BS 863.

9.7.1.1.2 Mbështetëset prej çeliku.

Shtylla e mbështetjes së tabelës duhet të jetë tub çeliku i galvanizuar dhe me gjatesi nga 3.5 m deri 5m, me diametër nominal 50 mm dhe trashësi 5mm në përputhje me kërkesat e BS 1387. Ajo duhet të vendoset në rrugë sipas mënyrës së përcaktuar në vizatim, duke u betonuar në një bazament betoni të klasës C20/25.

Kur shtyllat përdoren me fletë alumini, duhet të përdoren shtrengueset e duhura për të shmangur korrozionin në pikat e kontaktit.

9.7.1.1.3 Fletët e aluminit

Trashësia e fleteve të aluminit duhet të jetë minimumi 1.3 mm dhe duhet të jetë në përputhje me kërkesat e BS 1470.

9.7.1.1.4 Mbështetëset prej alumini.

Shtyllat mbështetëse prej alumini duhet të jenë të seksioneve të tilla që ti përshtaten sipërfaqes së shenjave dhe duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BS 1474.

9.7.1.1.5 Betoni

Betoni duhet të jetë i klasës C20/25.

9.7.1.1.6 Boja

Përveç kur janë specifikuar sipërfaqet reflektuese, sipërfaqja e sinjaleve rrugore nuk duhet të jetë tepër e shkëlqyeshme. Nuk duhen përdorur elemente hollues në përzierjen e bojës.

9.7.1.1.7 Prodhimi i fletëve dhe mbështetjeve të tabelave rrugore.

Fletet e tabelave rrugore do të prodhohen nga pllaka metalike sipas përmasave, modeleve dhe ngjyrave të dhëna siç përshkruhet në vizatimet përkatëse. Tabelat duhet të kenë aftësi fotometrike sipas klasit 1 dhe 2 të parashikuar në Kodin Rrugor.

Tabelat rrugore duhet të jenë të prodhimeve të miratuara dhe nëse kërkohet, Kontraktori do të informojë Mbikëqyresin mbi metodat e prodhimit.

Të gjitha saldimet e punimeve të çelikut duhet të kryhen në përputhje me standardet e përcaktuara në BS 1856, BS 693 ose BS 5135, cilado që të jetë e aplikueshme.

Pjesa e pasme e faqes së sinjalit dhe mbështetësja e sinjaleve duhet të lyhet me ngjyrë gri. Aty duhet të shënohet:

- Enti pronar i rrugës
- Marka e firmës prodhuese të sinjalit
- Viti i prodhimit dhe numri i lejes së dhënë nga Ministria e Transportit

Sipërfaqja e shënimeve të mësipërme nuk duhet të kalojë 200 cm katrore.

Për të gjithë paqartësitë Kontraktori duhet të bashkëpunojë me inxhinierin e ngarkuar për mbikëqyrjen e projektit në zbatim.

9.7.1.1.8 Ruajtja dhe trajtimi

Të gjitha shenjat rrugore ose pjesët e shenjave rrugore duhet të trajtohen dhe të ruhen në mënyrë të tillë, që të parandalohet çdo deformim i përhershëm ose dëmtim i sipërfaqeve të lyera.

Të gjitha Sipërfaqet e palyera dhe punimet metalike duhet të mbrohen nga korrozioni.

Çdo shenjë e dëmtuar do të riparohet ose zëvendësohet me shpenzimet e Kontraktorit.

9.7.1.2 Montimi i shenjave rrugore.

9.7.1.2.1 Pozicioni

Shenjat rrugore do të montohen në pozicionet e treguara nga Mbikëqyrësi. Mënyra e vendosjes së tabelës në mbajtësen e saj të jetë siç është treguar në figurë duke respektuar dimensionet.

9.7.1.2.2 Gërmimet dhe mbushja.

Gërmimet për montimin e shenjave rrugore duhet të jenë të përmasave të mjaftueshme për të lejuar vendosjen e duhur të shenjës dhe mbushjen e përshtatshme. Gërmimet duhet të mbushen me beton të klasës C20/25, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikëqyrësi.

9.7.1.2.3 Montimi (ngritja)

Shenjat rrugore do të montohen siç tregohet ose drejtohet nga Mbikëqyrësi. Gjatë montimit, punimet metalike duhet të jenë të zbatuara saktë dhe të mbrojtura, në mënyrë që të mos dëmtohen nga punimet e montimit ose nga pajisjet e përdorura për montim.

9.7.1.2.4 Saldimet në terren.

Të gjitha saldimet e bëra gjatë montimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat për saldim gjatë prodhimit.

9.7.1.2.5 Mbrojtja dhe mirëmbajtja

Të gjitha vendet ku punimet e bojatisjes janë dëmtuar gjatë montimit do të ribëhen si duhet, nga Kontraktori me shpenzimet e veta, derisa të plotësohen kërkesat e Mbikëqyrësit.

Kontraktori duhet të mbrojë shenjat rrugore të përfunduara nga të gjitha dëmet (veshjen e duhur dhe sipërfaqen e rregullt) derisa ato të pranohen përfundimisht nga Klienti dhe do të mirëmbajë shenjat rrugore derisa të lëshohet certifikata e mirëmbajtjes. Dëmtimet ose defektet e shkaktuara nga puna e gabuar ose neglizhenca, do të riparohen si duhet nga Kontraktori me shpenzimet e tij derisa të plotësohen kërkesat e Mbikëqyrësit.

9.7.2 Vijëzimet horizontale të rrugës

9.7.2.1 Materialet

Rregulli i përgjithshëm lidhur me materialet është që këto të fundit të prodhuara në formë industriale apo artizanale përpara se të përdoren në kantier duhet që një mostër ti paraqitet Mbikëqyrësit. Pas miratimit të Mbikëqyrësit këto materiale dhe kryesisht boja e vijëzimit do të mund të përdoret për vijëzimin e rrugës

9.7.2.2 Pajisjet

Pajisjet duhet të përbëhen nga: një aparat për pastrimin e sipërfaqes së rrugës, një makinë mekanike për lyerjen dhe të gjitha pajisjet shtesë të përdorura me dorë për të përfunduar punën. Makina mekanike e

vijëzimit të rrugës duhet të jetë e projektuar në mënyrë të tillë, që të jetë e aftë të lyejë vijëzimet rrugore në një gjerësi uniforme brenda tolerancave të specifikuara.

9.7.2.3 Boja për vijëzimet rrugore

Kontraktori, para se të aplikojë bojën, duhet ti dorëzojë Mbikëqyresit për miratim, specifikimin e prodhuesit i cili tregon se boja përputhet me kërkesat e specifikuara.

Boja e vijëzimit reflektuese duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

Karakteristika të Përgjithshme: Boja e vijëzimit duhet të jetë e parapërzier, dmth sferat e xhamit duhet të jenë përzier gjatë fabrikimit, të jenë homogjene, nuk duhet të ketë papastërti. Sferat e xhamit pas tharjes së bojës duhet të japin një ndriçim në mënyrë që dritat e automjeteve të thyhen nga këto të fundit.

Ngjyra: Duhet të jetë e bardhë ose e verdhë në konformitet me atë të kërkuar. Ngjyra duhet të ruhet në kohë.

Pigmenti: Për bojën e bardhë pigmenti kolorant do të përbëhet nga bioksidi i titanit. Për ngjyrën e verdhë pigmenti do të përbëhet nga kromati i plumbit.

Pesha specifike dhe stabiliteti: Boja e hedhur nuk duhet të absorbojë vajra apo substanca të tjera duke formuar njolla të ndryshme dhe sidomos gjatë muajve të verës nuk duhet të futet dhe të përzieret me bitumin. Pesha specifike nuk duhet të jetë më pak se 1.5 kg për litër në temperaturën 25 grade celcius.

Koha e tharjes: Nuk duhet të kalojë të 30 minutat në kushte temperature 30 grade celcius, në kushte lagështire relative 65 % për spesorë rreth 200 mikron. Pas kalimit të kësaj kohe boja nuk duhet të hiqet nga gomat e makinave.

Viskoziteti: Duhet të jetë nga 70 – 90 njësi krebs

Mbetja e pa avullueshme: Duhet të jetë nga 65 – 75 % në peshë.

Sferat e xhamit: Duhet të jenë transparente dhe rreth 90 % e tyre duhet të kenë formë sferike dhe jo ovale. Treguesi i reflektimit nuk duhet të jetë më pak se 1.5.

Ashpersia: Koeficienti i ashpërsisë sipas metodës së matur nga TRL angleze nuk duhet të jetë më pak se 60% e ashpërsisë sw rrugës së palyer.

Karakteristikat Fiziko-Kimike:

Masa volumore	1.7 kg/l
Mbetje jo te avullueshme	75% ne peshe
Viskoziteti	89/90 KU
Përmbajtja e pigmentit në bojë	35 %
Përmbajtja e dyoksidit të titanit në bojë	16 % ne peshe
Koha e tharjes (hapja e rrugës trafikut)	30 min
Fuqia mbuluese	1.3 m ² /kg
Rrëshqishmëria	S.R.T. 44
Përmbajtja e sferave në bojë	20% e peshes

Granulometria e sferave

Kalimi në sitën ASTM nr 70 : 100%

Kalimi në sitën ASTM nr 140: 22 %

Kalimi në sitën ASTM nr 230 : 0.84 %

Karakteristikat e Solventit. Solventi i mirë është ai i përbërë nga Benzene Toluenee Xilene max 45%. Përzjerja e diluentit me bojën duhet të jetë jo më tepër se 4%.

9.7.2.4 Kufizimet e motit

Boja e vijëzimeve rrugore nuk duhet të aplikohet në një sipërfaqe të lagur ose kur lagështia relative është mbi 80% ose në temperatura më të ulëta se 10°C.

9.7.2.5 Prgatitja e sipërfaqes

Vijëzimet e rrugës do të aplikohen mbi sipërfaqen e asfaltit vetëm pasi të ketë kaluar koha e mjaftueshme në mënyrë që të mos shkaktohet dëm në sipërfaqen e lyer nga substancat e paqëndrueshme që avullojnë nga sipërfaqja bituminoze. Në asnjë rast vijëzimet rrugore nuk duhet të zbatohen, deri në të paktën 48 orë pas përfundimit të shtrimit të sipërfaqes bituminoze.

Para se të aplikohet boja, sipërfaqja duhet të jetë e thatë dhe plotësisht e paster nga çdol loj pluhuri, dheu, yndyre, vaji, acidi ose ndonjë material tjetër që mund të dëmtojë lidhjen ndërmjet bojës dhe sipërfaqes. Pjesët e sipërfaqes ku do të aplikohet boja duhet të pastrohen siç duhet me fshesa specifike ose me ajër të ngjeshur, nëse kërkohet. Sipërfaqet që nuk mund të pastrohen në mënyrë të kënaqshme nga ajri i kompresuar, duhet të pastrohen me solucion uji 10% fosfatit tri-natriumi sipas peshës ose një përgatitje të ngjashme të miratuar nga Mbikëqyrësi.

Pas pastrimit të sipërfaqes, solucionin duhet të shpërlahet me ujë dhe sipërfaqja duhet mbrojtur përsëri nga papastërtitë gjatë tharjes.

Heqja e sinjalistikës horizontale ekzistuese me anë të makinerive abrasive duhet të bëhet me kujdes për të mos dëmtuar sipërfaqen e rrugës.

9.7.2.6 Piketimi i vijëzimeve rrugore.

Vijat, simbolet, figurat ose shenjat duhet të piketohen me anë të njollave të bojës të së njëjtës ngjyrë me vijat dhe shenjat përfundimtare të propozuara. Këto shenja mbi sipërfaqe duhet të jenë në intervale të tilla që të sigurojnë, që shenjat përfundimtare të rrugës të mund të zbatohen me saktësi dhe në asnjë rast nuk do të jenë më larg se 1.5 m nga njëra-tjetra.

Dimensionet dhe pozicionet e shenjave të rrugës duhet të jenë sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit.

9.7.2.7 Aplikimi i bojës.

Boja do të aplikohet si figura, shenja, shkrime, simbole, vija të ndërprera ose të pandërprera ose shenja të tjera sipas nevojës.

Kur boja zbatohet me anë të një makine, ajo do të aplikohet në një shtresë. Përpara se makineria e vijëzimit të rrugës të përdoret për vijëzimin përfundimtar, cilësia e punës së makinës do të demonstrohet në një vend të përshtatshëm që nuk është pjesë e punimeve përfundimtare. Rregullimet e makinerisë do të pasohen nga testime të mëtejshme. Vetëm kur makineria të jetë rregulluar saktë dhe përdorimi i saj është miratuar nga Mbikëqyrësi pas testimit, ajo mund të përdoret për realizimin e punës finale.

Boja do të aplikohet pa shtimin e holluesve.

Kur lyerja bëhet me dorë, boja duhet të aplikohet në dy shtresa dhe shtresa e dytë nuk duhet të zbatohet përpara se shtresa e parë të jetë tharë mjaftueshëm.

Aplikimi i vijëzimit duhet të bëhet në sipërfaqe të thata dhe me mjete sa më të vogla në mënyrë që të mos pengojë lëvizjen e trafikut.

9.7.2.8 Aplikimi i sferave reflektuese ("ballotini")

Kur kërkohet bojë reflektuese, duhet të aplikohen sfera prej qelqi reflektues me anë të një makinerie të përshtatshme menjëherë pas aplikimit të bojës në një proces të vazhdueshëm. Shkalla e aplikimit të sferave reflektuese do të jetë 0.8 kilogram për litër bojë ose një normë tjetër siç mund të përcaktohet nga Mbikëqyrësi.

Nuk duhet të përdoren makineri që i aplikojnë sferat vetëm me anë të gravitetit. Ato duhet të futen në shtresën e bojës.

9.7.2.9 Instalimi i sy-maceve ("Cat's eyes")

Sy-macet do të instalohen sipas vizatimeve ose sipas udhëzimit të Mbikëqyrësit.

Lloji i syrit reflektues të përdorur duhet të jetë në përputhje me specifikimet e fundit të Kodit Rrugor dhe instalimi duhet të jetë në përputhje me udhëzimet e prodhimit.

Lloji i syrit reflektues që do të përdoret duhet të dakortësohet midis Mbikëqyrësit dhe Kontraktorit përpara se ndonjë nga llojet syve reflektues të urdhërohet për t'u përdorur nga Kontraktori. Në asnjë rrethanë, Kontraktori nuk mund të instalojë sytë reflektues pa miratimin e Mbikëqyrësit.

9.7.2.10 Kërkesa të përgjithshme

Vijëzimet në kthesa, qofshin të ndërprera apo të pandërprera, nuk duhet të përbëhen nga korda, por duhet të ndjekin në mënyrë sa më të saktë rrezen e kthesës.

Çdo vijëzim rrugor që nuk përputhet me kërkesat duhet të riparohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij. Vijëzimet e papranuara të rrugëve, duhet të hiqen në atë mënyrë që të mos të shfaqen më vonë.

9.7.2.10.1 Tolerancat

Puna e përfunduar e lryjes duhet të ketë një pamje të pastër, me skaje të plotësisht të përcaktuara dhe vijëzimet rrugore duhet të jenë brenda tolerancave të specifikuara më poshtë.

Gjerësia: Gjerësia e vijëzimeve nuk duhet të devijojë nga gjerësia e specifikuar me më shumë se 5%.

Pozicionimi: Pozicionet e vijave, shkronjave, figurave, shigjetave dhe shënimeve të tjera nuk duhet të devijojnë nga pozicioni i specifikuar më shumë se 20 mm.

Skajet e vijave: Skajet e vijëzimeve gjatësore nuk duhet të devijojnë nga skaji i përcaktuar në vizatim me më shumë se 10 mm në 15 m.

Vijat e ndërprera: Gjatësitë e segmenteve të vijave të ndërprera në drejtimin gjatësor nuk duhet të devijojnë nga gjatësia e specifikuar për më shumë se 150 mm.

9.7.2.11 Mbrojtja

Pas aplikimit të bojës, shenjat e rrugës duhet të mbrohen nga dëmtimi i trafikut ose shkaqëve të tjera. Kontraktori është përgjegjës për montimin, vendosjen dhe heqjen e të gjitha tabelave paralajmëruese, flamujve, barrikadave dhe masave të tjera mbrojtëse që mund të jenë të nevojshme.

9.7.2.12 Gabimet e puntorisë ose materialeve

Nëse ndonjë material që nuk i plotëson kushtet është dorëzuar në vend ose është përdorur në punë ose nëse kryhet ndonjë punë e në kujdesin jo të duhur, materiali ose puna e tillë do të hiqet, zëvendësohet ose riparohet siç kërkohet nga Mbikëqyrësi me shpenzimet e Kontraktorit. Boja e cila është spërkatur ose ka pikuar në sipërfaqë, bordura, struktura ose sipërfaqetë tjera të tilla, duhet të hiqet nga Kontraktori me shpenzimet e tij.

10 PUNIMET PËR MURET MBAJTËS ME GUR

10.1 Referencat

- EN 771-6: Metodat e provës për njësitë e muraturës, Pjesa 6: Përcaktimi rezistencës në shkatërrim nga përkulja e njësive të muraturës me agregate betoni.
- EN 772-11: Metodat e provës për njësitë e muraturës, Pjesa 11: Përcaktimi i absorbimit të ujit të agragatit të betonit, betonit të autoklavës, njësive të muraturës me gur të prodhuar dhe natyral për shkak të veprimit kapilar dhe shkallës fillestare të absorbimit të ujit të njësive të muraturës me argjilë.
- EN 772-20: Metodat e provës për njësitë e muraturës, Pjesa 11: Përcaktimi i sheshtësisë të faqeve të njësive të muraturës.
- EN 1097-8: Provat për vetitë mekanike dhe fizike të agregateve, Pjesa 8: Përcaktimi i vlerës së gurit të lëmuar.
- EN 1926: Metodat e provës së gurit natyror – Përcaktimi i rezistencës në shtypje një-aksiale.

10.2 Materialet

10.2.1 Guri

Të gjithë gurët duhet të jenë të fortë, me teksturë uniforme, më të mirët të mundshëm nga karrierat më të afërta ose në vende të tjera të miratuara nga mbikëqyrësi i punimeve. Mostrat të cilat nuk janë të ngjashme me mostrat e ofruara do të refuzohen. Asnjë guri i rrumbullakët nuk duhet të përdoret nëse nuk thyhet.

Gurët duhet të kenë përmasa mjaft të rregullta dhe çdo gur duhet të përshtatet me gurin fqinj. Bllloqet e gurit duhet të kenë forma të çrregullta me përmasa 0.3 deri 0.7 m.

Gurët në faqen e jashtme duhet të jenë relativisht më të mëdhenj dhe uniformë në madhësi dhe ngjyrë për të arritur aparençë sa më të mirë. Gjerësia e gurëve në faqen e jashtme duhet të jetë më e madhe se lartësia e gurit. Gurët e faqes duhet të shtrihen në një thellësi të mjaftueshme në mur në mënyrë që të lidhet sa më mirë. Raporti i bllloqeve të gurit me llaçin mbushës do të jetë 60:40, 60% bllloqe guri dhe 40% llaç i markës M50.

10.2.2 Uji

Uji duhet të jetë i pastër dhe pa lëndë të dëmshme si vaji, acidi, alkali, kripa dhe lëndë bime etj.

10.2.3 Çimento

Do të përdoret çimento Portland 32.5N i miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve. Çimentoja duhet të magazinohet në rafte rezistente ndaj motit në platforma të thata dhe të mbrojtura nga shiu dhe lagështia. Çimentoja e cila është ngurtësuar pjesërisht nuk duhet të përdoret.

10.2.4 Rëra

Rëra duhet të ketë një modul imtësie midis 2.1 dhe 2.5. Rëra duhet të jetë e pastër, pa papastëri, argjilë etj. Përqindja totale e argjilës ose e papastërtive nuk duhet të jetë më shumë se 5% ndaj peshës.

10.3 Ndërtimi

Teknikat e përgjithshme të ndërtimit duhet të jenë në përputhje me traditat më të mira lokale. Kontraktori i punimeve duhet të sigurojë muratorë me eksperiencë për të tilla punimesh.

Zgjedhja e blloqeve të gurit duhet të jetë e përshtatshme, duke i vendosur në pozicion të tillë që të merret një lidhje sa më e mirë dhe prerja e gurëve duhet të bëhet e tillë që mos ketë qoshe të pa përshtatshme. Gurët duhet të vendosen në shtratin e tyre natyror aq sa është e mundur dhe me kënde të drejta me drejtimin e ngarkesës së shtytjes.

Lagia e gurëve do të kryhet vetëm nëse gurët janë porozë dhe shumë të thatë. Gjithashtu gurët e papërshkueshëm nuk duhet të lagen përpara shtrimit. Natyra ujëthithëse e gurëve të ndryshëm fillimisht duhet të konstatohet në mostra dhe për aq sa është e mundur të përdoren vetëm gurë me porozitet afërsisht të njëjtë në çdo gjatësi të murit.

Gurët e qosheve do të ndërtohen përpara trupit kryesor të murit në një lartësi prej 50 cm dhe muri ngjitur në të dy anët do të vijë me shkallëzim. Gurët e qosheve duhet të jenë në formë më të rregullt se muri kryesor dhe duhet të zgjidhen dhe vendosen në tokë paraprakisht. Ata duhet të vendosen me kujdes për të prodhuar qoshe të rregullta. Muratura do të ndërtohet në kurse në çdo interval prej 50 cm. Metoda e ndërtimit të murit duhet të jetë sipas traditave më të mira vendase, duke përdorur sa më shumë gurë të gjerë në shtrat dhe të lidhur mirë me pjesën tjetër të murit. Hapësirat e zbrazëta do të mbushen me gurë të zgjedhur për t'u lidhur me pjesën tjetër. Copat e gurëve duhet të përdoren vetëm për të mbushur zbrazëtitat midis gurëve dhe për të shmangur përdorimin e llaçit të tepërt. Megjithatë, të gjithë gurët duhet të jenë të shtrirë mirë në llaç dhe të gjitha zbrazëtitë të jenë të mbushura me llaç.

Fugat e llaçit nuk duhet të jenë më pak se 6 mm të trasha në çdo anë të shtratit të gurit dhe duhet të ketë trashësi të mjaftueshme në mënyrë që të mbulojë parregullsitë e blloqeve të gurit pa krijuar kontakt gur me gur.

11 PUNIMET E TUBACIONEVE

11.1 Të përgjithshme

Punimet e tubacioneve do të përfshijnë transportin, magazinimin, shtrimin, bashkimin, testimin, kolaudimin dhe vënien në funksion të tubacioneve dhe elementëve të tjerë përbërës të tyre të cilat do të jenë plotësisht të kompletuara.

Të gjithë elementet duhet të përputhen dhe e gjithë puna duhet të bëhet në përputhje me specifikimet në këtë seksion dhe me seksionet e tjera përkatëse të specifikimeve.

Kostot e të gjithave nyjeve, elementëve të veçantë dhe rakorderive duhet të përfshihen në kostot e njësisë për furnizimin dhe shtrimin e tubave. Asnjë pagesë shtesë nuk do të bëhet për asnjë nyje dhe pajisje.

11.2 Dorëzimet

Asnjë material i furnizuar sipas këtyre specifikimeve nuk do të dërgohet në vendndodhje pa u miratuar më parë nga Mbikëqyrësi.

Të gjitha dorëzimet do të jenë të kompletuara në të gjitha aspektet duke përfshirë të gjithë informacionin dhe listën e të dhënave këtu dhe të gjithë informacionin shtesë I kërkuar për të vlerësuar përputhshmërinë e materialit të tubave me kontratën.

Të dhënat që do të dorëzohen do të përfshijnë, por jo kufizohen në të dhënat e mëposhtme:

- a) Katalogu i të dhënave që përbëhet nga specifikimet, ilustrimet dhe një program që identifikon materialet që do të përdoren për komponentë dhe aksesore të ndryshëm. Ilustrimet do të jenë të detajuara mjaftueshëm për të ofruar një udhëzues për montimin dhe çmontimin. ;
- b) Vizatimet e bashkimit të rakorderive etj. me dimensione të shënuara qartë. Ky informacion duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar për të shërbyer si një udhëzues për montimin dhe çmontimin dhe për porositjen e pjesëve;
- c) Listimi i të gjithë lubrifikantëve të kërkuar për pajisjet me një minimum prej katër lubrifikantë ekuivalent natyral ose sintetik të prodhuar nga fabrika të ndryshme. Listimi duhet të përfshijë cilësinë e duhur të kërkuar të lubrifikantit, për një vit operim.
- d) Lista e pjesëve rezervë dhe e pajisjeve të montimit (veglave) të veçanta;
- e) Pesha e gjithë pjesëve përbërëse;
- f) Programi i tubave të tabeluar, i cili përfshin informacionin e mëposhtëm për të gjithë tubat dhe rakorderitë: Shërbimi, madhësia e tubit, Presioni I punës, trashësia e murit;
- g) Udhëzimet e prodhuesit për transportimin, shkarkimin, magazinimin dhe instalimin e tubave, rakorderive dhe aksesoreve të tjerë të tubacionit.

11.3 Sigurimi i cilësisë

Të gjithë Tubat dhe rakorderitë duhet të prodhohen nga Fabrika të njohura të cilat janë të certifikuara në përputhje me ISO 9001.

Tubat duhet të etiketohen në përputhje me standardet, duke përfshirë: Markën e fabrikës, standardin referencë, materialin e tubit, diametrin dhe presionin nominal.

Të gjithë tubat, veshja e brendshme dhe e jashtme duhet të jenë të çertifikuara për ujë të pijshëm ose përdorim në kanalizime dhe nuk duhet të përmbajnë përbërës që mund të kalojnë në ujë në sasi që konsiderohen toksike ose të dëmshme për shëndetin.

Të gjithë tubat dhe pjesët montuese të zgjedhura në bazë të kësaj kontrate duhet të jenë të cilësisë së parë, formë rrethore të rregullt dhe me trashësi uniforme, pa defekte dhe do të jenë të projektuara për presionin dhe temperaturën e kërkuar.

Kontraktori do të paraqesë certifikatat e prodhuesit dhe certifikatat nga laboratorët e miratuar që vërtetojnë se tubat i janë nënshtruar dhe kanë kaluar me testet e kërkuara sipas standardeve specifike. Të gjithë materialet duhet të jenë në përputhje me standardet e përmendura në këto specifikime.

Të gjithë mallrat duhet të kenë certifikatat e tyre të miratimit para se të përdoren. Kostoja e mostrave, transporti në laborator dhe testimi i tyre përfshihet në çmimin njësi dhe nuk kryhet pagesë shtesë.

Kontraktori duhet të vërtetojë që tubat janë të përshtatshëm për kushtet specifike të instalime në përputhje me standardet Shqiptare ose ekuivalente. Kontraktori do të bëjë llogaritjen për çdo diametër të tubit për të gjitha thellësitë e mundshme (intervali nuk duhet të kalojë 0.5 m), për kushte të ndryshme të dheut dhe për kushte të tjera të ndryshme, të cilat mund të ndryshojnë për shkak të metodave të punës etj.

Asnjë punim nuk do të fillojë pa miratimin e llogaritjeve nga Mbikëqyrësi. Llogaritjet duhet të miratohen nga Mbikëqyrësi përpara porositjes dhe prodhimit të tubave. Kontraktori është plotësisht përgjegjës për llogaritjet e tij.

11.4 Piketimi

Para fillimit të gërmimit për ndonjë tubacion do të jetë përgjegjësia e Kontraktorit të piketojë me saktësi aksin e çdo tubacioni në përputhje me vizatimet e miratuara të Kontraktorit. Aksi e tubacionit duhet të shënohet qartë në tokë po ashtu edhe kuotat e tokës aty ku kërkohet nga Mbikëqyrësi.

Rezultatet e rievimit, që përmbajnë nivelet e tokës, , nivelet e koritës në pikat e bashkimit, diametrat dhe detajet e elementeve nëntokësore do ti dërgohen Mbikëqyrësit për miratim. Detajet do të konfirmojnë pikat më poshtë:

- Rakorderitë e nevojshme për të bërë lidhjen me tubat ekzistues;
- Aksi dhe kuota e koritës së tubacionit të ri.

Gjithmonë rievimi i tubacionit do t'i paraprijë gërmimit dhe shtrimin të tubave duke përcaktuar aksin, kuotat dhe pjerrësitë e linjës së tubacionit.

Nëse në opinionin e Kontraktorit, aksi i përcaktuar i tubacionit në bazë të vizatimeve nuk është praktike, Kontraktori mund të propozojë një aks të ri të tubit dhe t'ia dërgojë atë Mbikëqyrësit për miratim. Profili duhet të jetë në përputhje me parametrat e vendosura në vizatime dhe me kërkesat e Mbikëqyrësit.

Mbikëqyrësi duhet që brenda 7 ditëve të kontrollojë dhe të miratojë propozimet e reja të profileve dhe çdo shtyrje e ndërtimit nga vonesa e paraqitjes së propozimeve do të jetë përgjegjësia e Kontraktorit. Asnjë tubacion nuk do të ndërtohet nëse nuk merret paraprakisht miratimi i Mbikëqyrësit.

Kontraktori duhet të sigurojë të gjitha mjetet dhe pajisjet gjatë montimit të tubave përfshirë dhe ato për korrigjimin e aksit. Të gjitha kostot e punimeve të nevojshme për zbatimin e projektit do të mbulohen nga Kontraktori dhe asnjë pagesë shtesë nuk do të kryhet.

11.5 Transporti

Kontraktori duhet të bëjë të gjitha angazhimet e tij për paketimin dhe transportimin e të gjitha pajisjeve dhe materialeve nga fabrika prodhuese tek vendi i ndërtimit dhe të gjitha kostot duke përfshirë pastrimin dhe transportimin që do të bëhen, do të përfshihen në vlerën e kontratës.

Transportimi i tubave do të bëhet në përputhje me udhëzimet e fabrikës ku prodhohen tubat.

Gjatë transportit, tubat nuk do të lejohen të qëndrojnë në nyjet e tyre, pjesët e ngushta të automjeteve, ose ndonjë gjë tjetër që mund të rrisë ngarkesat e përqendruara për shkak të peshës së tubit ose goditjes së automjetit por duhet të mbështetet mbi material të butë.

Gjatë transportimit, tubat nuk duhet të kalojnë gjatësinë e automjetit më shumë se 0.6m.

Gjatë transportimit duhet treguar kujdes në këto gjëra:

- Tubat të jene të pastër dhe pa pluhur;
- Skajet e tubave do të mbulohen me mbulesë të përshtatshme për të parandaluar hyrjen e pluhurit;
- Tubat në shtresat më poshtë nuk duhet të ngarkohen në mënyrë të tillë që të shkaktojë dëme ose shtrembërim të tubave.

11.6 Ngarkim-Shkarkimi

Tubat duhet të ngarkohen dhe shkarkohen me kujdesin më të madh në përputhje me rekomandimet e prodhuesit. Kontraktori do të jetë përgjegjës për cilësinë e tubave dhe për gjendjen e tyre para, gjatë dhe pas dërgimit në kantier.

Përpara fillimit të punimeve nga Kontraktori, skajet e tubave, degëzimet e tubave, etj. duhet të izoluara me kapak të përshtatshëm për të parandaluar ndonjë grumbullim të papastërtive ose dëmtim. Kjo mbrojtje duhet të hiqet vetëm në momentin e bashkimit të tubave, rakorderive ose valvulave.

Ngarkim-shkarkimi i pakujdesshëm do të shmanget gjithmonë, sidomos në temperatura të ulëta.

Tubat nuk duhet të hidhen dhe shkarkohen në asnjë mënyrë direkt nga automjeti.

Kontraktori duhet të ketë gjithmonë mbikëqyrje, fuqi punëtore, materiale dhe ambient magazinimi të tilla për të parandaluar në çdo lloj mënyre dëmtimin e tubave.

Duhet të përdoren litarë dhe ganxha të përshtatshme miratuara për ngarkimin dhe shkarkimin e tubave. Nuk duhet të përdoren ganxha të vendosura në sipërfaqen e brendshme në skajet e tubave.

Në asnjë rrethanë tubat nuk duhet të hidhen, lejohen të godasin njeri tjetrin, të rrokullisen lirshëm ose të tërhiqen nëpër tokë.

Nuk do të lejohet asnjë mjet metalik ose objekt i rëndë të bien në kontakt me tubat ose rakorderitë e tubave. Tubat me veshje të jashtme do të ngarkohen ose shkarkohen gjithmonë me rripa të gjerë jo abrazivë, gome, rripa lëkure ose pajisje të tjera të projektuara për të parandaluar dëmtimin e veshjes. Çdo dëmtim i veshjes mbrojtëse të tubave duhet të riparohet përpara testimit të tyre.

Mbikëqyrësi ka të drejtë të anulohet dërgesën e tubave, nëse tubat nuk janë prodhuar siç duhet ose të urdhërojnë të testohen pa u montuar, edhe pse nuk ka defekte të dukshme, nëse ka arsye që ngarkimi dhe shkarkimi nuk është bërë siç duhet. Të gjitha kostot e këtyre shërbimeve do të mbulohen nga Kontraktori.

11.7 Magazinimi

Të gjithë tubat duhet të magazinohen në përputhje me rekomandimet e prodhuesit, në mënyrë që të ruajnë cilësinë dhe kushtet sipas standardeve të dhëna në Specifikime.

Për magazinimin në kantier, toka duhet të jetë e niveluar dhe e pastër nga gurët.

Gjatë magazinimit dhe transportimit, tubat duhet të kenë sa më afër të jetë e mundur mbështetje të vazhdueshme.

Ngarkesat e tubave nuk duhet të vendosen njeri mbi tjetrin në lartësi më të madhe se 2m.

Një kujdes i veçantë duhet të tregohet për tubat HDPE dhe PVC. Për këta tuba duhet të merren në konsideratë pikat e përgjithshme të mëposhtme:

- Të shmangen kontaktet me cepat e mprehta të metaleve;
- Skajet e tubave duhet të mbrohet nga dëmtimet për të shmangur riskun e bashkimeve jo të sakta;
- Tubat duhet të ruhen dhe të mbrohen nga rrezet direkte të diellit përfshirë edhe magazinimin në vendet e dorëzimit;
- Tubat duhet të ruhen në temperaturë më të ulët se 23°C.

Nëse, për shkak të magazinimit ose ngarkim-shkarkimit është dëmtuar ndonjë tub atëherë pjesa e dëmtuar duhet të pritët komplet me shpenzimet e Kontraktorit.

11.8 Instalimi

Instalimi i tubave duhet të bëhet në përputhje me specifikimet e prodhuesit.

Përpara fillimit të punimeve, Kontraktori do të marrë nga prodhuesi të gjitha informacionet e veçanta në lidhje me transportimin e tubave, bashkimin dhe me të gjitha fazat e instalimit të tyre.

Mbikëqyrësi do të kontrollojë tubat në kantier (inspektim vizual i tubave nga brenda dhe jashtë duke përfshirë kontrollet e përmasave) dhe Kontraktori do të shënojë të gjithë tubat e dëmtuar në përputhje me udhëzimet e Mbikëqyrësit dhe duket ti largojë nga kantieri menjëherë dhe ti zëvendësojë ato me tubat e duhur me shpenzimet e tij.

Vetëm tubat e shënuar si të pranuar nga Mbikëqyrësi pas inspektimit në kantier do të lejohen të instalohen.

Përpara montimit, çdo tub dhe rakorderi duhet të kontrollohet brenda dhe jashtë dhe çdo papastërti material i huaj duhet të largohet. Gjithashtu kujdes duhet të tregohet për të mbajtur pastër tubat gjatë shtrimit dhe bashkimeve.

Kontraktori do të kujdeset maksimalisht për të parandaluar çdo dëmtim të tubave, gjatë uljes, shtrirjes dhe bashkimit.

Ne asnjë rrethanë tubat nuk duhet të hidhen në kanal.

Ulja do të realizohet me dorë ose me anë të litarëve dhe mjeteve të përshtatshme.

Kontraktori duhet të sigurohet, që përpara se të vendose tubin, fundi i kanalit të jetë i pastër nga gurët dhe lende të tjera të cilat mund të dëmtojnë veshjen e tubit.

Tuba duhet të vendosen me saktësi sipas planimetrisë dhe kuotave në profilin gjatësor të paraqitura në projekt, brenda një tolerance +/- 5 mm.

Tubat duhet të mbështeten përgjatë gjithë gjatësisë së tij dhe të shtrihen të pa sforcuar.

Kur kanalet kalojnë në rrugë, Kontraktori do të mbrojë tubat nga automjetet pas shtrimit të tyre, gjatë kryerjes së punimeve për riparimin e rrugës. Çdo tub i dëmtuar pas vendosjes së tyre do të zëvendësohet dhe Kontraktori do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet dhe vonesat e shkaktuara.

Një përfaqësues i fabrikës duhet të inspektojë kantierin dhe të demonstrojë procedurat e instalimit në përputhje me udhëzimet e prodhuesit përpara fillimit të montimit.

Kontraktori do të instalojë tubat sipas kuotës së koritës të paraqitur në projekt. Thellësia e vendosjes së tubacionit do të llogaritet si diferenca midis nivelit të tokës natyrale e matur gjatë piketimit minus kuotës së koritës të dhënë në projekt.

11.9 Prerja e tubave

Prerja e tubave duhet të jete minimale. Sidoqoftë, duhet të tregohet kujdes për të siguruar që prerje të tilla bëhen vetëm kur është e domosdoshme. Prerja do të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit, pa dëmtim të tubit ose veshjes mbrojtëse dhe në mënyrë që të pjesa ballore të jetë e lëmuar dhe pingul me

aksine tubit. Të gjitha prerjet duhet të bëhen me mjete dhe pajisje të duhura për prerje. Në të gjitha rastet, Kontraktori do të jetë përgjegjës për saktësinë e matjes së tubit të prerë të kërkuar. Kontraktori do të përfshijë në koston e tij çdo shpenzim të bërë për shkak të pjesëve të mbetura.

11.10 Sasitë

Para porositjes së tubave, Kontraktori duhet të sigurohet për gjatësinë e nevojshme të secilit lloj tubash, adaptorësh, rakorderi, valvula dhe elemente të veçanta të nevojshme për të përfunduar punimet. Kontraktori nuk do ketë pretendime për sasinë e tepërt ose të mangët të porositur bazuar në Preventiv.

11.11 Inspektimi i Punëdhënësit

Punëdhënësi, Mbikëqyrësi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar kanë të drejtë të inspektojnë tubat ose prodhimin e tubave dhe testet e kontrollit të cilësisë. Një inspektim i tillë nuk do të çlirojë në asnjë mënyrë Kontraktorin nga përgjegjësia për të siguruar produkte që përputhen me standardet e zbatueshme brenda këtyre Specifikimeve.

Nëse punëdhënësi zgjedh që të mos inspektojë prodhimin, testimin ose tubat e prodhuar, nuk do të thotë në asnjë mënyrë që ai ta ketë miratuar produktin.

Kostoja e transportit të Punëdhënësit ose Mbikëqyrësit në fabrikë dhe vendet e testimit do të konsiderohet se përfshihet në çmimin njësi (çmimin e Kontratës) dhe nuk paguhen veçmas.

Nëse Mbikëqyrësi konsideron së një segment tubacioni brenda një gjatësie të testuar ka dështuar, Kontraktorit mund t'i kërkohej të testojë hidraulikisht, secilin tub dhe nyje bashkimi para montimit në kantier. Në këtë rast, rezultatet e testeve duhet t'i dorëzohen dhe miratohen nga Mbikëqyrësi përpara se të vendosen tubat e tjerë. Kostoja e testimit të tubave të veçantë do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij.

Punëdhënësi ka të drejtën të punësojë një laborator të pavarur testimi për të kryer teste pranimit. Defektet e zbuluara gjatë këtij inspektimi duhet të korrigjohen me shpenzimet e tij nga Kontraktori. Në rast mosmarrëveshjeje, një laborator i pavarur testimi do të merret si ndërmjetës. Këto shpenzime duhet të paguhen nga pala humbëse.

11.12 Rakorderitë

Të gjitha rakorderitë duhet të jenë me të njëjtin material si tubat nëse nuk përcaktohet ndryshe. Rakorderitë duhet të pajisen me një bashkues të përshtatshëm me sistemin e tubacioneve dhe do të sigurohen nga Kontraktori pa ndonjë kosto shtesë. Kostot e të gjitha bashkuesve, pjesëve speciale dhe rakorderive duhet të përfshihen në kostot njësi të tubacionit.

11.13 Vendi i Origjinës së Materialeve

Kontraktori do të jetë specifik për vendin e origjinës dhe firmën prodhuese të materialeve që do të furnizojë në bazë të Kontratës, dhe do t'i dërgojë të gjithë katalogët përkatës Mbikëqyrësit. Para konfirmimit të importit të çdo materiali, Kontraktori duhet të marrë miratimin me shkrim të Mbikëqyrësit.

11.14 Lidhja me Tubacionet Ekzistues

Lidhja me tubacionet ekzistues duhet të bëhet ashtu siç paraqitet në projekt.

Kur një tub i ri do të lidhet me një tubacion ekzistues atëherë do të përcaktojë pozicionin e tubit ekzistues përpara gjurmimit dhe konfirmimit të aksit dhe kuotës së korites të tubacionit të ri. Kontraktori do të përdorë detektorët e tubave ose mjete të ngjashme për të përcaktuar saktë pozicionin e tubave ekzistues.

Kontraktori do të hape një gropë në vendin e rënë dakord dhe me Mbikëqyrësin për të konfirmuar vendndodhjen e tubacionit ekzistues dhe për të ekspozuar pjesën ku do të bëhet lidhja. Nëse gropa nuk arrin të zbulojë tubin e kërkuar, atëherë duhet të hapen gropa shtesë. Pasi të ketë gjurmuar gropën dhe të ekspozojë tubin ekzistues, Kontraktori duhet të matë kuotën e koritës së tubit ekzistues dhe diametrin e tij të jashtëm.

Para se Kontraktori të kryejë ndonjë lidhje me rrjetin ekzistues, do të informojë Mbikëqyrësin dhe Autoritetin përgjegjës për operimin e rrjetit dhe duke propozuar një procedurë të përshtatshme për punimet. Kontraktori do të njoftojë Mbikëqyrësin së paku gjashtë ditë përpara dhe do t'i kërkojë t'i kryejë këto punime në mënyrë që të shkaktojë ndërhyrje minimale në funksionimin normal të rrjetit, duke përfshirë punën e natës kur është e nevojshme. Zgjatja e Periudhës së Kontratës nuk do të lejohet për ndonjë vonesë që lind nga dështimi i Kontraktorit për të ndjekur procedurën e rënë dakord.

Mbikëqyrësi do t'i lëshojë Kontraktorit udhëzime të hollësishme në lidhje me çdo ndërlidhje që duhet të bëhet me rrjetin ekzistues. Prerja në tubin kryesor ekzistues dhe procesi i lidhjes do të bëhet vetëm në prani të Mbikëqyrësit ose Punëdhënësit në kohën e përcaktuar nga Punëdhënësi. Kontraktori duhet të paraqesë vizatime shtesë të detajuara të montimit dhe një metodologji të detajuar për miratim nga Mbikëqyrësi.

Prerja e tubit kryesor ekzistues dhe instalimi i tubit të ri do të kryhet me efikasitet dhe shpejt në mënyrë që të zvogëlohet në minimum ndërprerja e shërbimit publik të këtij rrjeti. Rrjeti ekzistues do të shkurtohet vetëm duke përdorur pajisje speciale të miratuara nga Mbikëqyrësi. Në asnjë rrethanë tubi nuk duhet të priten me oksigjen ose hark elektrik. Prerja do të jetë pingul për të siguruar që tubi i ri i dhënë sipas projektit të instalohet siç duhet. Për gjatësinë e tubit që do të hiqet, Kontraktori do të këshillohet me Përfaqësuesin e Mbikëqyrësit. Kontraktori do të kujdeset për të shmangur çdo papastërti ose material tjetër të hyjë në tubat ekzistues.

Kontraktori duhet të ketë në dispozicion në vendin e lidhjes një pompë të përshtatshme para se të fillojë çdo prerje në rrjetin ekzistues në mënyrë që gjurmimet të mbeten të thata në çdo kohë dhe të zvogëlojnë rrezikun e ujit të ndotur ose të papastërtisë që hyn në sistemin ekzistues të shpërndarjes.

Asnjë bashkim nuk duhet të mbulohet derisa të testohet dhe të sigurohet që nuk rrjedhje dhe të verifikohet nga Mbikëqyrësi.

11.15 Punimet e tubacioneve për furnizimin me ujë

11.15.1 Tubacionet prej polietileni (PE 100-RC)

11.15.1.1 Tubat

Tubat duhet të jenë PE 100-RC për ujë të pijshëm dhe në përputhje me DIN 8074/8075, DIN EN 12201 për instalime në kanale pa shtrat rëre, të prodhuar me PE 100-RC me rezistencën më të lartë ndaj plasaritjeve të ngadalta (FNCT kërkesat minimale: ≥ 8760 h në përputhje me PAS 1075; $T=80^{\circ}\text{C}$, $\sigma=4$ N/mm², 2% Arkopal), të verifikuara në përputhje me të dyja DIN 8075 dhe DVGW GW 335 A2.

Etiketimi i tubave të bëhen me lazer, duke përfshirë barkodin e gjurmueshmërisë së tipit 128-C, në përputhje me ISO 12176-4 të shtypur direkt mbi tub.

Tubat duhet të kenë miratime të përditësuara sipas PAS 1075, DVGW dhe EN 12201 të cilat Kontraktori do t'ia paraqesë Mbikëqyrësit.

Tubat me diametër deri në 63 mm duhet të jenë në përputhje me PAS 1075 Tipi 1, tuba me mure të ngurtë me një shtresë të prodhuar me PE100-RC ose në përputhje me PAS 1075 Tipi 2, tuba me dy shtresa, me shtresë mbrojtëse të integruar të prodhuar me PE 100 or PE 100-RC dhe që ka një shtresë mbrojtëse të brendshme prej PE 100-RC.

Tubat me diametër të barabartë dhe më të madhe se 75 mm do të jenë në përputhje me PAS 1075 Tipi 2, tuba me dy shtresa, me shtresë mbrojtëse të integruar të prodhuar me PE 100 or PE 100-RC dhe që ka një shtresë mbrojtëse të brendshme prej PE 100-RC.

Tubat sipas PAS 1075 Type 2, duhet të jenë me një shtresë treguese të integruar me ngjyrë të paktën 10% të trashësisë së murit të tubit në pjesën e jashtme për të lejuar një vlerësim të saktë të sipërfaqes së tubit.

Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së materialit sipas PAS 1075 do të kryhet nga testimet, inspektimet dhe certifikimet e miratuara.

Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 50001.

11.15.1.2 Bashkuesit me elektrofuzion

Bashkuesit me elektrofuzion të tubave PE 100-RC duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Materiali: PE 100
- Klasa e presionit: SDR 11
- I përshtatshëm për instalim në kanale pa shtrat rëre
- të dy anët mund të saldohen (ngjiten) njëkohësisht
- me ndalim qendror
- thellësia e futjes në përputhje me kërkesat maksimale të ISO
- Zona të gjata të ftohta
- kompensimi i temperaturës (koha e ngjitjes rregullohet automatikisht sipas temperaturës së ambientit)
- me barkod për procesin automatik të saldimit
- me barkod gjurmueshmërie

Skajet e tubit do të përgatiten sipas udhëzimeve të instalimit të prodhuesit.

Bashkuesit duhet të kenë certifikime të përditësuara sipas DVGW and EN 12201.

Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 50001.

11.15.1.3 Testimi i tubave në fabrikë

- Kontraktori duhet të ketë kryer testet e mëposhtme dhe të paraqesë certifikata të përditësuara të testeve të lëshuar nga një organ i akredituar për testimet:
- Testet e miratimit të materialit në përputhje me PAS 1031 dhe PAS 1075 Table 1 a dhe 1 b,
- Testet e sigurimit të cilësisë së materialit në përputhje me PAS 1075 Table 2,
- Testet e miratimit të tubit në përputhje me PAS 1075 Table 3,
- Testet e kontrollit të cilësisë së tubit në përputhje me PAS 1075 Table 4.

11.15.1.4 Testet pas dorëzimit

• Mostrat e tubave HDPE merren në mënyrë të rastësishme ose siç udhëzohet nga Mbikëqyrësi. Mbikëqyrësi mund të kryejë, përveç testeve të Cilësisë dhe Pranimit, cilindo ose të gjitha testet e mëposhtme në mostrat e marra:

- Testimet për rezistencën në rrjedhshmëri, zgjatimin relativ në rrjedhshmëri si dhe rezistencën dhe zgjatimin relativ në këputje sipas standardit shqiptar ose ekuivalent ISO 527,
- Testi për gërvishtjen e shtresës mbrojtëse të jashtme (PAS 1075, Aneksi 6).

11.15.1.5 Shtrirja e tubave PE

Tubat dhe rakorderitë duhet të bashkohen me saldim me elektrofuzion mbi tokë dhe do të mbështeten mbi mbështetëse të lëmuar të miratuar më parë nga Mbikëqyrësi. Çdo tub në secilën anë të makinës salduese do të kenë minimum dy mbështetës. Të gjitha nyjet e bashkimit duhet të inspektohen pas saldimit dhe të regjistrohen nga makineria e saldimit.

Të gjitha nyjet do të miratohen nga Mbikëqyrësi përpara se Kontraktori të vazhdojë me punimet e shtrimit të tubave. Gjatësia maksimale e tërheqjes së tubave PE të bashkuar në pozicionin përgjatë kanalit ose direkt në kanal nuk duhet të kalojë 300 m ose sa gjatësia e maksimale që lejon nga pajisja hidraulike e makinës së elektrofuzionit. Tërheqja direkt në sipërfaqen e tokës është rreptësishtë e ndaluar. Të gjithë bashkimet e rakorderive, degëzimeve, etj. të cilat montohen (saldohen) në kanal duhet të bëhen nga manikota me saldim automatik me elektrofuzion ose rakorderi të tjera të cilat bashkohen elektrofuzionit.

Fundi i kanalit duhet të jetë i pastër nga gurët ose pjese të forta të cilat mund të dëmtojnë tubin. Përpara se tubacioni ose elementë të tij të ulet ne kanal, nyjet e bashkimit duhet të jenë ftohur mjaftueshëm. Gjatë uljes së tubit ne kanal duhet të ketë kujdes të veçantë ne vendet e takimit të tubit me pjesët anash dhe ne fund. Kujdes i veçantë duhet të tregohet gjatë kryqëzimeve me strukturat ose rrjetet e tjera. Mbështetëset rrethore të tubave për 4 gjatësitë fillestare të tubave nga fundi i tubit i cili duhet të ulet ne kanal duhet të sigurohet.

Ndryshimet graduale ne planimetri dhe profil mund të bëhen nga deformimi i lehtë i tubit në të ftohtë, por në asnjë rast tubi nuk duhet të kthehet në një rreze më të vogël se 25 herë diametri i jashtëm i tubit. Në asnjë rrethanë nuk do të lejohet kthimi i tubit në të nxehtë në kantier. Tubi duhet të mbahet sa më shumë të jetë e mundur në qendër të kanalit për të siguruar ngjeshjen e duhur të mbushjes anësore, por do të lejohen disa lakime të vogla për të kompensuar bymimin linear të tubit nga ndryshimi i temperaturës.

11.15.1.6 Bashkimi i tubave PE

Të gjithë tubat PE dhe rakorderitë të tyre do të bashkohen me pajisje automatike elektrike me elektrofuzion. Të gjitha pajisjet automatike të saldimit me elektrofuzion duhet të kenë mundësinë e regjistrimit dhe printimit të të dhënave të saldimit. Kontraktori duhet të sigurojë një pajisje për transferimin e të dhënave nga pajisja e elektrofuzionit në kompjuter.

Kompleti i plotë i pajisjes të saldimit automatik me elektrofuzion do të përfshijë si më poshtë:

- Kutia e Kontrollit automatik të pajisjes e aftë të funksionojë në një mënyre plotësisht automatike, për tubacione deri në diametrin nominal të jashtëm, të përdorur në Projekt. Do të ketë mundësinë e transferimit të të dhënave për të gjitha nyjet e saldimit.
- Gjenerator i lëvizshëm i përshtatshëm për të furnizuar me energji pajisjen e elektrofuzionit.
- Morseta të përgjithshme me unaza për tubat, shume funksionale për manikotat, bërrylat dhe degëzimet T.

Procedura për saldimet me elektrofuzion do të jete si vijon:

- Drejtohen skajet e tubave dhe hiqet ndonjë pjesë e mbetur. Kontrollohen tubat dhe rakorderitë e tyre për futjen e duhur ne manikotat. Nëse tubat kanë formë ovale të theksuar dhe nuk futen

në manikotat bashkuese, tubat duhet të riformësohen në formë më rrethore nga një pajisje të miratur për këtë qëllim.

- Pastrohen dhe përgatiten skajet e tubit me një kruarës universal ose një pajisje të miratur për përgatitjen e sipërfaqeve në gjendje për të hequr sipërfaqen e oksiduar të skajeve të tubit të gjatësisë së futjes. Duhet të hiqet një shtrese 0.2 – 0.4mm të trashë nga sipërfaqja e jashtme. Kruarës dore të llojit Harris ose ekuivalent mund të përdoren për bashkimet e T-ve dhe të mbështetësve.
- Pastaj zona e përgatitur pastrohet me aceton ose tretës tjetër të miratur. Sipërfaqja e përgatitur e tubit nuk duhet të preket ose kontaminohet përpara saldimit.
- Rakorderitë ose degëzimet T duhet të hiqen nga paketimi dhe të pastrohen nga yndyrnat me aceton ose tretës tjetër të aprovuar para se të futen në skajet e tubit. Pastaj thellësia e futjes shënohet me shënues të përshtatshëm duke futur manikotat/rakorderitë deri në fund.
- Drejtimi dhe hapësirat ndërmjet tubave dhe rakorderive do të kontrollohen me kalibër. Hapësira totale ndërmjet diametrit të jashtëm të tubit dhe rakorderive nuk duhet të kalojë 2% e diametrit nominal të jashtëm të tubit.
Bashkimi me elektrofuzion do të lejohet të vazhdojë vetëm pasi të jenë kryer kontrollet e mësipërme.
- Në përfundim, tek bashkimi duhet të shfaqet materiali i shkrirë. Nëse shkrirja nuk është e dukshme, nya duhet të pritët dhe të bëhet një saldim i ri.
- Manikota nuk duhet të hiqet derisa të ftohet.

11.15.2 Tubat dhe rakorderitë prej gize duktile

11.15.2.1 Të përgjithshme

Të gjithë materialet duhet të jenë në përputhje me standardet EN, ISO ose ndonjë standard tjetër ekuivalent, do të furnizohen nga prodhues të certifikuar për tubacionet e ujit të pijshëm deri në 50 °C. Të gjitha punimet e tubave do të jenë të klasës K9.

11.15.2.2 Standardet dhe kodet e aplikueshme

Kodet dhe standardet të zbatueshme për punimet sipas këtij kapitulli janë rënditur më poshtë.

- ISO 2531:2009: Tubat, rekorderitë, aksesorët dhe bashkuesit e tyre prej gize duktile për ujë ose gaz
- EN 545:2010: Tubat, rekorderitë, aksesorët dhe bashkuesit e tyre prej gize duktile për tubacionet e ujit. Kërkesat dhe metodat e testimeve.
- ISO 4179:2005: Tubat dhe rekorderitë prej gize duktile për tubacionet me dhe pa presion – Veshja e brendshme me llac çimentoje.
- ISO 8179-1:2004: Tubat prej gize duktile – Veshja e jashtme me bazë Zinku. Pjesa 1 – Shtresa prej metalit të zinkut.
- ISO 4633:2002: Guarnicionet prej gome – unazat e bashkimit për tubacionet furnizimit me ujë dhe kanalizimit-specifikimet për materialet.
- ISO 7005-2:1988: Fllanxhat metalike - dimensionet e fllanxhës
- EN 14910: 2006: Tubat dhe rekorderitë prej gize duktile – Veshje e jashtme prej epoksi (për industri të rëndë) të rakorderive dhe aksesorëve prej gize duktile - Kërkesat dhe metodat e testimeve.

EN 15542:2006: Tubat prej gize duktile, veshja e jashtme me llac çimentoje - Kërkesat dhe metodat e testimeve.

11.15.2.3 Bashkimet

Bashkimet e ankoruara

Bashkimi i ankoruar do të jetë i projektuar për t'i rezistuar forcave aksiale shtytëse, por duke ruajtur fleksibilitetin dhe devijimin këndor siç është përmendur në Tabelën më poshtë. Bashkimet e ankoruara duhet të jenë të llogaritura për t'i rezistuar rastit më të disfavourshëm të presionit sipas kushteve normale të punës plus grushtin hidraulik, kushteve emergjente apo presionit të hidrotetit.

Testi i rrjedhjes duhet të bëhet veçmas për secilin segment nga puseta në pusetë.

Testimi do të kryhet me ujë për të cilin do të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Kërkesat e testit;
- Vlerat e matura dhe grafikët;
- Certifikata e testit.

Protokolli i testit do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- Punëdhënësi, Kontraktori, Mbikëqyrësi, operatori i pajisjeve, vendi, data, ora, rruga, numri, numri i seksionit dhe/ose numri i pusetave fqinje;
- Karakteristikat e seksionit që do të testohet, p.sh. lloji i provës (testimi në seksione, testimi i bashkimit), diametri nominal, gjatësia e seksionit, materiali i tubit, lloji i kanalizimeve, viti i ndërtimit, niveli i ujit nëntokësor;
- Informacione mbi standardet e testit të aplikuar, presionin e testit, kohën dhe kohëzgjatjen e testimit, diferencën e lejuar dhe të matur të presionit;
- Grafiku i ndryshimit të presionit gjatë testimit;
- Proces verbalin e testit me rezultatin e testit të rrjedhjes të nënshkruar nga pjesëmarrësit që e kanë ndjekur testin.

11.16.13.4 Testimi me presion të ulët të ujit

Seksioni duhet të pastrohet në mënyrë që nyjet të vëzhgohen nga jashtë. Të dy skajet e seksionit duhet të mbyllet hermetikisht nga tapa të përshtatshme të përkohshme të pajisura me niple. Tapa nga ana e sipërme duhet të jetë e lidhur me një tub vertikal të paktën 0.50 m mbi majën e tubit më të lartë. Më pas do të bëhet mbushja me ujë nga tubi i poshtëm dhe duke nxjerre ajrin nga tubi vertikal derisa niveli i ujit në tubin vertikal të jetë 0.50 m mbi kokën e tubit vertikal më të ulët. Bashke me një seksion tubacioni mund të testohet dhe puseta nga biefi i sipërm.

Tubacioni duhet të mbushet me ujë 1 orë para se të kryeni testin dhe testimi bëhet për 30 minuta. Të gjitha rrjedhjet e dukshme në nyje do të riparohen.

Sasia e ujit që duhet të shtohet për të ruajtur nivelin e ujit në tubin vertikal do të matet dhe kjo do të konsiderohet si rrjedhje e seksionit të testuar.

Tubi kalon testin nëse vëllimi i ujit që duhet të shtohet gjatë kësaj kohe nuk është më i madh se:

- 0.15 l/m² për tubacionet
- 0.20 l/m² për tubacionet me puseta.

Nëse rrjedhja gjatë periudhës së testit tejkalon vlerën e lejuar, Kontraktori do të riparojë defektet që shkaktojnë rrjedhje të tilla. Testi dhe riparimet përsëriten deri sa të mos ketë rrjedhje të dukshme dhe rrjedhjet nuk tejkalojnë kufirin e lejuar.

Të gjitha aparatet e nevojshme të testimit, tapat, etj., punëtorja, uji dhe çdo material tjetër i nevojshëm për testim do të sigurohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij.

11.16.14 Pastrimi i tubacioneve

Gjatë instalimit, Kontraktori do të mbajë të pastër pjesën e brendshme të tubave nga uji, papastërtia, gurët, mbeturinat dhe materiet e tjera të huaja. Pas përfundimit të shtrimit dhe bashkimit, ana e brendshme

e tubave duhet të pastrohet për te larguar plotësisht papastërtitë dhe të mbahet në një gjendje të tillë derisa të merret në dorëzim nga Punëdhënësi.

11.16.15 Pusetat

11.16.15.1 Kërkesat e përgjithshme

Pusetat do të ndërtohen me dimensionet dhe në të gjitha vendet ku tubi ndryshon drejtimet dhe në hyrjet e kolektorëve të tjerë, siç tregohet në Vizatime.

Nëse rënia e brendshme midis fundeve të tubave të lidhur është më e vogël se diametri më i madh i tubiave të lidhur, atëherë fundi i kanalit duhet të jetë i tillë që të sigurojë një kalim gradual midis fundeve të tubit të lidhur pa asnjë rënie.

Kur rënia midis tubave të lidhur është më e madhe se 1.00 m, pusetat duhet të jenë me një rënie të brendshme sipas standardit shqiptar ose ekuivalent me ATV dhe rregulloreve të tjera përkatëse.

Pusetat duhet të projektohen për të siguruar stabilitet kundër efektit të notimit (buoyancy).

Korita e pusetave do të formohet në atë mënyrë që ato të kenë një drenazhim të qetë dhe të mos pengojnë rrjedhën e ujërave të ndotura. Pjesa e sipërme e kanaleve në bazën e pusetave duhet të jetë e barabartë me pjesën e sipërme të tubit.

11.16.15.2 Pusetat prej polietileni dhe polipropileni

Të gjithë komponentët e pusetës duhet të jenë të certifikuar sipas EN 13598-2 dhe EN 476.

Pusetat duhet të jetë e papërshkueshme nga uji, e siguruar nga notimi deri në presionin 0.5 bar, me mundësi fleksibël për lidhjet e tubave, e përshtatshme për trafik të rëndë (SLW 60) dhe lejon rregullime në lartësi.

Pusetat duhet të bëhen prej 100% me material të pastër pa përmbajtje riciklimi.

Për pusetat me një diametër më të madh se 1000 mm, unazat dhe konet e pusetave duhet të pajisen me shkallë jo të rrëshqitshme.

Gotat (foletë) hyrëse dhe dalëse (mashkull dhe femër) duhet të korrespondojnë me dimensionet e tubave që do të lidhen, me garnicion elastomërik për një lidhje fleksibël të tubave sipas EN 681-1 dhe EN 1277. Adaptorët e tubit të përshtatshëm për materialin dhe diametrin e tubave që do të lidhen duhet të përfshihen në pjesët përbërëse të pusetës.

Instalimi duhet të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit.

11.16.15.3 Pusetat me beton të armuar

Permasat e pusetave prej betoni të armuar do të jenë sipas vizatimeve të projektit të cilat mund të jenë të parapërgatitura ose monolit.

Poshtë pusetave me beton të armuar të parapërgatitura do të bëhet një shtrese betoni i varfër i klasës C12/15 me trashësi 10cm.

Pusetat me beton të armuar të parapërgatitura duhet të jenë në përputhje me standardin shqiptar ose ekuivalent me DIN 4034. Elementet e parapërgatitura të betonit duhet të jenë ekuivalente me DIN EN 1917 dhe DIN 4034 Tipi 2 dhe të kenë etiketën e kontrollit të cilësisë së një fabrike të certifikuar të betonit.

Klasa e betonit do të jetë sipas projektit por jo më e vogël C25/30 për betonin e armuar dhe C20/25 për betonin e pa armuar. Betoni duhet të ketë një rezistencë të lartë ndaj sulfateve. Për sa i përket klasës së ekspozimit, betoni duhet të jetë i papërshkueshëm nga uji (thellësia e penetrimit: ≤ 30 mm), rezistent ndaj korrozionit kimike "të lartë" sipas standardit shqiptar ose ekuivalent me DIN 4030 dhe të ketë një rezistencë të lartë ndaj ngricës.

Armatura duhet të jetë sipas standardit shqiptar ose ekuivalent me EN 10080 dhe të jetë i projektuar për t'i rezistuar sforcimeve para dhe gjatë instalimit.

Puseta duhet të kompletohet me:

- Bazën e parapërgatitur DN 1000,
- Seksionet për rritjen në lartësi të pusetës DN 1000 (në lartësi të ndryshme nga 0.25 deri në 1.00 m),
- Unaza DN 1000 për axhustimin e kuotës së sipërme (në lartësi të ndryshme nga 60 deri në 100 mm),
- Koni 600/1000 mm,
- Kapaku i betonit.

11.16.15.4 Aksesorët e pusetave

Kapakët dhe kornizat

Kapakët e pusetave do të jenë prej gize duktile të standardit shqiptar ose i ngjashëm me ISO 1083 dhe të jete në përputhje me EN 124. Të gjithë kapakët duhet të jene te klasës D400 për trafik të rëndë dhe të klasës 125 për trafik të lehtë, rrethor, me menteshë me kënd hapje maksimumi 130°, bllokim sigurie në 90°, i ventiluar, me dorezë të vulosur, me kyç kundër vjedhjes, me unaza ngritëse të integruar me kornizën. Të gjithë kapakët e pusetave të furnizuara në bazë të kësaj kontrate do të stampohen me një mbishkrim të konfirmuar nga Mbikëqyrësi përpara se Kontraktori të bëjë porosinë e tyre.

Kapakët duhet të kenë dimensionet e mëposhtme:

- Hapja e pastër: të paktën 600 mm
- Thellësia e kornizës: të paktën 100 mm, me vrima ankorimi
- Mbeshtetja e kapakut/kornizës: Unazë elastomeri

Kapakët e pusetave duhet të instalohen në atë mënyrë që të parandalojnë hyrjen ujërave sipërfaqësore.

Kontraktori do të sigurojë tre çelësa për mbylljen dhe ngritjen e kapakëve të pusetave.

Kontraktori do të sigurojë gjithsej çelësa ngritës dhe mbyllës për kapakët e pusetave.

Unazat mbështetëse të betonit duhet të ndërtohen siç kërkohet dhe përfshihen në kostot e pusetave.

Shkallet e hekurit

Shkallet e hekurit duhet të jenë jo korrozive (gize, çeliku të galvanizuar, çeliku me veshje antikoroze) sipas standardit shqiptar ose ekuivalent me DIN EN 13101, DIN V 1264 dhe DIN 19555.

Shkallët e hekurit mund të instalohen para ose pas betonimit dhe duhet të jenë të projektuara për të siguruar një qëndrueshmëri të mire, të ketë një model anti-rrëshqitëse në pjesën e sipërme, një dorezë të sigurt dhe anët e ngritura për të ndihmuar në parandalimin e rrëshqitjes së këmbës.

Përmasat:

- gjerësia minimale e shkeljes 300 mm
- thellësia minimale e shkeljes 150 mm dhe maksimale 250 mm

Shkallet e hekurit duhet të jenë në bulon ose të ndërtuara. Vrimat për ankorimin në mur duhet të shpohen dhe mbushen me çimentim pas instalimit të Shkalleve të hekurit.

Të gjitha elementët e fiksimit (bulona, kunjat, vida, rrota, etj.) duhet të jenë prej çeliku të galvanizuar.

Shkalla e parë duhet të vendoset 30 cm nën kapakun e pusetave.

11.16.15.4.1 Kapakët e pusetave shimbledhëse të rrugës

Ky specifikim përfshin karakteristikat teknike dhe përbërësit e tjerë plotësues. Zgara e kapjes se ujerave te shiut do te jete material kompozit ne mënyrë që të përmbushë kërkesat e Klientit për anti-vandalizëm gjatë operimit duke i hequr/grabitur.

Karakteristikat e zgarës:

- KLASA C250 EN 124
- Kapaku i prodhuar sipas standardit EN 124-klasa C250.
- Prodhuar nga ISO 9001:2008, ISO 14001:2004 dhe ISO OHSAS 18001:2007 kompani të certifikuara.
- Vizim: Klasa e kapacitetit mbajtës, standardi referues, emri i prodhuesit dhe cilësia e markës e lëshuar nga një trupë e njohur ndërkombëtarisht.

Zgara përbëhet nga:

- Korniza katrore, madhësia e jashtme 500x500 mm me material kompozit të përberë, me profil të integruar për ankorimin gjatë instalimit.
- Sipërfaqe e rrjetëzuar në formë skare jo e rrëshqitshme
- Sipërfaqja e rrjedhjes: 30% e sipërfaqes së lirë
- Trashësia e kapakut 32 mm

Përshtatje opsionale




Figura 11-2: Vizatimi shembull i zgarës

Tabela 11-3: Përmasat e zgarës se ujerave te shiut

Përshkrimi	AxA (mm)	B (mm)	CxC (mm)	DxD (mm)	E (mm)	F (mm)	G (mm)
500 C250	500x500	107	402x402	443x443	87	7	32

Zgara duhet te ketë mbishkrimin e bashkisë perkatëse në sipërfaqen e dukshme.

11.16.15.5 Unazat e shkarkimit të ngarkesave

Unazë e shkarkimit të ngarkesave duhet të jetë prej betoni C50/60, me diametër të jashtëm 1050 mm, me hapje 675mm, lartësi 120mm, me aftësi për të mënjanuar zhvendosjet dhe për të mbajtur një kapak të Klasit deri në D400.

11.16.15.6 Lidhje shtesë të tubave në muret e pusetës

Kujdes! Nuk lejohen lidhje shtesë në paretet e pusetës se kolektorit kryesor, ato do të bëhen vetëm ne pusetat e betonit ne kapërderdhës.

11.16.15.7 Testimi i Pusetave

Kontraktori do të sigurojë të gjithë ujin, punën, tubat, tapat, kthesat dhe pajisjet e tjera të nevojshme për kryerjen e testimeve, dhe asnjë pusetë apo punë tjetër nuk duhet të mbulohet, derisa ato të jenë kontrolluar dhe aprovuar nga Mbikëqyrësi.

Testi që do të aplikohet në pusetat duhet të jetë mbushja e tyre me ujë të paktën 50 cm mbi pjesën e sipërme të tubit më të lartë.

Për të kontrolluar papërshkueshmërinë e ujit, duhet të bëhet një test rrjedhje sipas standardit shqiptar ose ekuivalent me DIN EN 1610. Puseta duhet të mbushet me ujë 1 orë para testimit dhe të testohet për 30 min. Puseta e kalon provën nëse vëllimi i ujit që duhet të shtohet gjatë kësaj kohe nuk është më i madh se 0.4 l/m² të pusetës. Nëse kjo kërkesë nuk përmbushet, Kontraktori me shpenzimet e tij do të riparojë pusetën dhe do të përsërisë provën.

Kostot e të gjitha këtyre punimeve do të përfshihen në çmimet e preventivit dhe asnjë pagesë shtesë nuk do t'i bëhet Kontraktorit.

11.16.16 Lidhjet e konsumatorëve

Në projekt lidhjet e konsumatorëve paraqiten vetëm në mënyrë skematike. Vendndodhjet e sakta të lidhjeve do të vendosen në vend nga Kontraktori dhe do të miratohen nga Mbikëqyrësi. Detajet e këtyre lidhjeve do të miratohen nga Mbikëqyrësi para dorëzimit të materialeve nga Kontraktori. Kontraktori është përgjegjës për të paraqitur pozicionet e sakta të këtyre lidhjeve në Vizatimet e zbatimit (përfshirë distancën e saktë paralel dhe pingul) në pusetën më të afërt nga biefi i sipërm.

Lidhjet e konsumatorëve duhet të kenë një thellësi maksimale të koritës 1.50 metra në vijën e pronës në varësi të thellësisë së instalimit të tubacioneve të oborrit. Ata do të kenë një pjerrësi minimale prej 1%.

Për të minimizuar numrin e lidhjeve të tubave me rrjetin e kanalizimeve, Kontraktori inkurajohet të ndërtojë kolektorë lokalë që shërbejnë deri në katër konsumatorë, kur kjo është e aplikueshme. Kolektorët lokalë do të bashkohen në një pusetë inspektimi PE DN 400 të vendosur para pronave.

Në rast të lidhjes së drejtpërdrejtë me kanalizimet, lidhjet duhet të bëhen duke përdorur degëzime 90 ° me reduktim.

Lidhjet e konsumatorëve që do të ndërtohen sipas kontratës do të lidhen me tubin ekzistues të të ujërave të ndotura në oborrin e konsumatorit duke përdorur përshtatësit (adaptorët) e tubit për bashkimin e tubave me diametra dhe materiale të ndryshëm.

11.17 Valvulat dhe rakorderitë

11.17.1 Rakorderitë me fllanxhë prej gize daktilë

Rakorderitë me fllanxhë prej gize daktilë, të certifikuara për ujë të pijshëm, duhet të jenë në përputhje me standardet e mëposhtme:

- Specifikimet dhe metodat e testimit: EN 545,

- Certifikuar për ujë të pijshëm sipas DVGW (bazat e testit DVGW GW337), KTW W270, WRAS, ose ACS
- Veshja sipas specifikimeve të GSK

Veshje me rezinë epoksi pluhur, brenda dhe jashtë në përputhje me RAL-GZ 662 të "Gütegemeinschaft Schwerer Korrosionsschutz GSK" (Association for Excellent Corrosion Protection with Epoxy resin powder coating) në përputhje me DIN 30677-2 (trashësia e shtresës min 250 µm, miratuar për përdorim në sistemet e ujit të pijshëm

- Fllanxhat: EN 1092-2
- Guarnicionet: EPDM

Përfshire bulonat, dadot dhe rondelat e galvanizuar në të nxehtë.

Prodhuesi duhet të ketë menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001.

11.17.2 Valvulat thikë

Valvulat e portës duhet të jenë sipas EN 1074 (1-2) dhe ISO 5996; dimensionet sipas EN 558 seria F14 (DIN 3202, F4); dimensionet e fllanxhës dhe të vrimave sipas EN 1092-2, trupi prej gize daktilë sipas EN 1563, veshur me epoksi brenda dhe jashtë sipas DIN 30677-2 dhe GSK "mbrojtje nga korrozioni për industrinë e rëndë" (trashësia e veshjes >250 µm), thika prej gize duktile të mbështjellë me EPDM të vullkanizuar, bosht teleskopik pre çeliku të pandryshkshëm (inoks) për komandimin, me filetim, teleskop me izolim me shumë unaza O pa nevojë për mirëmbajtje. Udhëzues i boshtit teleskopik i mbrojtur nga uji dhe papastërtia nga jashtë me një unazë pastruese. Unaza O të futura në materiale jo korrozive. Përfshire bulonat, dadot dhe rondele prej çeliku të galvanizuar si dhe guarnicione.

Të gjitha pjesët në kontakt me ujin do të jenë të miratuara për ujë të pijshëm sipas DVGW (bazat e testeve DVGW GW337), KTW W270, WRAS, ose ACS.

Valvulat thike duhet të jenë të përshtatshme për operim me timon dore ose bosht teleskop të zgjatur.

Valvulat duhet të jenë të projektuara për temperaturat e shërbimit nga 0 °C (pa përfshirë ngricën) deri në 40 °C dhe për temperaturat e ruajtjes midis -20 °C dhe 70 °C.

11.17.3 Timoni i komandimit

Timoni i komandimit të valvulës duhet të jetë prej gize duktile, me veshje epoksi kundër korrozionit pluhur ose ekuivalent me rondele dhe bulon fiksues prej çeliku të galvanizuar.


11.17.4 Boshti teleskopik i zgjatur

Boshti teleskopik i zgjatur për valvulën thikë për instalimet në tokë duhet të jetë me tub mbrojtës dhe rrëshqitës PE, teleskopike, me pajisje bllokuese kundër shkëputjes, me kokë katrore të galvanizuar GGG 40, lartësi e rregullueshme, DN 80 - DN 200: me kapak të rrumbullakët me fileta për fiksion në trupin e valvulës.

Më poshtë janë paraqitur foto të boshtit teleskopik dhe pjesëve të tij.



Kapak Sipërfaqësor
Gjeokompozit Tipi 4056 DI
160mm, H270mm



Mbështetëse te kapakut
sipërfaqësor



Pajisje për Komandimin e
valvulës (TELESKOP)

11.17.5 Pusetat sipërfaqësore

Pusetat sipërfaqësore për valvulën thikë duhet të jetë me kapak sipas standardit shqiptar ose ekuivalent me DIN 4056.

Materiali: GG 25, trup i veshur me bitum ose ekuivalent, me kapak te veshur me pluhur epoksi.

11.17.6 Bazamenti i betonit për pusetat sipërfaqësore

Bazamenti i betonit për pusetat sipërfaqësore për valvulën thikë duhet të jetë sipas standardit shqiptar ose ekuivalent me DIN 4056.

11.17.7 Valvula flutur

Valvula flutur koncentrike, PN 16, duhet të jetë me veshje të brendshme elastike të fiksuar për aplikim në sistemet e ujit dhe duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- Dimensionet e valvulës sipas EN 558, ser. 13
- Presion nominal 16 bar.
- Fllanxhat sipas EN 1092.
- Materiali: gizë duktile.
- Trupi i valvulave duhet të jetë i mbrojtur nga korrozioni me një shtresë Epoksi, 200 µm.
- Materiali i veshjes së brendshme do të jetë EPDM i certifikuar për ujë te pijshëm.
- Izolimi i boshtit duhet të jetë i inkorporuar në kontakt ndërmjet veshjes së brendshme dhe boshtit/diskut. Për mbrojtjen nga pluhurat duhet të jenë me unaza O.
- Me bosht për aktuator.
- Temperatura maksimale e operimit duhet të jetë së paku 70 °C.

Prodhuesi duhet të ketë një sistem të certifikuar të cilësisë ISO 9000, të audituar nga një palë e tretë e pavarur.

Standardet e projektimit dhe të materialeve:

- EN 1074-1 dhe -2 (furnizimi me ujë, valvulat izoluese)
- EN 593 (valvula industriale flutur)
- EN 558 (distanca faqe më faqe)
- EN 1092-2 (flanaxhat)
- ISO 5211 (akuatori i komandimit)
- EN 12266 (testi i rrjedhjes)
- EN 1563 (gize)
- EN 10088 (çelik i pandryshkshëm (inoks))
- DIN 30677-2 (veshja)
- EN 681 (guarnicionet izolues te ujit)

11.17.8 Valvulat e ajrimit

Valvula automatike e ajrimit me dhomë dyshe duhet të jetë sipas EN 1074-4, PN 16, flanaxhat me vrima sipas EN1092-2, trupi: gize duktile, guarnicionet gomë EPDM, ajrim i volumeve të mëdha të ajrit gjatë mbushjes dhe zbrazjes së tubacioneve, ajrim i volumeve të vogla të ajrit ndërsa tubacionet janë nën presion, me veshje të brendshme dhe të jashtme prej epoksi. Përfshire bulonat prej çeliku të galvanizuar, dadot, rondelet dhe guarnicionet.

11.17.9 Valvulat e kontrollit

Dimensionet e instalimit sipas standardit Shqiptar ose ekuivalent me DIN 3202 F6, presioni i punës i lejuar vetëm në një drejtim (drejtim sipas shigjetës). Valvula e kontrollit lejon: rrjedhën e papenguar të ujit pa turbulenca, mbyllje të avashtë dhe të sigurt, dhe hapje me ndryshime të vogla të presionit. Valvula e kontrollit duhet të sigurojë mundësinë e instalimit në tubacione vertikale ose horizontale.

- Diametri nominal: siç tregohet në Vizatime
- Materiali i valvulës së kontrollit: Gize duktile
- Presioni nominal: PN 10/16
- Presioni i testimit sipas: Standardit shqiptar ose ekuivalent me DIN 3230
- Fllanxha e bashkimit: Sipas DIN 2501

Bashkimet me flanaxha përfshijnë:

- Dado standarde sipas DIN EN ISO 4034
- Vida standard sipas DIN EN ISO 4016
- Rondele standard sipas DIN EN ISO 7091
- Guarnicionet unazore prej gome me hyrje çeliku standard sipas DIN EN 1514-1

11.17.10 Valvulat e reduktimit të presionit (PRV)

Të gjitha kërkesat e mëposhtme duhet të përmbushen për valvulat e reduktimit të presionit.

Valvulat e reduktimit të presionit duhet të jetë sipas EN 1074, me flanaxha, valvula sferike, me operim hidraulik, me manovrues diafragmë, me dy manometra, duke reduktuar presionin pavarësisht nga luhatja e kërkesës për ujë; Trupi i valvulës PN16, flanaxhat me vrima sipas EN 1092-2; Trupi i valvulave prej gize duktile, i mbrojtur me veshje epoksi brenda dhe jashtë me një trashësi minimale të veshjes 250µm; Valvula kryesore qendrore, me unazë çeliku të pandryshkshëm, të zëvendësueshëm; Të gjithë komponentët e valvulës të mirëmbahen dhe riparohen pa hequr valvulën nga tubacioni; Boshti i valvulave prej çeliku të

pandryshkshëm; Membrana e bërë nga neoprenë të armuar; Sistemi i kontrollit me dy drejtime të rregullueshme, me komandim të drejtpërdrejtë, valvul pilot për reduktimin e presionit, një valvul gjilpërë dhe valvola izoluese. Kontrolli i valvulës pilot duhet të përfshijë një filtër "vetë-pastrimi" të mirëmbajtjes. PRV duhet të jenë të certifikuara për përdorim me ujë të pijshëm.

Furnizimi dhe dorëzimi përfshijnë të gjitha bulonat dhe dadot prej çeliku të galvanizuar si dhe rondelet dhe guarnicionet.

Valvula e reduktimit të presionit duhet të testohet Hidraulikisht dhe të përshtatet nga fabrika sipas kërkesave të klientit sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit.

11.17.11 Valvula për ruajtjen e presionit

- Valvula për ruajtjen e presionit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:
- Me mbështetje elastike dhe guarnicion i butë
- Kontrollohet nga prurja
- Kontroll pilot për të mbajtur presion konstant nga rrjedha e sipërme
- Përbëhet nga valvula kryesore boshti i kontrollit dhe valvula pilot
- Niveli i presionit në rrjedhën e sipërme: 1 - 20 bar
- Të gjitha pjesët e brendshme të arritshme nga lart pa hequr tubin
- Me tregues të pozicionit dhe 2 manometra
- Trup të drejtë
- Materiali i trupit: gize
- Diafragma: NBR ose EPDM
- Materiali izolues: EPDM
- Boshti i kontrollit dhe vidat lidhëse prej çeliku të pandryshkshëm;
- Të jetë llogaritur kundër kavitetit
- Presioni nominal: PN 16
- Fllanxhat sipas EN 1092-2
- Dimensionet sipas EN 558, Seria 1
- Testimet për presionin dhe funksionimin ndaj EN 12266 dhe EN 1074
- Mbrojtja nga korrozioni i pjesëve të trupit: Veshja e brendshme dhe e jashtme me epoksi ngjyrë blu "mbrojtje nga korrozioni për industrinë e rëndë" sipas DIN 30 677-2, trashësia e shtresës: të paktën 250 µm
- E certifikuar për ujë të pijshëm
- Të gjitha pjesët e lagura duhet të plotësojnë kërkesat sipas DVGW (bazat e testit DVGW GW337), KTW W270, WRAS, ose ACS.

11.17.12 Valvulat e kontrollit të prurjes

Valvulat sferike të kontrollit sipas EN 1074-5 do të ketë një trup prej gize duktile (GGG-50), duhet të jetë me model të drejtë, të pajisur me një piston, bosht dhe një cilindër të fiksuar prej çeliku të pandryshkshëm, i pajisur me timon dore.

Pistoni i kontrollit i udhëzuar nga unaza rrëshqitëse prej PTFE ose NBR i cili lëviz brenda këtij cilindri që mbyll ose hap valvulat sipas pozicionit të kontrollit të kërkuar.

Valvulat e kontrollit të prurjes duhet të jetë e pajisur me një tregues mekanik të pozicionit.

Valvula e kontrollit të prurjes duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Presioni nominal: PN 16
- Fllanxhat sipas EN 1092-2
- Testimet për presionin dhe funksionimin ndaj EN 12266 dhe EN 1074
- Mbrojtja nga korrozioni i pjesëve të trupit: Veshja e brendshme dhe e jashtme me epoksi ngjyrë blu "mbrojtje nga korrozioni për industrinë e rëndë" sipas DIN 30 677-2, trashësia e shtresës: të paktën 250 µm
- E certifikuar për ujë të pijshëm
- Të gjitha pjesët e lagura duhet të plotësojnë kërkesat sipas DVGW (bazat e testit DVGW GW337), KTW W270, WRAS, ose ACS.

11.17.13 Nyja për montim-çmontimin (kompensator montimi)

Nyja për montim-çmontimin duhet të jetë e certifikuar për ujë të pijshëm dhe përbëhet nga tre fllanxha sipas standardit ISO 7005. Trupi duhet të bëhet nga çeliku, brenda dhe jashtë veshur me epoksi. Përfshirë: bulona, dado, rondele dhe guarnicione.

11.17.14 Filtrat

Filtrat duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

Filtri do të jetë tipi "Y" i bërë nga giza duktile, sita prej çeliku të pandryshkshëm, fllanxhat me vrima sipas EN1092-2. Përfshire bulonat prej çeliku të galvanizuar, dadot, rondelet dhe guarnicionet të aprovuara për ujë të pijshëm.

11.17.15 Përshtatësit (adaptorët) me fllanxha për tubacione me materiale të ndryshme

Përshtatësit me fllanxha do të jetë me tolerancë të madhe, për mundësi lidhje të llojeve të ndryshme të tubave prej gize duktile, me guarnicion gome EPDM dhe mbrojtjen anti-korrozive epoxy.

Përshtatësi me fllanxhë fllanxhës me fole për tuba PE / PVC.

Përfshire: bulonat prej çeliku, Dado, rondelat dhe guarnicionet.

11.17.16 Hidrantët

Hidrantët përfshijnë të gjitha materialet, punën, mjetet dhe pajisjet e nevojshme për furnizimin dhe instalimin e elementeve të hidrantëve.


Hidranti duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Hidrant zjarri mbi sipërfaqen e tokës DN 80 sipas EN 1074-6
- Me manikotë B
- Fllanxhat sipas EN 1092-2, PN10
- Me drenazhim automatik
- I rrotullueshëm
- I certifikuar për ujë të pijshëm sipas DVGW (baza e testimit DVGW GW337), KTW W270, WRAS, ose ACS
- Materiali: gizë duktile
- Mbrojtja nga korrozioni: Pjesa e sipërme (Upper barrel) dhe kapaku: Veshje epoksi, nga jashtë veshje shitesë me poliestër

Elementet plotësues të furnizimit dhe vendosjes së hidrantit sic janë të dhëna në vizatimet përkatëse.



Hidrant mbi
toke, PN 16,
DN80 2C 1B



Beryll 90°, gize
per lidhje me
flanaxha, Tipi N
sipas EN 545, DN
100




Tub bashkimi
me flanaxhe
dyshe DN 100,
PN10/16,
gjatesia 220mm



Pershtatese

Fllanxhe, PE tipi i
gjate DN 110 per
bashkim me
bashkim me
elektrofuzion,
PN16



Fllanxhe PP e
zeze me
perforcuese
celiku SDR11 DN
110, PN16



Valvul tipi thike,
Gize, DN 100,
me flanaxha DN
110mm, PN16

Standardet:

- I projektuar sipas EN 1074 – 6:2008 dhe EN 14384:2005
- Standardi i hapjes se vrimave te flanaxhës EN1092-2 (ISO 7005-2), PN16

Testet qe duhet te garantoj:

- Testi hidraulik sipas EN 1074-6 / VP 325 (3321)
- Testi hidraulik sipas EN 1074-1 dhe 2 / EN 12266
- Aprovimi sipas CE Reg. No. 0620-CPR-6122

12 PUNIMET ELEKTRIKE PËR LINJËN TM

12.1 Shtylla beton arme te centrifuguara

12.1.1 Të përgjithshme

Shtyllat e betonit të standardizuara ne kete specifikim, do të përdoren në ndërtimin e linjave ajrore te TM dhe TU. Kontraktori do të optimizojë projektin e linjës duke përzgjedhur kampaten nominale, gjithmone duke marrë në konsideratë kushtet e projektimit të specifikuara më poshtë.

Për trasene e linjes në një vend të hapur për të kapërcyer pengesa të ndryshme, do të përdoren shtylla me lartësi të përshtatshme. Shtyllat duhet te jene me seksion rrethor me nje vrime te qenderzuar mire pergjate gjithë gjatesise se shtyllës dhe me diameter qe ritet ne menyre uniforme nga maja deri ne fund te shtyllës. Cilësia e betonit dhe armimi i tij prej çeliku të përforcuar do të jetë sipas standardeve. Sipërfaqja e jashtme e betonit do të jetë e sheshtë, pa brima ose të çara, siç është përcaktuar në standarte. Vrima ne maje te shtyllës duhet te jete e mbyllur me kapuc betoni per te mos lejuar futjen e ujit. Kapaciteti(momenti) i shtyllës shprehet me ngarkesën ne perkulje të aplikuar poshtë kokës së shtyllës, siç e përcakton standardi.

Gjatësia e shtyllës duhet të jetë 9 m, 10 m dhe 12 m. Te kene marketim CE

TE DHENA TE PERGJITHESHME		
Tensioni nominal	kV	10 ose 0.4
Frekuenca	Hz	50
Tensioni me i larte I sistemit	kV	12 ose 0.66
Tempertaura maksimale per llogaritjen e shigjetes se varjes	°C	60
Temperature minimale	°C	-20
Trashesia e akullit ne percjelles	mm	10
Shpejtesia maksimale e eres	m/s	35
Mesataraja e rreshjeve vjetore	mm	1000-1500

12.1.2 Detaje teknike

Ky specifikim mbulon projektimin, materialet, prodhimin, inspektimin, testimin, skicimet, transportin dhe dorëzimin e shtyllave të betonit te drejta, te paratensionuara 9, 10 dhe 12 m.

12.1.3 Standarded

Projektimi, prodhimi dhe testimi i shtyllave duhet te jete ne perputhje me standartet e me poshtme:

- SSH EN 12843 Produkte të parafabrikuara të betonit - Shtyllat dhe traret(Concrete prefabricates- masts and poles)
- SSH EN 10080 Concrete reinforcement steel- Reinforcement steel suitable for welding- General terms(Çelik për përforcimin e betonit - Çelik i përforcuar i saldueshëm - Të përgjithshme)
- SSH EN EN 12620 Agregatet e betonit(Concrete aggregate)
- SSH EN EN 1097- 1 Provat për vetitë fizike dhe mekanike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës ndaj fërkimit (mikro-Deval)(Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 1: Determination of the resistance to wear (micro-Deval)
- SSH EN 1097-2 Provat për vetitë mekanike dhe fizike të agregateve - Pjesa 2: Metoda të

përcaktimit të rezistencës ndaj copëzimit (Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 2: Methods for the determination of resistance to fragmentation

- SSH EN 1367- 1 Prova për vetit termike dhe klimaterike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës në ngrirje dhe shkrirje (Tests for thermal and weathering properties of aggregates - Part 1: Determination of resistance to freezing and thawing)
- SSH EN 196- 1 Metoda prove për çimento - Pjesa 1: Përcaktimi i fortësisë (Methods of testing cement - Part 1: Determination of strength)
- SSH EN 196- 7 Metoda prove për çimento - Pjesa 7: Metoda për marrjen dhe përgatitjen e mostrave të çimentos (Methods of testing cement - Part 7: Methods of taking and preparing samples of cement)
- SSH EN 197-1 Çimento - Pjesa 1: Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot e zakonshme (Cement - Part 1: Composition, specifications and conformity criteria for common cements)
- SSH EN 197-2 Çimento - Pjesa 2: Vlerësimi i konformitetit (Cement - Part 2: Conformity evaluation)
- ISO 1920- 1 Testimi i betonit - Pjesa 1: Marrja e mostrës së betonit të sapo përgatitur (Testing of concrete - Part 1: Sampling of fresh concrete)
- ISO 1920-3 Testimi i betonit - Pjesa 3: Marrja dhe trajtimi i mostrës (Testing of concrete - Part 3: Making and curing test specimens)
- ISO 1920-4 Testimi i betonit - Pjesa 4: Rezistenca e betonit të ngurtësuar (Testing of concrete - Part 4: Strength of hardened concrete)

12.1.4 Testimi

Testet për betonin duhet të behen në përputhje me EN 13369:2004 klauzola 5.1.

Matja e dimensioneve

Dimensionet do të maten me pajisje që kanë një saktësi $\pm 1\text{mm}$ me përjashtim të gjatësisë së shtyllës që do të matet me saktësi $\pm 0,5\%$. Pajisjet matëse dhe metodat e testimit do të përshkruhen në dokumentet e kualitetit të prodhuesit.

Veshja me beton

Testimi i betonit veshes perforcues, mund të jenë shkatërruese ose jo-shkatërruese, do të kryhet me një saktësi prej $\pm 2,0\text{ mm}$. Metoda e përdorur për këtë testim do të përshkruhen në kontrollin e prodhimit fabrikë.

Rezistenca mekanike

Testi është i përbërë nga:

- Matja e deformimit gjatë aplikimit të momentit të perkuljes
- Ngarkesa deri në shfaqjen e plasaritjen e betonit (load when the first transversal crack appears in case of pre-stressed concrete)
- Ngarkesa perfundimtare (ultimate load)
- Ngarkesa perfundimtare në përdredhje (ultimate torsional load)

Testi në perkulje

Testi do të kryhet në një shtyllë horizontale, mbështetur fort, të shtrirë në një një support të levizshëm për të shmangur efektet për shkak të peshës dhe të lejoje levizjen e lirë të saj. Nëse nuk definohet as në deklaratën e prodhuesit apo në kërkesat e blerësit, ngarkesa do të zbatohet në 90° (\pm

5 °) te aksit qendror te shtylles, jo te deformuar. Shpejtesia e ngarkimit, aplikuar nen kontrollin e forcave duhet te jete i kufizuar ne 100N/s pa ndonje shok apo impakt. Një saktësi prej $\pm 3\%$ është e nevojshme për ngarkesat e aplikuar të testit dhe në deformimet e matura.

Testi elasticitetit

Testi I kapacitetit mbajtes

Testi perdredhjes

Testi do të kryhet në një shtyllë në pozicion horizontal. Maja e shtylles do te jete e lire dhe deformimi duhet te shmanget. Testi gjatesise embedment eshte percaktuar ne kerkesat e bleresit ose ne deklaraten e prodhuesit. Ajo përcakton seksion kryq embedment. Rritja e momentit rrotullues do te kufizohet ne 100Nm/s pa ndonje shok apo impakt. Një saktësi prej $\pm 3\%$ do të kërkohet mbi ngarkesat e aplikuar të testit.

12.1.5 Zgjedhja e shtyllave

Shtylla ndermjetese (mbajtese)

Një shtyllë ndermjetese përdoret kur përcjellësit/telat janë varur ne shtyllë dhe tensioni mekanik është i njëjtë nga të dy anët. Në këtë rast, supozohet që shtylla të perballoje nje forcë në rënie (perpendikular poshte) dhe një forcë anësore, por jo një forcë gjatësore. Këto shtylla përdoren aty ku linja ajrore vazhdon në mënyrë lineare ose kthehet në një kënd të ngushtë. Në raste të tjera, do të përdoret shtylla ankerore.

Aplikimi :

Linja lineare ose këndore me kend
 $\leq 20^\circ$ Lloji i shtyllës 9/6, 10/6 or
 12/6

Shtyllat Tensionuse/Ankerore/ Fundore/Shtyllat pa vazhdim (Ankerore Fundore) (Dead-end poles)

Shtyllat në fund të një seksioni linear të linjës, aty ku linja mbaron ose merr kënd në një drejtim tjetër quhen shtylla tensionuse/Ankerore/Fundore/Ankerore Fundore. Këto shtylla duhet të perballojne forcat gjatesore të seksioneve dhe gjatesive me te medha te percjellesave. Zakonisht, ato kane nje konstruksion ndertimi me te rende.

Aplikimi:

këndi ($>20^\circ$) - ($\leq 60^\circ$)
 Lloji i shtyllës 9/10, 10/10 or 12/10

këndi ($>60^\circ$) - ($\leq 90^\circ$) ose shtylla ankerore , fundore, ankerore fundore
 Lloji i shtyllës 9/15, 10/15 or 12/15

12.1.6 Ndertimi

Shtyllat duhet të jenë në gjendje t'i rezistojnë të gjitha rasteve të specifikuar të ngarkesës, duke përfshirë erën mbi shtylla dhe tërheqjen dytësore nga devijimi, shmangia dhe lëvizja e bazamentit. Shtylla do t'i rezistojnë ngarkesave pa pasur demtime si dhe duke mos tejkaluar limitet e devijimeve te specifikuar.

Shtyllat do t'i rezistojnë kushteve të ngarkesës, duke përfshirë edhe faktorë specifik të ngarkesës. Projektimi i shtyllës do të përfshijë toleranca për faktoret e ngarkesës nga trajtimi, transporti dhe ngritja pa demtime e saj, si dhe deformimin e përhershëm apo dëmtimin e shtyllës.

Shtyllat do të projektohen në mënyrë të tillë që qendrueshmeria në thyerje e shtyllës e tejkalon forcën e kërkuar, e cila llogaritet nga ngarkesat e shërbimit të aplikuar në shtyllë.

12.1.7 Materialet

Te gjitha ankoruset e siguruara nga fabrika duhet të jenë të galvanizuara në të nxehtë ose material jo korroziv. Pllakat kadmium dhe material alumini nuk duhen përdorur. Te gjitha materialet duhet të jenë jo korrozive prodhuar enkas për këto qëllime bazuar në rekomandimet e fabrikës. Nëse prodhuesi i konsideron heqjen e paisjeve levizëse të nevojshme apo të përshtatshme, ato mund të jenë të derdhura në shtyllë me paisje levizëse.

Betoni duhet të ketë minimum pas 28 ditësh një fortësi në shtypje prej 5,000 psi me një vlerë maksimum të përmbajtjes së uje-cimento 0.40. Fortësia me e madhe dhe vlera me e vogël uje-cimento kompensojnë kërkesat për celikun.

Agregati i hollë duhet të jetë rere natyrale, me grimca të pastra të forta, të ashpra dhe me të gjitha specifikimet e përfshira më poshtë. Agregati duhet të jetë i një klase të mirë.

Agregati i ashprë duhet të jetë i pastër, me gurë të thyer dhe i një cilësie të mirë. Agregati duhet të jetë i lagur me ujë para se të përdoret në beton.

Agregati duhet të testohet për të përcaktuar ndonjë reaksion alkalin-agregat. Gurët e copëtuar ose gurët e copëtuar pjesërisht janë burimi i agregatit.

Uji duhet të jetë i pastër pa përmbajtje vajrash, acidesh, alkalinesh, kriprash ose material organikë apo material të tjera të dëmshme.

Përzjerja nuk duhet të përmbajë jone kloruri në sasi që mund të shkaktojnë në përmbajtjen totale të klorurit në beton që të tejkalojë 0.4 pound për meter kub

Vetite mekanike të celikut të paratensionuar, celik i perforcuar dhe perforcimet spirale duhet të jenë në përputhje me standartet e përdorura.

12.1.8 Tokëzimi i shtyllave

Do të përdoret një përcjelles tokëzimi i brendshëm. Për lidhjen e përcjellesit të tokëzimit të shtyllës me tokëzimin e jashtëm do të përdoren elemente të filetuara nga brenda (dado), pozicioni i të cilëve në shtyllë tregohet në vizatimet përkatëse dhe sqarohet më poshtë.

Fija e celikut e përfshirë në lidhje do të jetë tokëzimi i brendshëm i shtyllës. Minimumi një përcjelles celiku gjatësor (me diametër jo më të vogël se 12 mm) do të lidhet elektrikisht me elementet prej bronzi (dado bronzi M12) të filetuara nga brenda, të cilët janë vendosur në majë dhe në fund të shtyllës. Dadoja e sipërme do të vendoset në një distancë 60 cm poshtë majës së shtyllës, kurse e poshtmeja do të vendoset në një distancë 30 cm mbi sipërfaqjen e tokës (Groundline).

12.2 Izolatorë linje 10kV 12kN

12.2.1 Të përgjithshme

Materialet e furnizuara duhet të jenë të prodhimit standart në përputhje me specifikimet e mëposhtme. Te gjitha materialet do të jenë të projektuara për të siguruar funksionim të kënaqshëm sipas kushteve klimatike që mizoterojnë në vend, pa ndryshuar, përqesuar apo ritur tensionin e panevojshëm në çdo pjesë. Materialet do të punojnë në mënyrë të kënaqshme për variacione të ngarkesës dhe tensionit, lidhjeve të shkurtera apo kushteve të tjera të sistemit, me kusht që ato të mbeten brenda vlerave të lejuara të paisjeve. Te gjitha materialet e përdorura në prodhimin e produkteve duhet të jenë të cilësisë me të mirë dhe të jenë lloji të përshtatshëm për punën dhe kushtet e specifikuar.

12.2.2 Kërkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat me dimensione
- Manual perdorimi

12.2.3 Kushtet e sistemit

a	Specifikime	Njesia	Vlera
1	Tensioni nominal ne sistem	kV	10
2	Tensioni me larte ne sistem	kV	12
3	Frekuenca e sistemit	Hz	50
4	Numri I fazeve	Nr	3 faze
5	Sistemi I tokezimit		I izoluar
b	Kushtet atmosferike		
1	Temperatura maks. e ambientit		50°C
2	Temperatura max. mesatare ditore		30°C
3	Temperatura minimale e ambientit		-10 °C
4	Lageshtia relative maks		90%
5	Lartesia maksimale mbi nivelin e detit		1500m
6	Shpejtesia maksimale e eres		126 km/h
7	Ndotja		mesatare

12.2.4 Përshkrimi, kërkesa dhe të dhëna

Materiali i izolatoreve duhet te jete porcelain C 110.

Izoloret duhet te garantojne nje qendrushmeri mekanike ne perkulje ne qafen e tyre 12kN. Izoloret ne pjesen e brendshme duhet te perforcohen me sulfurgrafit si dhe te mbrohen me nje shtrese te holle paste siliconi per mos depertimin e lageshtise.

Ngjyra e izolatoreve duhet te jete kafe e lustruar.

Ne pjesen e jashtme te izolatoreve duhet te stamposet tipi I izolatorit, emir I prodhuesit, tensioni nominal, qendrushmeria ne perkulje ne kN, viti I prodhimit.

Kunji i izolatorit duhet te behet me celik te galvanizuar ne te nxehte, minimumi M20 Kunji me dado dhe rondele eshte pjese perberese e izolatorit te furnizuar.

Izolatori transportohet i ndare nga kunji,dadoja dhe rondelja.

Te gjitha pjeset perberese per montimin e izolatorit duhet te prodhohen me te njejtin standart si dhe trupi i izolatorit.

Te gjitha pjeset metalike duhet te mbrohen nga korozioni me galvanizim ne te mxehte. Testet e izolatoreve duhet te kryhen ne perputhje me standartet me te fundit IEC.

Te dhena Teknike

Pershkrimi	Sasia	Vlera
Distanca e izolimit	mm	320

Pesha totale	Kg	2.5
Lartësia totale	mm	166
Lartësia deri ne qendër të qafës	mm	128
Diametri i qafës	mm	80
Diametri i kokës	mm	100
Sforcimi i lejuar në qafë	kN	12
Numri i unazave	pcs	2
Tipi i materialit (porcelanit)	-	C 110
Tensioni nominal	kV	10
Qendrushmeria ndaj tensionit teshkarkimeve 1,2/50 ^μ sec	kV	70
Qendrushmeria ndaj tensionit me frekuence 50Hz	kV	28
Prova me tension AC në kushte të thata	kV	35
Prova me tension AC në kushte me lageshtire	kV	28
Prova me tension AC në të thatë (për valën +)	kV	78
Prova me tension AC në të thatë (për valën -)	kV	110
Prova me U _{max} , në të thatë	kV	50
Prova me U _{max} , në lageshtire	kV	36

12.2.5 Standartet referuese

Izolatoret e TM duhet te jene ne perputhje me Standartin IEC 383 ose ekuivalentin e tij.

12.2.6 Aplikimi

Izolatoret duhet te plotesojne dy kushte kryesore:

- Mbeshtetja mekanike e percjellesave te zhveshur ne strukturen mbeshtetese (traverse).
- Izolimi elektrik I percjellesave te zhveshur te linjes.

Keta izolatore perdoren per vendosjen e percjellesave te zhveshur te linjave ajrore me tension 10kV, si per shtyllat ndermjetese ashtu edhe per shtyllat kendore dhe ankerore brenda qendrushmerise se lejuar te tyre. Per me teper keta izolatore perdoren per mbajtjen e percjellesave te zhveshur ne tipe te ndryshme te konstruksioneve mekanike mbajttese (traverse) si dhe te tipeve te ndryshem te shtyllave apo bazamenteve mbajtes metalik. Jetëgjatësia minimumi 30 vjet.

12.2.7 Montimi


Izolatoret duhet te montohen ne gjendje te paster, jo me yndyre si dhe ndotje te tjera te siperfaqes se tyre. Keta izolatore shtrengohen ne konstruksioni mbajtes metalik (traverse) me bulon dhe rondele M20. Gjatesia e bulonit te izolatorit varet nga tipi I konstruksionit mbajtes metalik te tyre. Izolatoret duhet te perdoren ne perputhje me stampen e treguar nga prodhuesi.

12.3 Litar Alumin-Çeliku

12.3.1 Të përgjithshme

Keto specifikime percaktojne te dhenat teknike te pergjitheshme , per blerjen dhe pranimin e percjellesit AIÇ te zhveshur, ne forme litari , i cili do te perdoret ne linjat e tensionit te larte, dhe linjat e

tensionit të mesëm. Përcjellesi AlÇ mund të përdoren edhe në linjat e tensionit të ulët, por në mënyrë me të kufizuar. Ky material duhet të jetë i konform me standardin IEC ose standarde të tjera dhe të ketë markim CE.



12.3.2 Kërkesa të detyrueshme

Është e detyrueshme që furnizuesi të sigurojë si pjesë integrale të ofertës së tyre, dokumentat e mëposhtme:

- Certifikatë e fabrikës ISO 9001 ose ISO 9002
- Të dhënat teknike si kërkohen më poshtë
- Të gjitha test reportet nga fabrika
- Tabelën për tensionin në kampatë – Hapsirë 70-100m në çdo 10 m
- Skicat së bashku me dimensionet
- Të ketë markim CE

12.3.3 Kushtet e sistemit

a	Te dhënat e sistemit	Njesia	Vlera
1	Tensioni më i lartë i sistemit	kV	Deri në 38.5
2	Tensioni nominal	kV	Deri në 35
3	Frekuenca	Hz	50
4	Numri i fazëve	Nr	3 faze
5	Sistemi i tokezimit		izoluar
b	Kushtet atmosferike		
1	Temperatura max. e ambientit		40°C
2	Temperatura min. e ambientit		-10°C
3	Lageshtia relative max		80%
4	Lartësia max mbi nivelin e detit		1000m
5	Ndotja		mesatare

12.3.4 Pershkrime,kerkesa dhe te dhena

Percjellesi AlÇ, duhet te kete nje ndertim koncentrik me fije te holla telash Al , ne te cilin pesha dhe percjellshmeria e aluminit jane te kombinuara me fortesine e celikut.Ai do te ndertohet nga nje ose me shume shtresa telash alumin te terhqur fort, te cilat ne menyre rrethore , vendosen rreth berthames se celikut(percjellesi celikut)

Berthama e celikut mund te ndertohet me nje percjelles celiku me nje mbulesa te vetme zinku , ose nga me shume percjellesa celiku te zinkuar vendosur ne menyre koncentrike.

Percjellesi i aluminit duhet te kete nje grade pastertie elektrike prej 99.7%

Te dhena teknike

Seksionet					Diametri percjellesve perberes te dellit		Diametri jashtem i percjellesit
Nominale		AL	Celik	Total	AL	Celik	
AL	Celik						mm2
mm2	mm2	mm2	mm2	mm2	mm	mm	mm
16	2.5	15.3	2.6	17.9	6/1.80	1/1.8	5.4
25	4	23.8	4	27.8	6/2.25	1/2.25	6.8
35	6	34.3	5.7	40	6/2.70	1/2.70	8.1
50	8	48.3	8	56.3	6/3.20	1/3.20	9.6
70	12	69.9	11.4	81.3	26/1.85	7/1.44	11.7
95	15	94.4	15.3	110	26/2.15	7/1.67	13.6
120	20	121.6	19.8	141	26/2.44	7/1.90	15.5
150	25	148.9	24.2	173	26/2.70	7/2.10	17.1
185	30	183.8	29.8	214	26/3.00	7/2.33	19
240	40	243	39.5	283	26/3.45	7/2.68	21.9
300	50	304.3	49.5	354	26/3.86	7/3.00	24.5

12.3.5 Standartet referuese

Te dhenat e percjellesit e AIC duhet te perputhen me kerkesat e zbatueshme nga standartet IEC 61089 , DIN 48 204 dheBS EN 50 182 ose cdo standart tjeter ekuivalent.

12.3.6 Përdorimi

Percjellesit e Alc gjejne perdorim ne ne linjat e tensionit te larte, dhe linjat e tensionit te mesem.Percjellesi AlÇ mund te perdoren edhe ne linjat e tensionit te ulet ,por ne menyre me te kufizuar. Rekomandohet qe percjellit Alc duhet te perdoren per 35 vjet.

12.3.7 Kerkesa per instalimin

Per te shtrire dhe terhequr percjellesit Alc , duhet te perdoren paisjet si makara , etj.

Makaraja e cila qe do te perdoret per te shtrire percjellesin, duhet te leviz lirshem, siperfaqja e saj duhet te jete e paster dhe e bute ne menyre qe percjellesi te mos mblidhet gjate rruges. Gjatesia e shiritit mbledhes duhet te jete sa 5x i diametrit te percjellesit.Ndersa gjatesia e mbuleses se jashtme duhet ete jete sa 50x diametri te percjellesve.

Gjate montimit,ferkimi I percjellesit duhet eleminuar ,percjellesi nuk duhet te prek ne toke, ndertesa apo objekte te tjera.

Rrezja minimale e perkuljes se percjellesit- diametri i kabllit eshte 25xdiametrin e percjellesit per ngarkese deri me 50Mpa dhe 30 x diametrin e percjellesit per ngarkesa me te medha. Ngarkesa maksimale e lejuar

nuk duhet tejkaluar, dhe terheqja e percjellesit duhet monitoruar. Rekomandohet perdorimi i nje paisje per te regjistruar nivelin e ngarkeses (nivelin e ngarkeses se percjellesit)

Frenat duhet të jetë e pajisur me një nyje mekanike për të kontrolluar tërheqjen, dhe barabani i percjellesit duhet te pajiset me nje paisje rregulluese limituese terheqese me mbyllje automatike. Perdorimi i saj eshte i nevojshem per seksionet 95 mm² e siper.

Gjate shtrirjes se percjellesit Alc, duhet te kemi parasysh qe pjesa e pare e percjellesit te terhiqet ngadale me shpejtesi rreth 5m/min. Me pas terheqja e mund te kaloj maksimumi deri me 60m/min.

12.4 Sistemi tokëzimit

12.4.1 Të përgjithshme

Shtyllat e tensionit të mesëm që do vendosen të reja do të tokëzohen sipas detajeve të projektit. Për tokëzimin e tyre do përdoret nga një elektrode në formë kryqi 50X50X5 cm FeZn me gjatësi L=150cm e cila lidhet me bulonin e poshtëm të shtyllës me shirit tokëzimi 30x3. Buloni isipërm i shtyllës lidhet me transversën metalike.

12.4.2 Specifikimet teknike, përcjellësi FeZn 30x3mm

Më poshtë paraqitet në formë ilustruese, përcjellësi hekuri i zinguar në të nxehtë me dimensione 30x3 mm, 0.75 kg/m.



Figura 12-1: Përcjellës FeZn

12.4.3 Specifikimet teknike, elektroda kryq FeZn

Elektrodë në formë plusi, çelik i galvanizuar në të nxehtë me seksion 50X 50X5 mm, gjatësi 1500 mm, 5.4 kg, për tu futur në tokë. E përbërë nga një piastër në formë flamuri me tre vrima për lidhjen e përcjellësit, shiritit apo aksesorëve të ndryshëm.

TE DHENAT TEKNIKE

- Formë kryqi “+” jo më pak se 50x5mm, H=1.5 m
- Cilësia e çelikut DIN 17 100
- Pajisur me pllakë bashkuese
- Paisur me morseten per bashkimin me percjellesin me diameter deri 13mm i përputhshëm me DIN 48 – 452
- Shtresë zinku – minimumi 70 mikron
- Kapikordat prodhohen ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre.

IDENTIFIKIMI DHE PAKETIMI

Elektrodat do të paktohen në kuti kartoni. Çdo kuti do të përmbajë informacion për:

- llojin e elektrodës
- përmasat e elektrodës
- prodhuesin
- vitin e prodhimit
- pesha bruto
- numrin e kutisë




Figura 12-2: Elektrodë tokëzimi

12.4.4 Specifikimet teknike, aksesor lidhje percjelles FeZn-elektrode FeZn

Morset kalimtare me seksion 40X3 mm për lidhjen e percjellësit 30x3 FeZn me elektrodën në formë kryqi FeZn, e përshtatëshme për tu futur në tokë.



Figura 12-3: Morseta lidhëse, lidhje percjelles FeZn-elektrode FeZn

13 Punimet elektrike për infrastrukturën e fibrave optike

13.1 Punimet me tubat


Tubat e një rrjeti të telekomunikacionit synojnë të mbrojnë kabllot si në kohën e instalimit dhe gjatë punës. Tubat mund të pajisen në sipërfaqen e brendshme të vijëzuara në drejtim gjatësor, duke pasur qëllimin e lehtësimit të vendosjes së kabllit, duke reduktuar sipërfaqen e kontaktit dhe për këtë arsye fërkimet midis kabllit dhe tubit. Struktura e tubave lejon përdorimin e aksesorëve të veçantë si: manikotave, tapave mbyllëse që pengojnë futjen e lëngjeve ose materialeve të papërshtatshme.

13.2 Dorëzimet

13.2.1 Të përgjithshme

Tubat që duhet të furnizohen duhet të jenë në përputhje me standardet aktuale EN- 61386-24.

Sa i përket testeve për të cilat ato duhet t'i nënshtrohen, ndër të cilat është nënvizuar rezistenca e ngjeshjes, rezistenca e goditjes, temperatura minimale dhe maksimal e instalimit dhe e përhershme. Prandaj, ju lutemi referojuni këtyre rregullave për të gjitha detajet e rastit.



Diametri i jashtëm	40 mm
Spesori	4.6 mm
Materiali	PE AD
Ngjyra	e zezë
Sipërfaqja	e jashtme (lisho), e brëndshme (me vija gjatësore me relief)

13.2.2 Literatura e produkteve, etj.

Të gjitha dorëzimet do të jenë të kompletuara në të gjitha aspektet duke përfshirë të gjithë informacionin dhe listën e të dhënave këtu dhe të gjithë informacionin shtesë I kërkuar për të vlerësuar përputhshmërinë e materialit të tubave me kontratën.

Të dhënat që do të dorëzohen do të përfshijnë, por nuk kufizohen në to:

- Katalogu I të dhënave që përbëhet nga specifikimet, ilustrimet dhe një pjesë axhendë që identifikojnë materialet që do të përdoren për përbërës dhe aksesorë të ndryshëm, ilustrimet do të jenë mjaftueshëm të detajuara për të na ofruar një udhëzues për montimin dhe çmontimin. ;

- b) Vizatimet e plota të montimeve etj. me dimensione të shënuara qartë. Ky informacion duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar për të shërbyer si një udhëzues për montimin dhe çmontimin dhe për porositjen e pjesëve;
- c) Lista e pjesëve rezervë dhe e mjete të veçanta;
- d) Pesha e gjithë pjesëve përbërëse;
- e) Programi i tubave të tabeluar, i cili përfshin informacionin e mëposhtëm për të gjithë tubat dhe pajisjet: Shërbimi, madhësia e tubit, Presioni i punës, trashësia e murit;
- f) Udhëzimet e prodhuesit për transportimin, shkarkimin, ruajtjen dhe instalimin e tubave, montimin dhe pjese të tjera të tubit.

13.2.3 Sigurimi i cilësisë

Të gjithë Tubat dhe pajisjet duhet të prodhohen nga Fabrika të njohura të cilat janë të certifikuar në përputhje me ISO 9001. Tubat duhet të etiketohen në rakordim me standardet, duke përfshirë: Markën e fabrikës, referencë ndaj standardit, materialit të tubit, diametrit dhe presionit minimal.

Të gjithë tubat dhe pjesët montuese të zgjedhura në bazë të kësaj kontrate duhet të jenë të cilësisë së parë, shumë rrethore dhe me trashësi uniforme, pa shkallë, të petëzim, gropëza dhe defekte të tjera, dhe do të jenë të projektuara përshtatshëm për presionin dhe temperaturë e deklaruar.

Kontraktuesi duhet të paraqesë certifikatat e prodhuesit dhe nga laboratorët e aprovuara që vërtetojnë se tubat i janë nënshtruar dhe kanë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara sipas standardeve specifike. Të gjithë materialet duhet të jenë në përputhje me standardet e përmendura këtu dhe më poshtë.

Të gjithë mallrat duhet të kenë para së gjithash Certifikatat e tyre të miratimit para se të përdoren në vendin e punëdhënësit. Kostoja e mostrave, transporti i tyre në laborator dhe testimi i tyre konsiderohet të përfshihet në tarifat e njëjësive dhe nuk paguhen veçmas.

13.2.4 Transporti

Transportimi i tubave do të bëhet në rakordim me udhëzimet e fabrikës ku prodhohen tubat.

Gjatë transportit, tubat nuk do të lejohen të qëndrojnë në nyjet e tyre, pjesët e ngushta të kryqëzuara të automjeteve, ose ndonjë gjë tjetër që mund të rrisë ngarkesat e përqendruara për shkak të peshës të tubit ose goditjes së automjetit por duhet të mbështetet në material të buta.

Gjatë transportimit, tubat nuk duhet të varen në automjete më shumë se 0.6m.

Gjatë transportimit duhet treguar kujdes në këto gjëra:

- Tubat të jenë të pastër dhe pa rërë;
- Do të sigurohet mbulesë e përshtatshme mbi skajet e ekspozuara të tubave për të parandaluar hyrjen e rërës;
- Tubat në shtresat më poshtë nuk janë të ngarkuara në mënyrë të tillë që të shkaktojë dëme ose shtrembërim të tubave.

13.2.5 Magazinimi

Të gjithë tubat duhet të magazinohen në rakordim me rekomandimet e fabrikës prodhuese, në mënyrë që të ruajnë cilësinë dhe kushtet sipas standardeve të specifikuara.

Për magazinimin në vendin e punimeve, toka duhet të jetë e niveluar dhe e pastër nga gurët.

Gjatë magazinimit dhe transportimit, tubat mbështetjen më të afërt të mundshme gjatë gjithë kohës, dhe kujdesi duhet të jetë që të shmangë dëmtime të tubave nga pjesë me kënd të mprehta të metaleve, gozhdët e ekspozuara etj.

Ngarkesat e tubit nuk duhet të grumbullohen më lart se 2m.

Një kujdes i veçantë duhet të tregohen në tubat HDPE dhe PVC. Pikat e përgjithshme të mëposhtme duhet të merren në konsideratë:

- Kontakti me papastërtitë dhe cepat e mprehta të metaleve në mbajtëse, etj. duhet të shmangen;
- Fundi i tubave duhet të mbrohet nga dëmtimet për të shmangur riskun e lidhjeve jo të mira;
- Tubat duhet të ruhen dhe të mbrohen nga rrezet direkte të diellit përfshirë edhe vendet e dorëzimit ku ato vendosen.
- Mbështjelljet mund të ruhen ose në skaje ose sipër stoqeve të rrafshët;
- Tubat duhet të ruhen në temperaturë më të ulët se 23°C.

Nëse, për shkak të ruajtjes dhe trajtimit jo siç duhet, një tub është dëmtuar ose ngacmuar, pjesa e dëmtuar duhet prerë plotësisht me shpenzimet e kontraktuesit.

13.2.6 Instalimi

Instalimi i tubave duhet të bëhet në rakordim me specifikimet e fabrikës prodhuese.

Kontraktuesi do të marrë nga prodhuesi të gjitha informacionet e veçanta në lidhje me trajtimin e tubave dhe formimin e nyjeve dhe ai do ta bëjë veten plotësisht të informuar me të gjitha fazat e shtrimit të tubave përpara se të paraqesë tenderin e tij.

Inxhinieri do të kontrollojë tubat në vendin e ndërtimit (Investigimi vizual i sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme të tubave duke përfshirë testet e dimensionimit) dhe kontraktori do të shënojë të gjithë tubat e dëmtuar në rakordim me udhëzimet e inxhinierit dhe duket ti largojë nga vendi i ndërtimit menjëherë dhe ti zëvendësojë ato me tubat e duhur me shpenzimet e tij.

Vetëm tubat e shënuar si të pranuar nga inxhinierët pas inspektimit në vendin e punës do të inkorporohen në punë.

Përpara se të vendoset, çdo tub duhet të ekzaminohet brenda dhe jashtë dhe të gjithë pluhurat, papastërtitë, dhe gjërat e huaja do të largohen. Kujdes duhet të tregohet që ata të qëndrojnë të pastër gjatë vendosjes.

Kontraktuesi do të kujdeset maksimalisht për të parandaluar çdo dëmtim të tubave, gjatë uljes, shtrirjes dhe bashkimit.

Në mënyrë që të evitohet që gurët, rëra dhe kafshët e vogla që të hyjnë nëpër tuba, duhet të sigurohen kapakë të përshtatshëm ose priza për tubin me të cilat duhet të mbyllen tubat fundore kur nuk është duke vazhduar shtrimi i tubave.

Ne asnjë rrethanë nuk duhet të hidhen tubat në kanal.

Ulja do të realizohet me dorë ose me ane të litarëve lëvizës. Tubat dhe pajisjet e tyre duhet të ulen në kanal me pajisje të përshtatshme për peshën e tubave dhe pjesëve të tyre.

Ulja e tubave në kanal duhet të bëhet në një mënyrë të sigurtë, në përputhje me rregulloret e zbatueshme të sigurisë dhe praktikat normale. Tubat e veshur duhet të trajtohen me presa të përshtatshme të cilat nuk dëmtojnë as tubin, as veshjen. Një numër i mjaftueshëm makinash ngritëse (p.sh. krahë anësore) do të përdoret që të sigurojë që tubi nuk i nënshtrohet presioneve dëmtuese.

Kontraktuesi duhet të sigurohet, që përpara se të vendose tubin, të sigurohet që fundi i kanalit është i pastër nga gurët dhe lende të tjera të cilat mund të dëmtojnë veshjen e tubit.

Tuba duhet të vendosen me saktësi në linjat dhe nivelet e paraqitura në vizatimet e miratuara, brenda një tolerance +/- 5 mm. Kontraktuesi mund t'i paraqesë Inxhinierit për miratimin e tij një metodë alternative për kontrollin e vendosjes së tubit në pozicionin dhe nivelet e sakta.

Tubat duhet të mbështeten përgjatë gjithë gjatësisë së tij dhe, sa të jete e mundur, do të qëndrojnë pa presion ngarkese.

Vëmendja tërhiqet në domosdoshmërinë e sigurimit të një shtrati të përsosur për tubat. Shtrati për tubat duhet të prodhohet sipas specifikimeve. Vrimat e kambanës, me madhësi të mjaftueshme për të lejuar bashkimin e tubit, siç përshkruhet më poshtë, do të gërmohen në pjesën e poshtme të kanaleve, në shtretërit dhe muret e kanaleve, në baze të nevojës. Asnjë tub nuk duhet të vendoset derisa sipërfaqja e fundit të gërmuar të kanalit ose ajo e shtratis të rërës, sipas rastit, duhet të jetë inspektuar nga inxhinieri dhe të miratohet për hedhjen e tubave.

Kur kanalet janë në rrugë, Kontraktori do të mbrojë tubat nga ngarkesat lëvizëse pas shtrimit të tyre, gjatë përfundimit të punimeve në rrugë.

13.2.7 Pjesët përbërëse të tubave

Nëse nuk përcaktohet ndryshe, të gjitha pajisjet duhet të jenë me të njëjtin material si tubat. Pajisjet duhet të pajisen me një lloj bashkimi të pajtueshëm me sistemin e tubave dhe do të sigurohen nga Kontraktuesi pa ndonjë kosto shtesë. Kostot e të gjitha nyjeve, pjesëve speciale dhe pajisje duhet të përfshihen në kostot e njësisë për furnizimin dhe shtrimin e tubave.

13.2.8 Vendi i origjinës së materialeve

Kontraktuesi do të jetë specifik për vendin e origjinës dhe firmën prodhuese të materialeve që ai synon të furnizojë në bazë të Kontratës, dhe do t'i dërgojë të gjithë katalogët përkatës Inxhinierit. Para konfirmimit të importit të çdo materiali, kontraktori duhet të marrë miratimin me shkrim të Inxhinierit.

14 PUNIMET ELEKTRIKE PËR NDRIÇIMIN RRUGOR


14.1 Sistemi ndriçimit

Për ndriçimin do të përdoren ndriçues LED me efikasitet të lartë, për të marrë maksimumin e ndriçimit duke ulur konsumin e energjisë. Ndriçuesit janë sipas normave teknike EN 13201-1 Appendix A1.

14.1.1 Specifikime teknike për ndriçuesin rrugor

Në tabelën e mëposhtme jepen karakteristikat teknike të ndriçuesit rrugor

Tabela 14-1: Karakteristikat e ndriçuesit rrugor tip



Për sistemin e ndriçimit rrugor, të gjitha llogaritjet dhe modelimet përkatëse janë bërë duke përdorur ndriçuesin me të dhënat teknike si më sipër. Gjatë projekt zbatimit duhet të përdoret ndriçues me karakteristikat teknike të mësipërme, për çdo ndryshim në projekt është detyrim dhe përgjegjësi e kontraktorit të rillogarisë ndriçimin rrugor dhe seksionin e linjave të furnizimit.

14.2 Linjat e furnizimit me energji elektrike

14.2.1 Qëllimi

Në këtë paragraf tregohen kërkesat teknike për materialet, prodhimin dhe testimin kabllorë që do të instalohen për furnizimin me energji elektrike të ndriçimit rrugor.

14.2.2 Kodet dhe standardet

Kabllot që do të përdoren për furnizimin me energji duhet të jenë në përputhje me standardet, rregullat dhe rregulloret e përmendura në Specifikimet e Përgjithshme, veçanërisht në përputhje me standardet e mëposhtme:

- IEC 60076
- IEC 60354
- IEC 60502-1
- EN 50575:2014
- EN 50575/A1:2016

14.2.3 Specifikimet teknike të kabllorëve

Kabujt e furnizimit me energji elektrike si dhe kabujt e komandimit, duhet të jenë të përshtatshëm si për instalime të brendshme dhe të jashtme. Kabujt janë të tipit FG16OR16 0,6/1 kV, me Përcjellës fleksibël prej bakri të kuq të klasës 5, me izolom HEPR të cilësisë G16 të mbështjellë me PVC cilësia R16.

Gjatë instalimit duhet të kihet parasysh që rrezja e kubaturës të jetë $R_k=4XD$.

Të gjitha produktet duhet të jenë të çertifikuara dhe markuara "CE".

Tabela 14-2: Karakteristikat teknike të kabllorëve FG16OR16 0,6/1 kV

Tensioni nominal U_0/U	600V/1000 (AC)
Tensioni maksimal	1200V (AC)
Tensioni i provës	4000 V
Temperatura maksimale e ushtruar	90°C
Temperatura minimale e ushtruar	-15°C
Rrezja e rekomanduar minimale e kthimit	4 herë sa diametri i kabllit
Materiali veshës	PVC

14.3 Specifikimet teknike për shtyllat e ndriçimit

Shtyllat e ndriçimit duhet të jenë çelik i galvanizuar. Shtylla e ndriçimit duhet të jetë e përshtatshme për tu instaluar referuar detajeve përkatëse. Baza dhe pjesa e sipërme e shtyllës duhet të jenë të hapura për të lejuar kalimin e kabullit dhe instalimin elektrik. Të dhënat teknike të shtyllave të ndriçimit janë si më poshtë:

- Gjatësia totale 8.8

- Krah me çelik të galvanizuar 1x1.5 metër.

- Shtylla duhet të jetë i pajisur me një kapëse, siguresa FRA16A dhe kabllor PP-Y3x2.5mm².

Shtylla e ndriçimit duhet të:

- Mbjë ngarkesat e projektimit
- Të jetë rezistent ndaj kushteve atmosferike dhe korrozionit
- Ofrojë hapësirë të mjaftueshme për lidhjet elektrike dhe instalimin e ndriçuesit
- Te minimizojë mirëmbajtjen

14.4 Panelet elektrike

14.4.1 Të përgjithshme

Panelet e shpërndarjes do të jenë sipas standardit IEC (pjesët e kontrollit dhe të kyçje-çkyçjes për tension të ulët), në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe kombëtare. Panelet e shpërndarjes do të normohen për tension alternativ 400 V dhe normimi i rrymës sipas ngarkesës së lidhur duke përfshirë ngarkesën rezervë 30 %. Projektimi dhe ndërtimi i paneleve do të jetë i tipit shpërndarës për ambiente të brendshme dhe i montueshëm në mur/dysheme dhe të jetë me përmasa, normim dhe vendosje në përputhje me specifikimet teknike, skemën njëfillëshe dhe të prodhohet në përputhje me standardet.

Çdo panel do të jetë i pajisur me lidhje të fortë dhe të lëvizshme neutrale për izolim dhe një zbarë për bashkimin e përcjellësve të tokës.

Plan-vendosja e pajisjeve brenda panelit do të jetë e tillë që të jenë të arritshme të gjitha pjesët, kabllot hyrëse dhe dalje dhe bashkuesi i tubave të kabllave.

Paneli do të jetë i pajisur me terminale të mbrojtura nga futja e gishtave për të gjithë lidhjet e hyrjes dhe të daljes. Terminalet për qarqet e sinjalit dhe kontrollit do të jenë të ndarë nga qarqet e fuqisë dhe të shënuar në mënyrë të qartë. Terminalet për sinjalet dhe komandat do të pajisen me lidhje për ndarje. Do të merren parasysh ngjyrat e mëposhtme:

- Fazat L1, L2, L3: Zezë, Kafe, Gri
- Neutri: Blu
- Toka: Jeshil/Verdhë

Në panel duhet të lihet një hapësirë rezervë për zhvillime të mëtejshme. Kjo hapësirë duhet të jetë 20 % e moduleve që janë në shfrytëzim. Vendet bosh do të pajisen me pllaka bosh. Në anën e brendshme të derës do të vendoset lista e qarqeve të emëtuara sakte që janë instaluar në panel.

Paneli elektrik dhe aksesorët e tij duhet të plotësojnë normat CEI EN 60439-1, IEC 61439-1, IEC 61439-2 dhe fraksionet e tyre. Të gjitha produktet duhet të jenë të çertifikuara dhe markuara "CE".

14.4.2 Specifikimet teknike të panelit

Në tabelën e mëposhtme jepen specifikimet teknike të panelit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Të gjitha produktet duhet të jenë të çertifikuara dhe markuara "CE".

Tabela 14-3: Karakteristikat teknike të panelit

Tensioni nominal i punës	230 / 400 V
Frekuenca	50 – 60 Hz
Rryma nominale e panelit	40-60A (referuar detajeve)
Rryma e lidhjes së shkurtër	25kA
Rryma impulsive e lidhjes së shkurtër	50kA
Shkalla e mbrojtjes	IP 43
Tensioni i izolimit	1000 V
Shkalla e mbrojtjes	IP43
Rezistenca mekanike IK	IK08
Temperatura e punës	-5°C / +40°C

Kushtet klimaterike (t°/RH%)	+ 23°C/83% - 40°C/93%
------------------------------	--------------------------

14.5 Automatet (ndërprerësit automatik të qarkut)

14.5.1 Të përgjithshme

Automatet duhet të ndërtohen dhe testohen sipas standardeve ndërkombëtare ose kombëtare. Karakteristikat e veprimit të automatit duhet të jenë në përputhje me karakteristika e funksionimit të aplikimit elektromekanik ose elektrik të lidhur në rrjet. Të gjitha karakteristikat dhe standardet duhet të jenë të garantuara për lartësinë e dhënë në funksion të pozicionit të punës së pajisjeve të instaluar.

14.5.2 Automatet magneto termik

Paisjet që shërbejnë për mbrojtje nga mbi ngarkesat dhe lidhjet e shkurtëra janë :

- Automat magneto termik katër polar (4P). Në këto automate mbrohen nga mbi ngarkesat dhe lidhjet e shkurtra të katër përcjellsat, tre përcjellsat e fazës dhe përcjellësi i nulit. Në rast avarish shkëputen automatikisht të katër përcjellësat.
- Automat magneto termik tre polar (3P). Në këto automate mbrohen nga mbi ngarkesat dhe lidhjet e shkurtëra të tre përcjellësat e fazës. Përcjellësi i nulit vazhdon i pandërprerë. Në rast avarish shkëputen automatikisht tre përcjellësit. Përcjellësi i nulit është i pandërprerë.
- Automat magneto termik tre polar plus neuter(3P+N). Në këto automatve mbrohen nga mbi ngarkesat dhe lidhjet e shkurtra të tre përcjellsat e fazës. Përcjellësi i nulit futet në automat por nuk mbrohet. Në rast avarish shkëputen automatikisht tre përcjellësit e fazave dhe përcjellësi i nulit.
- Automat magneto termik dy polar plus (2P). Në keto automate mbrohen nga mbi ngarkesat dhe lidhja e shkurtër përcjellsat e fazës dhe përcjellësi i neutrit. Në rast avarish shkëputen automatikisht të dy përcjellësat, si ai i fazës dhe përcjellësi i neutrit.
- Automat magneto termik një polar plus neutër(1P+N). Në keto automate mbrohen nga mbi ngarkesat dhe lidhjet e shkurtëra vetëm përcjellësi i fazës. Përcjellësi i nulit futet në automat por nuk mbrohet. Në rast avarish shkëputen automatikisht të dy përcjellësit, ai i fazës dhe përcjellësi i neutrit.

14.5.3 Specifikimet teknike të automateve

Automatet magneto termik, duhet të jenë konform normave dhe standardeve EN 60898, EN 60947-2, EN 61008-1/ IEC 61008-1/ EN 61008-2-1/ IEC 61008-2-1. Të gjitha produktet duhet të jenë të çertifikuara dhe markuara "CE"

Tabela 14-4: Karakteristikat teknike e automateve magneto termik 4P/3P+N

Tensioni nominal Un	230/400 V
Frekuenca	50 – 60 Hz
Tensioni i provës	4000 V
Rryma çkyçëse e lidhjes së shkurtër Icu	6kA /10kA
Numri i çkyçëse mekanike	20000
Numri i çkyçëse elektrike	10000
Shkalla e mbrojtjes	IP 40
Tensioni i izolimit	500 V

Kurba e punës	C
---------------	---

Tabela 14-5: Karakteristikat teknike e automateve magneto termik 2P/1P+N

Tensioni nominal Un	230/400 V
Frekuenca	50 – 60 Hz
Tensioni i provës	4000 V
Rryma çkyçëse e lidhjes së shkurtër Icu	6kA
Numri i çkyçjeve mekanike	20000
Numri i çkyçjeve elektrike	10000
Shkalla e mbrojtjes	IP 40
Tensioni i izolimit	500 V
Kurba e punës	C

14.5.4 Paisjet diferenciale

Për tu mbrojtur nga kontaktet indirekte apo direkte, në këtë projekt janë përdorur pajisje diferenciale të cilat instalohen në panelin kryesor. Pajisjet që shërbejnë për mbrojtje nga kontaktet direkte dhe indirekte do të jenë :

- Diferencial i pastër katër polar, për sistemet tre fazore (4P)
- Diferencial i pastër dy polar, për sistemet një fazore (2P)

Keto pajisje të mundur monitorimin e sasisë së rrymës hyrëse dhe sasisë së rrymës dalëse. Nëse kjo sasi rryme ka një diferencë më të madhe se vlera e taruar, paisja çkyçet duke ndërprerë furnizimin me energji elektrike të konsumatorit. Paisjet diferenciale kanë pesë karakteristika pune, siç tregohet dhe në figurën e mëposhtme. Në varësi tv qarkut që duhet tv mbrohet, zgjidhet karakteristika e punës së pajisjes diferenciale.












Tipologia di Corrente	Forma d'onda	Tipo					Soglia intervento
		AC 	A 	F 	B 	B+ 	
Alternata sinusoidale		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	0.5 ... 1.0 I _{Δn}
Corrente pulsante unidirezionale (semionde pos. o neg.)		<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	0.35 ... 1.4 I _{Δn}
Semionda parzializzata		<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Angolo di ritardo 90°: 0.25 ... 1.4 I _{Δn} Angolo di ritardo 135°: 0.11 ... 1.4 I _{Δn}
Corrente pulsante unidirezionale con componente continua		<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	max. 1.4 I _{Δn} + DC
Corrente a frequenza variabile		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	0.5 to 1.4 I _{Δn}
Corrente Continua		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	0.5 ... 2.0 I _{Δn}

Figura 14-1: Tipat e diferencialeve

Për mbrojtjen linjave të ndriçimit do të përdoren pajisje diferenciale me kurbë "A" dhe të taruar në vlerën 0.3 A (300 mA).

14.5.5 Specifikimet teknike te automateve diferenciale

Automatet diferenciale, duhet të jenë konform normave dhe standarteve EN 60898, EN 60947-2, EN 61008-1/ IEC 61008-1/ EN 61008-2-1/ IEC 61008-2-1. Të gjitha produktet duhet të jenë të çertifikuara dhe markuara "CE".

Tabela 14-6: Karakteristikat teknike të automateve diferencial të pastër 2P / 4P

Tensioni nominal Un	230/400 V
Frekuenca	50 – 60 Hz
Tensioni provës	4000 V
Rryma çkyçëse e lidhjes së shkurtër Icu	6kA
Numri i çkyçjeve mekanike	10000
Numeri i çkyçjeve elektrike	5000
Shkalla e mbrojtjes	IP 40
Tensioni i izolimit	440 V
Kategoria e mbitentensionit	III
Rryma diferenciale	0. 3A
Karakteristika e punës, klasa	A

14.6 Sistemi tokëzimit

14.6.1 Të përgjithshme

Si në çdo impiant elektrik edhe sistemi i ndriçimit rrugor duhet të lidhet me impiantin e tokëzimit, duke iu referuar normave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në të gjithë trasenë ku do të vendosen tubat e furnizimit, do të instalohet një përcjellës FeZn D10mm dhe një në tre puseta do të instalohet një elektrodë në formë kryqi 50X50X5 cm FeZn me gjatësi L=150cm, e cila do të lidhet me morsetë me përcjellësin FeZn. Elementet e sistemit të tokëzimit duhet të plotësojnë normat, CEI EN 62561, CEI EN 62561-2, CEI 99-3, CEI 64-8, CEI 81-10, CEI EN 62305-3.

14.6.2 Specifikimet teknike, përcjellësi FeZn D10mm

Më poshtë paraqitet në formë ilustruese, përcjellësi hekur i zinguar në të nxehtë me diametër $\varnothing=10$ mm, 0.6 kg/m, për tu futur në tokë.



Figura 14-2: Përcjellës FeZn

14.6.3 Specifikimet teknike, elektroda kryq FeZn

Elektrodë në formë plusi, çelik i galvanizuar në të nxehtë me seksion 50X 50X5 mm, gjatësi 1500 mm, 5.4 kg, për tu futur në tokë. E përbërë nga një piastër në formë flamuri me tre vrima për lidhjen e përcjellësit, shiritit apo aksesorëve të ndryshëm.

TE DHENAT TEKNIKE

- Formë kryqi “+” jo më pak se 50x5mm, H=1.5 m
- Cilësia e çelikut DIN 17 100
- Pajisur me pllakë bashkuese
- Paisur me morseten per bashkimin me percjellesin me diameter deri13mm i përputhshëm me DIN 48 – 452
- Shtresë zinku – minimumi 70 mikron
- Kapikordat prodhohen ne perputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre.

IDENTIFIKIMI DHE PAKETIMI

Elektrodat do të paktohen në kuti kartoni. Çdo kuti do të përmbajë informacion për:

- llojin e elektrodës
- përmasat e elektrodës
- prodhuesin
- vitin e prodhimit
- pesha bruto
- numrin e kutisë




Figura 14-3: Elektrodë tokëzimi

14.6.4 Specifikimet teknike, aksesor lidhje percjelles FeZn-elektrode FeZn

Morset kalimtare me seksion 40X3 mm për lidhjen e përcjellësit D10mm FeZn me elektrodën në formë kryqi FeZn, e përshtatëshme për tu futur në tokë.



Figura 14-4: Morseta lidhëse, lidhje percjelles FeZn-elektrode FeZn

14.6.5 Specifikimet teknike, aksesor lidhje përcjellës FeZn-përcjellës bakri

Morsetë inoksi, për lidhjen e dy materialeve të ndryshme. Në njërin krah lidhet me përcjellësin FeZn D 8-10 mm, në krahun tjetër lidhet me përcjellësin e tokëzimit me seksion nga 4-50mm². Morseta nëpërmjet elementit ndërmjetës së saj të përbërë nga një pllakë inoksi mund të bashkojë materiale të ndryshme si Cu, Al, Fe/Zn dhe inoks.



Figura 14-5: Morseta lidhëse, lidhje përcjellës FeZn-përcjellës bakri

14.7 Infrastruktura e Tubave Fleksibël dhe Aksesorët

14.7.1 Të përgjithshme

Tubat e përdorur për mbrojtjen e linjave të Ndrëçimit Rrugor, janë tuba të valëzuar të përbërë nga dy shtresa polietileni. Nëpërmjet strukturës së tij të veçantë të përbërë nga një shtresë e valëzuar dhe një shtresë e drejtë, (shtresa e dytë e pa valëzuar) bën të mundur instalimin e përcjellëseve me lehtësi. Janë rezistente ndaj shtypjeve dhe goditjeve. Këto veçori i bëjnë këto tuba të përshtatshëm për instalime nën tokë.

Tubat janë konform normave CEI EN 61386-1 (CEI 23-80); CEI EN 61386-24 (CEI 23-116); EN 61386-24. Të gjithë tubat duhet të jenë të markuar “CE”.

14.7.2 Specifikimet teknike të tubave D 75 mm dhe D 110 mm


Tubat e përdorur janë të përshtatshëm për tu vendosur në tokë, janë tuba të valëzuar të përbërë nga dy shtresa polietileni. Nëpërmjet strukturës së tij të veçantë të përbërë nga një shtresë e valëzuar dhe një shtresë e drejtë, (shtresa e dytë e pa valëzuar) bën të mundur instalimin e përcjellëseve me lehtësi. Janë rezistente ndaj shtypjeve dhe goditjeve. Këto veçori i bëjnë këto tuba të përshtatshëm për instalime nën tokë.

Tabela 14-7: Specifikimet teknike të tubave D75 mm dhe 110 mm

Diametri i tubit[DN]	75	110
Diametri jashtëm	75.0	110
Diametri brendshëm	62.1	93.1
Rrezja e kurbaturës [≥ m]	0.600	0.800
Tipi i tubit	fleksibël	
Ndërtimi i tubit	korrogat me dy shtresa	
Materiali	polietilen	
Temperatura e përdorimit	(-25/ +90) °C	
Rrezistenca në shtypje	≥ 450 N	

Tabela 14-8: Specifikimet teknike të aksesorëve të tubave

Bashkues i tubave	Unazë mbyllëse	Tapë fundore	Distanciator
-------------------	----------------	--------------	--------------



14.7.3 Pusetat e betonit

Për ndërtimin e infrastrukturës elektrike janë përdorur puseta shpërndarëse dhe kalimtare të cilat janë instaluar në gjatësi të linjave dhe në ndryshimin e trajektoreve.

- Për infrastrukturën e ndriçimit rrugor ku është përdorur bateri me 2 tuba me DN 75 mm, do të përdoren puseta betoni me hapsirë të brendshme 30x30 cm të çara në fund. Pusetat do të jenë me kapak gize B125 sipas EN 124 me dimensione të jashtme të kapakut 40x60 cm. Detaji i ndërtimit të pusetës jepet në fletën e vizatimit.
- Për infrastrukturën e fibrave optike ku është përdorur batri me 4 tuba PE 40 mm do të përdoren puseta betoni me hapsirë të brendshme 50x50x55 cm të çara në fund. Pusetat do të jenë me kapak gize klasi B125 sipas EN 124 me dimensione të jashtme të kapakut 60x60 cm.

15 PROÇEDURAT NË ARKEOLOGJINË PARANDALUESE

15.1 Përcaktime

15.1.1 Impaktet në Trashëgiminë Kulturore (ITK)

Një ndryshim në Trashëgiminë Kulturore (në këtë kontekst "Trashëgimia Kulturore") i referohet çdo trashëgimie materiale (p.sh.: objekte, artefakte, struktura, hapësira) ose shpirtërore te vlerave te rëndësishme për kulturën e popullit historinë apo identitetin e tij) që ka ndodhur si rezultat i impaktit të projektit ndërtimor.

Impaktet mund të konsiderohen pozitive ose negative.

15.1.2 Trashëgimia Kulturore Shpirtërore (TKSH)

"Praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë, aftësitë si dhe instrumentet, objektet, artefaktet, hapësirat kulturore të lidhura me to-që komunitetet, grupet dhe në disa raste individët i njohin si pjesën e tyre të trashëgimisë kulturore" (konventa për mbrojtjen e TKSH e vitit 2003) .

Në termat e projektit janë instrumentet përkatës, objektet, artefaktet dhe hapësira kulturore që mund të ndikohet.

15.1.3 Procedurat e Arkeologjisë së Shpëtimit

Procedurat e Arkeologjisë së Shpëtimit si: sondazhet arkeologjike, gjetjet rastësore, gërmimet e shpëtimit do të konsiderohen si zë i veçantë në kontratë dhe nuk janë të përfshirë në çmimet njësi të zërave të gërmimit për qëllime të kësaj kontrate.

15.2 Përgjegjësitë

Kontraktori është përgjegjës për të siguruar që te gjitha operacionet e punës në kantier, pajisjet dhe makineritë janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, rregulloreve, standardeve ligjore, VNM, si dhe politikave dhe kërkesave për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Kontraktori është përgjegjës për çdo impakt negativ ambjental, social-ekonomik dhe te trashëgimisë kulturore që vjen si rezultat i aktiviteteve apo veprimeve për vënien në vend të çdo mase të nevojshme për ta evituar atë apo për ta zbutur.

Kontraktori është gjithashtu përgjegjës për veprime të menjëhershme në rast të ngjarjeve aksidentale dhe zvogëlimin e impaktit negativ ndaj mjedisit, atij social-ekonomik dhe të Trashëgimisë Kulturore sa më shumë që të jetë e mundur.

Në rast të ndodhjes së ndonjë ngjarje aksidentale Kontraktori duhet menjëherë të informojë Mbikëqyrësin dhe Klientin, për të zgjedhur mënyrën më të mirë të zgjidhjes apo të zvogëlojë rreziqet e menjëhershme të mundshme tek aktorët e projektit.

Kontraktori do të ushtroje te gjitha këto përgjegjësi duke :

- Komunikuar përmbajtjen e VNM punonjësve dhe nënkontraktoreve dhe duke i trajnuar ata për tu siguruar që ata e kuptojnë përgjegjësinë e tyre në lidhje me menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore, raportimin e incidenteve dhe reagimin.
- Duke siguruar që burime njerëzore të përshtatshme janë mobilizuar për menaxhimin e trashëgimisë kulturore duke përfshirë edhe specialiste përkatës për të bërë të mundur planifikim dhe zbatim të masave siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

15.3 Monitorimi arkeologjik gjatë fazës së ndërtimit dhe raportimi

Programi i monitorimit gjatë fazës së ndërtimit do të kërkojë që gjithë punimet e ndërtimit do të zbatohen nën një monitorim të plotë nga një Kompani Monitoruese (KM) e Trashëgimisë Kulturore.

KM do të dokumentojë dhe raportojë gjithë monitorimin e aktivitetit ndërtues rregullisht sikurse do të bihet dakord me Ministrinë e Kulturës.

Këto raporte do të jenë subjekt i rishikimit dhe miratimit nga eksperti i Trashëgimisë Kulturore dhe Ministria e Kulturës.

Çdo impakt i monitoruar në Trashëgiminë Kulturore do ti raportohet autoritetit përkatës qeveritar Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik (ASHA), e cila mund të ndalojë punën derisa masat përkatëse të jenë marrë ose vendosur.

Kjo kërkesë është e zbatueshme për impaktin ndaj Trashëgimisë Kulturore në të gjitha zonat potencialisht të ndikuara nga projektet ndërtimore.

15.4 Sondazhet arkeologjike dhe gërmimet e shpëtimit

Autoritetet Përgjegjëse për Trashëgiminë Kulturore (Ministria e Kulturës), bazuar në rezultatet e vëzhgimit Intensiv Arkeologjik dhe potencialin arkeologjik të zonës ku zhvillohet projekti ndërtimor, mund të kërkojnë kryerjen e sondazheve arkeologjike, para fillimit të punimeve të zbatimit.

Bazuar në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Rregulloren e Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë sondazhet kryhen nga Shoqëri të Liçensuara në Arkeologji, të cilat mbikëqyren nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA) në Ministrinë e Kulturës.

Raporti i Sondazheve Arkeologjike miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) dhe mbi bazën e rezultateve të tij, mund të kërkohet kryerja e gërmimeve të shpëtimit.

Gërmimet e Shpëtimit kryhen nga Kompani të specializuara dhe të Liçensuar në Arkeologji.

Sondazhet dhe Gërmimet Arkeologjike të Shpëtimit realizohen mbi bazën e marrëveshjeve trepalëshe: Kontraktor – Shoqëri e Liçensuar në Arkeologji – ASHA.

15.5 Gjetjet rastësore arkeologjike

Gjetjet rastësore janë objekte, të dhëna, apo site të trashëgimisë kulturore ose paleontologjike, që zbulohen pas një njohje më të plotë të kantierit, kryesisht si rezultat i monitorimit arkeologjik në terren të procesit të ndërtimit.

Gjetjet rastësore mund të behën nga çdo pjesëmarrës në procesin e ndërtimit, përfshirë arkeologët monitorues, punëtorë të zbatimit apo vizitorë.

Ligji shqiptar dhe legjislacioni ndërkombëtar kërkojnë zbatimin e një Procedure për gjetjet rastësore në rastet e ndërtimeve të mëdha.

Kjo përfshin monitorimin e aktiviteteve të ndërtimit nga një arkeolog/shoqëri arkeologjike e liçensuar (CHM), i emëruar nga Klienti dhe i aprovuar nga Ministria e Kulturës) dhe ndërprerjen e punës (përmes zbatimit të një protokollit të caktuar për të ndaluar punën) në afërsi të ndonjë zbulimi të ri arkeologjik.

Nëse një gjetje rastësore arkeologjike me rëndësi të madhe zbulohet gjatë ndërtimit, procedurat e arkeologjisë së shpëtimit duhet të kryhen sipas kërkesave të Ligjit Shqiptar dhe atij ndërkombëtar.

Aktivitetet e ndërtimit në një gjetje rastësore të rëndësishme do të rifillojnë vetëm pas zbatimit të masave mbrojtëse të miratuara nga autoritetet e trashëgimisë në Shqipëri. Vazhdimi i ndërtimit në një zbulim të rëndësishëm rastësor arkeologjik duhet të rifillojë vetëm pasi gërmimi i shpëtimit është realizuar i plotë, në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Rregulloren e KKA.

Objektiv i kësaj Procedure është të identifikojë dhe t'i mbrojë sitet e peregjistruara më parë të trashëgimisë kulturore, objekte, ose karakteristika, nga dëmtime që mund të shkaktojë zbatimin e projektit ndërtimor.

Procedura zbatohet për objekte të trashëgimisë kulturore, karakteristika apo site të identifikuara si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit në një zonë.

Kjo procedurë ka të bëjë në vetvete me mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore më shumë se objektet individuale.

Vendimi nëse një gjetje rastësore është një burim trashëgimie kulturore kërkon trajtim shtesë dhe duhet të bëhet nga një kompani arkeologjike, bazuar në përvojën dhe trajnimin.

Çdo i punësuar nga Kontraktori që merr pjesë në procesin e ndërtimit, mban përgjegjësi për të njoftuar arkeologun monitorues(CHM) , menjëherë në rast dyshimi për gjetje rastësore arkeologjike.

Në rastin e një gjetjeje rastësore, puna në afërsi (në një zonë minimale 50m nga zbulimi) duhet të ndalohet dhe zona duhet të shënohet për tu shmangur nga Kontraktori (ose nënkontraktorët). Pas ndalimit të punës, Kontraktori duhet të raportojë menjëherë zbulimin Mbikëqyrësit dhe përfaqësuesit të Klientit, i cili nga ana e tij duhet të thërrasë ekspertin e trashëgimisë kulturore.

Mbikëqyrësit, personeli në terren, përfaqësuesit e klientit dhe të trashëgimisë kulturore të cilët duhet të njoftohen nga eksperti i trashëgimisë kulturore sapo zbulimi është konfirmuar si i një rëndësie të veçantë dhe strategjitë e përshtatshme të trajtimit janë zhvilluar.

Shoqëria Monitoruese Arkeologjike duhet të identifikojë dhe të verifikojë gjetjen, të vlerësojë rëndësinë e saj dhe ajo vendos të pezullojë punën në këtë zonë dhe/ose zonat më të mëdha përreth, ose për të hequr gjetjen (në qoftë se ajo është një objekt lehtësisht i luajtshëm, si një monedhë etj.) dhe do të lejojë vazhdimin e punimeve.

Nëse një procedure shpëtimi arkeologjik është e nevojshme në një zbulim të rastësishëm, Klienti është përgjegjës për të siguruar se procedura e shpëtimit arkeologjik është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe shqiptare dhe me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare. Aktivitetet e ndërtimit në një zbulim të rëndësishëm rastësor do të rifillojnë vetëm pas zbatimit të masave mbrojtëse dhe/ose trajtimit të miratuar nga autoritetet qeveritare.

Një përshkrim i detajuar i procedurës për gjetjet rastësore arkeologjike jepet më poshtë.

15.6 Procedura për gjetjet rastësore

Në rastin e një gjetjeje rastësore, shoqëria arkeologjike monitoruese në bashkëpunim me ekspertin e trashëgimisë kulturore do të përgatisin brenda 48 orëve një raport të gjetjeve rastësore për ta paraqitur tek autoritetet përkatëse sipas këtij formati :

- ora dhe data e zbulimit,
- vendndodhja e zbulimit, (koordinatat gjeografike dhe referenca në km si dhe foto + vendndodhja në hartë),
- përshkrim i asaj çfarë është zbuluar,
- rëndësia e asaj çfarë është zbuluar,
- vlerësim nëse gjetja mund të zhvendoset apo jo (duke marrë në konsideratë peshën, dimensionet etj.)
- koha e parashikuar për kryerjen e gërmimit të shpëtimit
- rekomandime si do të procedohet më tej
- masat e përkohshme të zbatuara nga momenti i zbulimit

Autoriteti përkatës (ASHA) do të konsultohet për të përcaktuar vendimin e duhur në lidhje me masat që do të merren për gjetjen rastësore. Këto masa mund të përfshijnë, por nuk kufizohen te:

- Lëvizja, nëse është e mundshme, e gjetjes nëse vlera e saj është e një rëndësie të mesme ose të lartë.
- Kryerjen e gërmimeve të mëtejshme brenda një distance të caktuar nga pika ku është zbuluar gjetja rastësore, kur ajo është e rëndësishme së lartë.
- Vendimi për të vazhduar me punimet e ndërtimit.

15.7 Dokumentimi i gjetjeve rastësore arkeologjike

Stafit të trashëgimisë kulturore të Klientit, stafit tjetër të tij dhe Kontraktorit do t'ju kërkohet të mbajnë dokumentacion për monitorimin arkeologjik, gjetjet rastësore si dhe masat e ndërmarra për to. Këto do të përfshijnë:

- Raportet ditore të monitorimit për zonat dhe aktivitetet e monitoruara; Gjetjet rastësore të raportuara dhe rezultatet e ndonjë vlerësimi. Komunikimet si dhe instruksionet (si ato që bëjnë fjale për ndalimin dhe rifillimin e punimeve) duhet të përfshihen në këto raporte.
- Raportet javore do të përmbledhin aktivitetet përkatëse përfshirë dhe gjetjet rastësore, llogaritjen dhe vlerësimin, komunikimet e brendshme dhe të jashtme, instruksionet, dokumentacionin mbështetës fotografik (apo materiale të tjera mbështetëse që do të gjykohen të përshtatshme). Raporte të tjera shtesë që do të përmbushin kërkesa të veçanta të ekspertit të trashëgimisë apo Ministrisë së Kulturës, do të konsiderohen të mirëpritura.
- Raporte mujore përmbledhëse të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimeve, statusin e ndonjë siti i cili është në trajtim dhe kërkon masa shtesë, instruksionet e dhëna Kontraktorit, si dhe komunikime të brendshme apo të jashtme.

15.8 Mbrojtja e site-ve të njohura të trashëgimisë

Site-t e njohura të trashëgimisë duhet të mbrohen nga dëmtimet që lidhen me projektin ndërtimor. Kjo përfshin site-t e identifikuar para fillimit të punimeve të ndërtimit (nga vëzhgimi intensiv arkeologjik) apo ato të zbuluara apo të gjetura gjatë fazës së ndërtimit (gjetjet rastësore).

Site-t mund të jenë në zonën e projektit ose në afërsi të tij.

Një informacion për site-t duhet të jepet nga eksperti i trashëgimisë, klientit, mbikëqyrësit dhe stafit të kontraktorit në formë të shkruar dhe verbale në takime apo trajnime në terren gjatë punës si masa të përshtatshme për të siguruar që site-t e njohura arkeologjike do të mbrohen nga dëmtimet.

Për site-t arkeologjike, Klienti do të angazhojë autoritetet përkatëse qeveritare për vlerësime të mëtejshme të tyre dhe përdorimin e metodave intruzive dhe jo-intruzive.

15.9 Teknikat e ndërtimit

Kontraktori duhet të përdorë teknika të përshtatshme ndërtimi në mënyrë që të evitohet dhe atje ku nuk është e mundur të minimizojë çdo dëmtim të mundshëm që lidhet me impaktin e projektit ndërtimor.

Në zonat me potencial të lartë arkeologjik, brenda zonës së ndërtimit, ndërtimi duhet të ndalohej në kohë me nivel të lartë lagështie.

16 PUNIME TË TJERA

16.1 Shkallë, platforma çeliku dhe parmacët

Shkallët dhe Shkallëzimet e çelikut përfshirë të gjitha pajisjet duhet të prodhohen me seksione çeliku të butë me dimensione siç kërkohen në Kontratë dhe të fiksohen me bulona zgjerues. Në qoftë se nuk specifikohet ndryshe në Vizatime, shkallët duhet të projektohen nga Kontraktori për ngarkesë njëtrajtësisht të shpërndarë 5 kN/m², parmacët dhe korimanot për ngarkesë horizontale 1kN/m që vepron në çdo kënd në pjesën e sipërme të parmacut.

Aty ku shkallët janë më të larta se 3m, duhet të vendoset kafaz sigurie për pjesën e shkallës që është më e lartë se 2m nga dyshemeja e poshtme ose sheshpushimi.

Parmacët përgjatë çarjeve në dysheme etj. do të përbëhen nga tuba çeliku rrethore siç tregohet në vizatime. Në punime do të përfshihen ganxhat për vendosjen e parmacëve në mur. Shtyllat duhet të bulonohen në dyshemenë e betonit.

Të gjithë pajisjet prej çeliku duhet të galvanizohen në të nxehtë.

16.2 Shkallët metalike

Të gjitha shkallët metalike, të drejta dhe spirale, duhet të kenë shkelje dhe sheshpushime me rrjetë metalike. Parmacët në shkallët spirale duhet të bëhen me shufra çeliku me dy shufra për shkelje. Mbërthyeset për vendosjen e parmacëve në mur duhet të përfshihen. Kur një grup shkallësh spirale lidh më shumë se dy nivele të njëpasnjëshme, lartësia midis dyshemeve duhet të bashkërendohet me vendndodhjen e platformave të sheshpushimeve, numrin e ngjitjeve, dhe lartësinë e kërkuar për kalimin e një personi pa pengesë. Korimanot duhet të jenë ose me shufra çeliku rrethore ose të sheshta me shtresë PVC.

Trarët mbështetës, shtylla kryesore dhe të gjithë elementët e tjerë që mbajnë ngarkesë duhet të projektohen nga Kontraktori për ngarkesë njëtrajtësisht të shpërndarë 5kN/m². Parmacët duhet të projektohen për të mbajtur ngarkesë horizontale 1kN/m që vepron në çdo kënd në pjesën e sipërme të parmacut. Vizatimet e elementëve të parapërgatitur duhet ti dorëzohen Mbikëqyrësit për miratim. Të gjitha punimet me çelik duhet të përdorin çelik të galvanizuar në të nxehtë.

16.3 Zgarat metalike

Zgarat metalike të prodhuara me çelik të butë ose hekur, duhet të projektohen nga Kontraktori për ngarkesat e shënuara në Vizatime. Në qoftë se nuk specifikohet ndryshe, zgara metalike me regjim të lehtë pune duhet të projektohen për ngarkesë njëtrajtësisht të shpërndarë 5kN/m² dhe rrjeta metalike me regjim të rëndë pune duhet të projektohen për ngarkesë të përqendruar 400 kN që vepron në sipërfaqe rrethore me diametër 200mm.

Të gjitha punimet prej çeliku duhet të jenë prej çeliku të galvanizuar në të nxehtë, gizë të derdhur të ngjyrosur aty ku specifikohet.

16.4 Shtresa e vegjetacionit (nëse përshihet në preventiv)

Kontraktori duhet të sigurojë vegjetacion për peizazhin dhe mbrojtjen ndaj erozionit të shpateve dhe zonave të tjera.

Kontraktori duhet të sigurojë vegjetacion me anë të mbjelljes, ose me shtresa bari artificial. Kontraktori duhet ti mbajë zonat me vegjetacion të ujitura me ujë me spërkatje për sa kohë të nevojitet për

të siguruar mbulesë të qëndrueshme. Normalisht, kjo duhet të bëhet deri sa zonat me vegetacion të kenë arritur 98% të mbulesës së tokës.

